

PËRMBAJTJA

I. RAPORTIM DHE INFORMIM NË USHTRIM TË FUNKSIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT	3
STRUKTURA ORGANIKE E ADMINISTRATËS SË PREFEKTIT QARKU	
FIER.....	6
BUXHETI I INTITUCIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT FIER	9
ARKIVIMI I DOKUMENTACIONIT.....	15
II. MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE	16
VERIFIKIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES.....	16
VERIFIKIMI NË VEND I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE.....	21
III. MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME DEGËT TERRITORIALE DHE INSTITUCIONET	26
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS, FIER, LUSHNJË, MALLAKASTËR	26
DREJTORIA VENDORE E POLICISË	28
INSPEKTORIATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT	34
DEGA E DOGANËS FIER.....	37
DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT FIER	39
DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK FIER	43
DREJTORIA RAJONALE E SIGURIMEVE SHOQËRORE.....	45
DREJTORIA RAJONALE TATIMORE, FIER	50
DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR, FIER.....	53
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR, GJIROKASTËR	53
OSHEE DREJTORIA RAJONALE.....	53
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, FIER.....	58

AGJENCIA RAJONALE E EKSTENSIONIT BUJQËSOR LUSHNJË.....	61
SEKTORI I BORDIT TË KULLIMIT	69
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT, FIER.....	75
DREJTORIA E SPITALIT RAJONAL, FIER.....	77
NJËSITË VENDORE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR	78
DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR	91
ADMINISTRATA RAJONALE E ZONAVE TË MBROJTURA	95
AGJENCIA RAJONALE E MJEDISIT, FIER	100
IV. MBROJTJA CIVILE.....	121
V. TASK FORCA, KOMITETET RAJONALE SI DHE ORGANI	
KËSHILLUES PRANË PREFEKTIT TË QARKUT	126
KOMITETI RAJONAL I TURIZMIT	126
VEPRIMTARIA E TASK-FORCE “ PËR LUFTËN KUNDËR KANABISIT”. 127	
ANTITRAFIKIMI E PERSONAVE NË QARKUN FIER (KRAT)	128
VI. REKOMANDIME.....	130
VII. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2023	131
VIII. BURIMI I INFORMACIONIT.....	134

I. RAPORTIM DHE INFORMIM NË USHTRIM TË FUNKSIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT

Në drejtim të garantimit të zbatimit të programit të Këshillit të Ministrave në nivel qarku, në veprimtarinë e tij të punës një-vjeçare, institucioni i Prefektit të qarkut Fier ka funksionuar dhe ka ushtruar veprimtarinë në përputhje me ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, me aktet ligjore dhe nënligjore të Këshillit të Ministrave, të Ministrisë së Brendshme dhe të Ministrive të linjës,

Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier në përmbushje të misionit dhe ushtrimit të përgjegjësive gjatë vitit 2022, u fokusua jo vetëm në forcimin e rritjes së rolit të Institucionit bazuar në ligjin për Prefektin e Qarkut, por edhe në forcimin dhe bashkëpunimin real me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Degët Territoriale, Policinë Vendore. Viti 2023 u konsiderua si viti i Përmirësimit të mëtejshëm të punës dhe performancës së Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier, Përmirësimit të shërbimit ndaj qytetarëve duke shërbyer me profesionalizëm dhe me integritet moral si dhe shqyrtimi i ankesave dhe kërkesave të qytetarëve, duke i adresuar drejt zgjidhjes ligjore brenda afateve kohore. Veprimtaria e Institucionit u përshkua nga vijimësia e standardizimit, funksionimit të qasjes të marrëdhënieve midis Institucionit të Prefektit të Qarkut në raport me Ministrinë dhe Institucionet e tjera Qendrore ,me Degët Territoriale që veprojnë në qark dhe NJVQV, në drejtimet:

-Rritja e rolit të Prefektit në konsolidimin e imazhit të institucionit nëpërmjet menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

-Rritja e performancës së punonjësve të administratës shtetërore brenda çdo institucioni apo degë territoriale.

Kjo duke u bazuar dhe mbështetur në zbatimin me përpikmëri të:

Ligjit 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut, ligj i cili ka përcaktuar rolin e prefektit si përfaqësues të Këshillit të Ministrave në qark, si garantues i zbatimit të programit të qeverisë në nivel qarku, përgjegjësitet dhe kompetencat e tij për realizimin e këtij misioni;

-Programi i Qeverisë 2021-2025 program i cili në zbatimin e tij, kërkon impenjim, bashkëpunim, koordinim maksimal të këtij institucioni për zbatimin me sukses të reformave të miratuara , si dhe për arritjen e objektivave të vendosura nga qeveria Rama 3.

Institucioni i Prefektit qarku Fier gjatë vitit 2023, ka ndjekur, monitoruar e shqyrtuar veprimtarinë e institucioneve qendrore në nivel vendor, duke bashkërenduar punën, për realizimin e detyrave në përputhje me programin e qeverisë; ka rritur kërkesat ndaj vetes dhe Institucioneve në fjalë duke intensifikuar punën dhe bashkëpunimin me institucionet qendrore në nivel vendor, me Njësitë e vetëqeverisjes vendore, organizatat dhe shoqatat e ndryshme që ushtrojnë aktivitete brenda territorit të qarkut, nëpërmjet shkëmbimeve shkresore, takimeve me drejtues të institucioneve dhe

drejtues të NJVV, ndjekjen e problematikave dhe jo vetëm, me qëllim krijimin e urave bashkëpunuese dhe ndërvepruese për zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë kësaj periudhe.

Gjatë vitit 2023, institucioni i Prefektit të qarkut, ka punuar në

- vijimin e standardizimit të mënyrës së hartimit të urdhrit, shkresës, trajtimit të kërkesave dhe ankesave, dorëzimit të dokumentacionit të prapambetur në AQV, ruajtjen e dokumenteve shkresore, monitorimin e ecurisë së sistemit të dokumentacionit arkivor në vite

Rritjen e bashkëpunimit midis Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, Inspektorateve Shtetërore, Drejtorisë Vendore të Policisë së Qarkut me qëllim parandalimin dhe identifikimin e autorëve në veprat penale si zjarrvënie e qëllimshëm, kultivimi i lëndëve narkotike, prerja e pyjeve, etj.

Hartimin e Planit të Menaxhimit të Emergjencave Civile në shkallë qarku, bazuar në ndryshimet ligjore e udhëzimet e ardhura nga AKMC, duke i kushtuar rëndësi të veçantë analizës së riskut, llogaritjes së forcave dhe mjeteve (të strukturave vendore, strukturave qendrore dhe të të tretëve) dhe skenarëve të ndryshëm sipas probabilitetit të ndodhjes.

-intensifikimin e punës për bashkëpunimin real dhe konkret me strukturat përkatëse për parandalimin, menaxhimin, rehabilitimin e pasojave në rastet e emergjencave civile, drejtimin e task forcave, kontrollin dhe monitorimin e zbatimit në nivel qarku të politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave në bujqësi, arsim, shëndetësi, mjedis, rend publik, shërbim zjarrfikës, ndihmë dhe përkrahje sociale, turizëm dhe kulturë.

Institucioni i Prefektit të qarkut ka bashkërenduar dhe ka siguruar mbështetjen e ndërsjellët të organeve të Policisë së Shtetit, të institucioneve shtetërore në nivel vendor dhe të organeve të Vetëqeverisjes Vendore, për marrjen e masave për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike në nivel qarku.

Në fillim të vitit 2023, janë hartuar planet vjetore sektoriale të punës dhe janë përcaktuar objektivat e institucionit të Prefektit të qarkut.

Në muajin janar të vitit 2023 është hartuar dhe miratuar plani vjetor i punës së institucionit të Prefektit të qarkut si dhe janë përcaktuar prioritetet dhe objektivat e sektorëve dhe të gjithsecilit për realizimin me sukses të të gjithë veprimtarisë së institucionit.

Bazuar në urdhërin 50 të Kryeministrit u hartua për çdo sektor harta e proceseve, regjistri i Riskut dhe u zbatuan detyrat e lëna nga Kontrolli i Auditit të Ministrisë së Brendshme

Gjatë vitit 2023, me prioritet të veçantë janë trajtuar dhe ndjekur të gjitha kërkesat dhe ankesat e qytetarëve të adresuara pranë Prefektit të qarkut. Problematikat dhe shqetësimet e qytetarëve kanë pasur të bëjnë me shërbime të ndryshme dhe detyrime për organet e vetëqeverisjes vendore dhe një numër i konsiderueshëm i tyre për institucionet rajonale vendore.

Një nga shërbimet që institucioni i Prefektit ofron për qytetarët është vërtetimi i dokumenteve të lëshuara për përdorim jashtë vendit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në total përgjatë vitit 2023 numri i legalizimeve ka qenë **10360** copë. Në bazë të urdhrin 10181 datë 28.09.2023, të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile me objekt Kalimi i ofrimit të lëshimit të certifikatave online, bazuar në ligjin 107/2021 Shërbimet Online, ky shërbim nga data 01.10.2023, është reduktuar ndjeshëm, dhe vijon vërtetimi i dokumenteve që ende lëshohen nga Zyrat e gjendjeve Civile në Qark si dhe vërtetime të lëshuara nga Titullarët e Njësive të qeverisjes Vendore. Një vëmendje e veçantë iu është kushtuar ankesave të qytetarëve, të cilat i janë adresuar për zgjidhje njësive të vetëqeverisjes vendore. Nga të gjitha ankesat e trajtuara, të cilat lidhen me ushtrimin e funksioneve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore apo vendimmarrjen e këshillave bashkiakë, vihet re se një pjesë e mirë e tyre kanë marrë zgjidhjen ligjore, por kërkohet një angazhim më i madh nga ana jonë për rritjen e shërbimit ndaj komunitetit, duke ndjekur rrugën deri në dhënien e zgjidhjes përfundimtare të problematikave të tyre nga ana e Institucioneve përgjegjëse.

Prefekti i qarkut organizoi takim me kryetarët dhe nënkryetarët e bashkive edhe mbi bashkëpunimin mes institucionit të Prefektit të qarkut dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

Saj koordinimit të bërë nga institucioni i Prefektit gjatë sezonit pranverë – verë është rritur ndjeshëm **bashkëpunimi** i strukturave operacionale në nivel vendor (MZSH-të) duke i ardhur në ndihmë njëra – tjetrës për përballimin e situatave të shkaktuara nga zjarret gjatë periudhës së verës, në veçanti strukturat e MZSH-së Roskovec dhe Patos, në mbështetje të strukturave të bashkive të tjera. Prefekti në kuadër të koordinimit dhe bashkëpunimit efektiv ka zhvilluar me strukturat vendore të Mbrojtjes Civile përgjatë sezonit pranverë- verë 6 takime me fokus rritjen e gatishmërisë dhe të bashkëpunimit midis strukturave apo edhe çështje të tjera mbi përballimin e situatës së nxehtë të verës. Ka kryer vizita inspektuese në 5 stacionet e shërbimit zjarfikës në bashkitë e qarkut Fier. Duke vlerësuar rëndësinë e situatës ka marrë pjesë drejtpërdrejtë në 11 ngjarje emergjente. Nën koordinimin e Prefektit, referuar kërkesës së bashkisë Patos, kemi angazhuar në një rast forcat operacionale të bashkive të qarkut fqinj, Berat me dy mjete zjarfikës dhe 10 efektivë si dhe në nivel qendror angazhimin e një helikopteri të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Janë organizuar 3 mbledhje të Komisionit të Mbrojtjes Civile, Qarku Fier, si struktura vendore kryesore në fushën e mbrojtjes civile. Gjithashtu, me krijimin e grupit të Whatsapp-it “Komisioni i MC, Fier 2022” është standardizuar dhe strukturuar mënyra e raportimit mbi situatat emergjente në nivel qarku.

STRUKTURA ORGANIKE E ADMINISTRATËS SË PREFEKTIT QARKU FIER.


Për administratën e Prefektit Qarkut për vitin 2023 nuk ka ndryshuar plani i strukturës organike, nga ajo e vitit 2016.

Është në fuqi struktura e ardhur me Urdhër të Kryeministrit Nr. 4 Datë 12.01.2016 e ndërtuar në Sektorë dhe që ka një organikë prej 29 punonjësish.

Si funksion i deleguar është vetëm Arkivat e Gjendjes Civile në Fier dhe dy Nënprefekturat me 3

nëpunës gjithsej

Struktura e Administratës së Prefektit të Qarkut, është si më poshtë:



Struktura organike e Institucionit të Prefektit Qarku Fier ka ndikuar në realizimin e buxhetit, ne 1 janar 2023 kishim vakant 1 nëpunës civil në sektorin e planifikimit dhe mbrojtjes civile, dhe 1 funksionar politik.

Në mars është plotësuar vendi vakant në sektorin e planifikimit dhe mbrojtjes civile aktualisht në periudhë prove dhe ne fund te vitit mbetet vakancë në organike përsëri një pozicion nëpunës civil dhe një funksionar politik , nënprefekti Lushnje.

Më konkretisht sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi i Personelit	Plan	Fakt	Vakant
1	Numri i pozicioneve sipas strukturës se miratuar	32	31	2
	Nga të cilët			
2	Numri i pozicioneve të funksionarëve politik sipas strukturës	3	2	1
3	Numri i nëpunësve civil	23	19	1
	Numri i punonjësve ne periudhe prove		1	0
	Numri i punonjësve me kontrate(ekselent)		2	
4	Numri punonjësve mbështetës	3	3	0
5	Numri gjithsej i punonjësve për funksionet e deleguara	3	3	0
6	Numri i Vendeve Vakante te Shërbimit Civil	0	0	1

- a. **Emëruar nga procedura e lëvizjes paralele:** 0 nëpunës civil.
- b. **Larguar nga procedura e lëvizjes paralele:** 0 nëpunës civil.
- c. **Emëruar nga procedura e pranimit në shërbim civil:** 1 nëpunës civil në periudhë prove.
- d. **Emërim nga VKM për punësimin e ekselentëve:** 0 nëpunës.
- e. **Lirim nga detyra:** 1
- f. **Morën statusin e nëpunësit civil:** 3 nëpunës.

Prioritet i punës për vitin 2023 ka qene azhurnimi i dosjeve të personelit në regjistrin elektronik të punonjësve (HRMIS).

Mbetet objektiv edhe detyrë për shtimin në organike të një punonjësi IT në Institucion për arsye të domosdoshme të shërbimeve kompjuterike dhe mbarëvajtjen e sistemeve online që përdoren në institucion, bazuar në shkresën e Ministrisë së Brendshme nr.7341/1Prot datë 12.07.2023, “Për

njohje dhe zbatim të shkresës me nr.3537prot datë 06.07.2023 të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së informacionit, në bashkëpunim dhe miratim të ministrisë së linjës dhe plotësimi i vakancës.

BUXHETI I INTITUCIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT FIER

Buxheti total me ndryshime i planifikuar për vitin 2023 është 46313 mijë lekë


- **-Të ndara sipas programeve:**

- Administrata e Prefektit, plani fillestar 32499 mijë lekë, me ndryshime 41.639 mijë lekë
- Gjendja civile, si funksion i deleguar plani fillestar 3030 mijë lekë, me ndryshime 3796 mijë lekë. Total plani fillestar 35529 mije
- Total plani me ndryshime për të dy programet është 45435 mijë lekë.


- **Të ndara sipas llojit të shpenzimeve:**

- Paga, shpërblime, të tjera shpenzime personeli 31.786 mijë lekë (70%)
- Kontributi i sigurimeve shoqërore 5413 mijë lekë (12%)
- Mallra & shërbime të tjera (shpenzime operative) 6336 mijë lekë (14%)
- Transferta tek individët 100 mijë lekë (0.22%)
- Shpenzime për investime 1800 mijë lekë (4%)

Në mënyre grafike pesha specifike e zërave të buxhetit ndaj totalit, paraqitet si më poshtë:



Plani i Buxhetit në % Me ndryshime pas Datës 01.01.2023



Realizimi i buxhetit, në 000 lekë


a) **Realizimi i shpenzimeve** sipas programeve paraqitet në mënyrë të detajuar sipas tabelës së poshtëshënuar:

Në total për secilin artikull për të dy programet vjetor:

ARTIKULL I	STRUKTURA BUXHETORE	BUXHET I	REALIZIM I	DIFERENCA	REALIZIMI NË%
600	Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	3178	30101	1685	95 %
601	Kontributi për sigurime shoqërore dhe shëndetësorë	5413	4991	422	92 %
602	Mallra dhe shërbime të tjera	6336	5970	330	94 %
606	Transferta tek individët	100	17	83	17 %

231	Rikonstruksion Godine	1341	1341	0	100 %
231	Pajisje kompjuterike	459	458	1	99.8%
	TOTALI	45435	42878	2557	94.3 %

Ne mënyrë grafike realizimi i buxhetit paraqitet si me poshtë:



Ne total realizimi i buxhetit ne %. Për te dy programet si me poshtë:

- Shpenzimet për paga, shpërblime, shpenzime personeli, janë realizuar 95 %
 - Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, 92 %
 - Mallra dhe shërbime të tjera, 94 %
 - Transferta tek individët, 17 %
 - Investim Rikonstruksion godine 100 %
 - Pajisje kompjuterike 99.8 %
- Për vitin 2023 është realizuar prokurimi "Kancelari" materiale pastrimi në proces siguracione të mjeteve të transportit, shërbime të ndryshme, taksa të mjeteve të transportit, shlyerja e detyrimeve për të tretët për faturat utilitare energji, post, internet, shërbimi i rojeve private etj, është kryer investimi "Rikonstruksion i godinës" Prefekti Qarkut Fier" Pasi kemi bërë të mundur

akordim të fondit për investime në vlerën 1800 000 lekë për rikonstruksion të godinës së institucionit, është përfunduar tenderi dhe investimi brenda afateve ligjore.

Nga kursimi i fondeve pasi fituesi me çmimin me te ulet e ka kryer investimin e planifikuar nga 1800 mije ne 1341 mije me TVSH, pjesa tjetër e fondit diferenca 459 mije ne baze te kërkesës se bere nga ana jone dhe miratim te Ministrisë se Brendshme dhe Ministrisë se Financave me ndryshim destinacioni fondi u prokurua për blerje pajisje kompjuterike. Është ndjekur në vazhdimësi regjistri i prokurimeve me ndryshime deri ne ezaurim te fondeve buxhetore te planifikuara.

Është ulur konsumi i karburantit për makinat e institucionit, në litra .Për vitin 2022 konsumi i karburantit është 2370 litra ne total. Ndërsa vitin 2023 konsumi është 2313 litra , 193 litra ne muaj për te dyja makinat.

-Është siguruar baza materiale e domosdoshme për kryerjen e aktivitetit të institucionit, si edhe kryerja e shërbimeve të tjera si ai i ruajtjes së objektit , i legalizimit te certifikatave etj.

b) Realizimi i të Ardhurave

Institucioni i Prefektit nuk gjeneron të ardhura të mirëfillta për arsye të natyrës institucionale. Të vetmet të ardhura të krijuara gjatë vitit janë të ardhurat e Gjendjes Civile nga taksat e pullave si funksion i deleguar në Institucionin e Prefektit të Qarkut dhe veprimtari si agjent tatimor ku 95% kalojnë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme te Tatimeve në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit dhe vetëm 5% i takojnë institucionit që vepron si agjent tatimor përkatësisht Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

Të Ardhurat si 12 mujor janë realizuar në vlerën 52787 (5%) lekë, krahasuar me vitet e kaluara janë më të ulta si rezultat i shërbimeve online (nënshkrim elektronik) pa taksën e pullës.

2 Përmirësim i Kushteve të punës në këndvështrimin jetësor dhe atë funksional.

Është punuar nga sektori I financës dhe shërbimeve mbështetëse duke bere të mundur sipas buxhetit vjetor të planifikuar për:

- a) Kompletimin e zyrave me orëditë e nevojshme. Pajisje kompjuterike (si kompjutera dhe printera)
Është bërë riformatim i disa njësive kompjuterike, janë pajisur(upgrade nga 4 në 8GB) te gjithë kompjuterat me karta memorie 8 GB
- b) Pajisja me bazë materiale të përditshme për zyrat, po kështu është kryer higjienizimi çdo dite i ambienteve të institucionit, është kryer dhe kontrolluar në mënyrë të rregullt shërbimi me roje private i godinës dhe kamera.
- c) Është punuar për Standardizimin dhe sistemimin e dokumentacionit në zyra dhe në arkivë dhe vazhdimisht është ushtruar kujdesin për mirëmbajtjen e ambienteve te punës.

- d) Është punuar për Mirëmbajtjen e aktiveve të Institucionit, nëpër rritjes së përgjegjësisë menaxheriale të Sektorit të Financës dhe shërbimeve mbështetëse për secilin punonjës të institucionit.

3 Raportimi, saktësimi dhe përditësimi i pronave të paluajtshme sipas listës së inventarit të pronave për Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier.

Ka qenë prioritet i punës bazuar në VKM Nr., 28, datë 27.1.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, si dhe urdhrin të Ministrit të Brendshëm nr. 44, datë 11.4.2023 për zbatimin e VKM nr. 28, datë 27.1.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve.

-Është duke vazhduar praktika e sistemimit të pronave të godinës së Institucionit Fier dhe Lushnjës në inventar të Institucionit të Prefektit Qarkut Fier, pra të statusit juridik të pronës me statusin e përdoruesit faktik dhe saktësimin e përditësimit të pronave të paluajtshme shtetërore për marrjen e certifikatës së pronësisë pasi ishin vetëm me vërtetime hipotekore,

Është përfunduar praktika nëpërmjet E-albanias dhe në bashkëpunim me ASHK dhe MB për Godinën e Institucionit Fier është marrë certifikata e pronësisë jemi në pritje të VKM.

Në zbatim, të VKM Nr. 28, datë 27.1.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, si dhe urdhrin të Ministrit të Brendshëm nr. 44, datë 11.4.2023, “Për zbatimin e VKM nr. 28, datë 27.1.2023 ‘Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, duke ndjekur hapat sipas VKM së përmendur me lart jemi në proces me regjistrimin dhe marrjen e certifikatës së pronësisë për godinën Lushnje, Është hedhur kërkesa në sistem dhe aplikimi në e-Albania për pajisjen me certifikatën e pronësisë, është shlyer detyrimi sipas faturës së gjeneruar në sistemin e-Albania, është bërë saktësimi i gjendjes fizike dhe juridike të pronës me planin e ri të rilevimit dhe i gjithë dokumentacioni plotësues është aplikuar përsëri në e-albania , është përfunduar dosja dhe dërguar me shkresë zyrtarisht në ASHK Lushnje dhe MB, jemi në pritje të certifikatës së pronësisë nga ASHK.

4. Plotësimi i vendeve vakante dhe menaxhimi i burimeve njerëzore sipas aftësive profesionale, përshkrimeve sipas pozicionit dhe arsimit të kërkuar, sipas aftësive profesionale, dhe kritereve të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe me Ministrinë .

Ky objektivi është realizuar:

- a) Duke zbatuar procedurat ligjore mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në lidhje me legjislacionin për nëpunësin civil, emërimin, lirimin, rekrutimin, regjistrimin e lëvizjes së punonjësve, menaxhimin e dosjeve të personelit dhe dhënies së informacioneve eprorëve sipas shkallës së hierarkisë, mbi menaxhimin e burimeve njerëzore. (Raportimi periodik/mujor i informacionit në lidhje me lirimet, emërimet, vlerësimet, masat disiplinore, proceset gjyqësore të nëpunësve civil), duke iu referuar strukturës plan dhe fakt, shpallja e vendeve vakante sipas kriterëve, përshkrimeve dhe arsimit të kërkuar, sipas aftësive profesionale, dhe kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore në fuqi.
- b) *Nëpërmjet Administrimit të sistemit HRMIS*, hedhjes së të dhënave dhe shkresave nga dosja personale fizike në sistemin online,
- c) Në zbatim të ligjit të nëpunësit civil 152/2013, VKM Nr. 833 Datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit, regjistrin qendror të personelit”, VKM Nr. 568 Datë 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave mbi kohëzgjatjen e punës edhe të pushimit për punonjësit e administratës shtetërore”,
- d) Rishikimit të dosjeve të personelit duke i azhurnuar me regjistrin qendror të personelit dhe sistemin HRMIS,
- e) Ngritjen e nivelit profesional të punonjësve nëpërmjet trajnimeve të detyrueshme dhe trajnimeve të tjera nga programe të ndryshme të organizuar nga ASPA.

Për sa i përket personelit mbi nëpunësit civil për vitin 2023 mbetet vetëm një vend vakant i cili është *Përgjegjësi i Sektorit të kompetencave vendore dhe funksioneve të deleguara, edhe pozicioni i nënprefektit Lushnje.(funksionar politik).*

Nga ana tjetër nuk kemi pas asnjë Lëvizje Paralele.

Shtesë kemi vetëm një specialist në periudhë prove në sektorin e Planifikimit dhe Mbrojtjes civile, asnjë masë disiplinore, 3 nëpunës të konfirmuar me statusin e nëpunësit civil. Sa më lart personeli rezulton të jetë pothuajse i plotësuar por edhe i stabilizuar dhe konsiderohet arritje nga Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse sepse ka qenë edhe një ndër objektivat në vite.

- f) Ndjekja e detyrave të urdhrit për Autoritet Përgjegjës dhe komunikimi me ILDKPI.

-Funksionimi i rregullt i EACIDS për plotësimin online të deklaratave të pasurisë për funksionaret politike për ILDKPI dhe dërgimi i raportit vjetor.

ARKIVIMI I DOKUMENTACIONIT

Arkivimi i dokumentacionit, standardizimi i mënyrës së hartimit të shkresës, urdhrit dhe trajtimit të kërkesave dhe ankesave, dorëzimit të dokumentacionit të prapambetur në AQV, ruajtja e dokumenteve shkresore, monitorimi i ecurisë së sistemit të dokumentacionit arkivor në vite.

4. Standardizimi dhe përmirësimi i punës mbi arkivimin e dokumentacionit.

- a. Është bërë standardizimi dhe sistemimi i dokumentacionit arkivor të Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier.
- b. Është punuar për Standardizimin e mënyrës së hartimit të urdhrit, vendimit, udhëzimit, trajtimit të kërkesave dhe ankesave, kthim përgjigjeve dhe arkivimit pas përfundimit të praktikave të ndryshme për përmirësimin e punës në institucion.
- c. Është kërkuar dhe punuar nga Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse(Arkiva) mbi konceptimin e shkresave duke zbatuar me rigorozitet gjuhën shqipe dhe përmirësimin e mënyrës së formulimit të dokumentit.
- d. Është shoqëruar çdo shkresë me kartelën shoqëruese. Është hartuar pasqyra emërtuese e çeljes së dosjeve për dokumentet me afat ruajtje RHK dhe jo RHK.
- e. Kryerja çdo ditë e Regjistrimit të korrespondencës, arkivimit të praktikave të ndryshme, shkresave zyrtare që prodhon institucioni, evidentimi, përpunimi, shpërndarja dhe protokollimi i shkresave që hyjnë dhe dalin nga Institucioni, si dhe shkresave që lëvizin brenda Institucionit.
- f. Dorëzimi ne AQV bëhet sipas kalendarit të miratuar nga DPA.
- g. Është ridërguar kërkesa për dorëzim të dokumenteve RHK për vitin e radhës 2001 pranë DPA, *është hedhur inventari online jemi në pritje të caktimit të datës për dorëzimin fizikisht të dokumentacionit në AQV Lushnje*

II. MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

Marrëdhëniet midis Prefektit të qarkut dhe njërive të vetëqeverisjes vendore përcaktohen në ligjin 107/2016 “Për Prefektin e qarkut” dhe në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Ndërmjet Prefektit të qarkut dhe njërive të vetëqeverisjes vendore nuk ka marrëdhënie varësie. Marrëdhëniet ndërmjet Prefektit të qarkut dhe njërive të vetëqeverisjes vendore bazohen në parimin e konsultimit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

VERIFIKIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE QË JANË DEPOZITUAR NË ZYRËN E PROTOKOLLIT TË INSTITUCIONIT TË PREFEKTIT

Në zbatim të neneve 8 shkronja “a” dhe 16 të Ligjit Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, është kryer verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të njërive të vetëqeverisjes vendore në Qarkun Fier.

Për periudhën janar-dhjetor 2023 nga gjashtë njësi të vetëqeverisjes vendore të nivelit të parë dhe një njësi e vetëqeverisjes vendore e nivelit të dytë Këshilli i Qarkut Fier, në Institucionin e Prefektit të Qarkut janë depozituar dhe shqyrtuar për vlefshmëri ligjore 138 vendime të organeve të njërive të vetëqeverisjes vendore. Janë verifikuar dhe konfirmuar në përputhje me ligjin 133 vendime të këshillave. Janë kthyer në kundërshtim me ligjin 5 vendime konkretisht 3 vendime të këshillit bashkiak Mallakastër, 1 vendim i këshillit bashkiak Patos dhe 1 vendim i këshillit bashkiak Roskovec. Vendimet e verifikuara kanë qenë me natyra të ndryshme. Në fillim të vitit janë verifikuar vendime të tilla si : “Miratimi i kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri 6% për bllok-ndihmën për vitin 2023” (për të gjitha bashkitë), në muajt në vazhdim “Miratimi i përdorimit të fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile për vitin 2023” (për të gjitha bashkitë), “Miratimi PBA 2024-2026” në të gjitha fazat (për të gjitha bashkitë); “Miratimi i shtesave të fondit në buxhet”, “Miratim rishpërndarje fondesh ndërmjet programeve për vitin 2023”; rregullore të ndryshme si : “*Miratimi i rregullores për administrimin dhe funksionimin e varrezave*”; (bashkia Patos) “Miratimi i rregullores të kushteve për tregtimin në markat” (bashkia Lushnje) “Miratimi i rregullores së financimit të projekteve artistiko-kulturore-sportive dhe promovuese” (bashkia Fier), miratimi i kriterëve apo standardeve që lidhen me funksionet që i kanë kaluar këshillit.

Është verifikuar ligjshmëria e disa vendimeve që kishin për objekt plane vendore si: planin vendor të veprimit për energjinë dhe klimën; (bashkia Roskovec); planin social (Bashkitë Roskovec dhe Patos); planin e veprimit të turizmit (Bashkia Lushnje) “Miratimin e strategjisë së transportit publik” (Bashkia Lushnjë); “Miratimin e planit të strehimit social vendor 2023-2028” (Bashkitë

Lushnjë dhe Divjakë); “Miratimin e planit lokal të rinisë 2024-2027” (Bashkia Lushnjë). Gjithashtu janë verifikuar vendimet më lidhje miratimin e disa fazave të PBA 2024-2026, si dhe miratimi i dokumentit përfundimtar të PBA-së për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, miratimi i paketës fiskale për 2024 dhe buxhetet për vitin 2024 nga të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore. Rezulton se paketat fiskale janë miratuar pa ndryshime nga viti i kaluar, gjithashtu janë konfirmuar edhe vendimet e mbledhjes së parë të konstituimit për secilin këshill bashkiak dhe këshillin e qarkut. Nga evidenca e akteve rezulton se për këtë periudhë bashkia me numrin më të madh të akteve normative të depozituara për verifikim ligjor është bashkia Lushnjë me 26 akte normative. Ndërsa Këshilli i Qarkut rezulton me numrin më të vogël të vendimeve të depozituara vetëm 9 vendime. Për vendimet e kthyera nga ana jonë është bërë argumentim ligjor. Janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me sekretarët e këshillave të bashkive por edhe me specialistët sipas kërkesave në funksion të përmirësimit të punës në lidhje me vendimet e këshillave bashkiakë dhe besueshmërinë e tyre ligjore. Nga ana e tij sektori juridik ka bashkëpunuar më sekretarët e këshillave, drejtoritë juridike në bashkitë e Qarkut Fier për evidentimin e saktë të akteve me karakter normativ të cilat duhet të depozitohen nga këto të fundit për verifikim ligjor.


Pasqyra e akteve normative të NJVQV-ve për periudhën janar-dhjetor 2023 është si më poshtë:

N r.	Verifikimi i ligjshmërisë së akteve normative të organeve të qeverisjes vendore										Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve		Dërguar në gjykatë		Vendime të pa konfirmuar në proces për kërkim infor.	
	Njësitet e qeverisjes vendore	Akte të hyra tek Prefekti		Të bazuara në ligj		Të pa bazuara ne ligj		Të rishqyrtuara nga OQV								
		Mujor	Pro	Mujor	Pro	Mujor	Pro	Mujor	Pro	Mujor						
1	Këshilli i Qarkut Fier	0	9	0	9	0	0	0	0	0	6	0	0	0	0	
2	Bashkia Fier	0	22	0	22	0	0	0	0	0	18	0	0	0	0	
3	Bashkia Lushnje	0	26	0	26	0	0	0	0	0	21	0	0	0	0	
4	Bashkia Mallakastër	0	20	0	17	0	3	0	0	0	17	0	0	0	0	
5	Bashkia Divjakë	0	21	0	21	0	0	0	0	0	18	0	0	0	0	
6	Bashkia Patos	0	15	0	14	0	1	0	0	0	13	0	0	0	0	
7	Bashkia Roskovec	0	25	0	24	0	1	0	0	0	20	0	0	0	0	
TOTALI		0	138	0	133	0	5	0	0	0	113	0	0	0	0	

Në funksion të këtij objekti në muajin gusht iu është dërguar bashkive një shkresë lidhur me problematikat e konstatuara gjatë verifikimit ligjor të akteve. Gjithashtu në datë 02.10.2023 është mbajtur një takim konsultativ me sekretarët e këshillave, kryetarët e këshillave, kryetarët e grupeve të këshilltarëve, nënkryetarët e bashkive me objekt:

- Prezantimi i këndvështrimit të Prefektit të Qarkut, në raport me vlefshmërinë juridike të akteve.
- Strukturat e këshillit si mekanizma ndihmues në funksionimin me efikasitet të këshillave bashkiak.
- Problematika të konstatuara në mënyrë të përsëritur gjatë verifikimit të ligjshmërisë së akteve me karakter normativ.

Për periudhën janar-dhjetor 2023, nga gjashtë njësi të vetëqeverisjes vendore të nivelit të parë dhe një njësi e vetëqeverisjes vendore e nivelit të dytë Këshilli i Qarkut Fier, në Institucionin e Prefektit të Qarkut janë depozituar dhe **shqyrtuar për vlefshmëri ligjore 138 vendime** me karakter normativ të organeve të njësisive të vetëqeverisjes vendore. **Janë verifikuar në përputhje me ligjin 133 vendime të këshillave. Janë kthyer jo në përputhje me ligjin 5 vendime.** Vendimet e kthyera jo në përputhje me ligjin kanë pasur si shkak kryesisht shkeljen e ligjit material nga këshilli bashkiak.



Për të gjitha vendimet e depozituara nga NJVQV-të është bërë verifikimi ligjor i thelluar dhe sipas rastit nga sektori juridik është formuluar shkresa përcjellëse me pasqyrimin e argumentimit ligjor për konfirmimin ose jo të këtyre akteve brenda afateve ligjore.

Për sa i përket vendimeve me objekt përdorimin e fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile, janë verifikuar në bashkëpunim me sektorin e emergjencave civile si sektor mbështetës.

Bashkia me numrin më të madh të akteve normative të depozituara për verifikim ligjor është bashkia Lushnjë 26 vendime, Bashkia Roskovec, më 25 vendime me karakter normativ ndërsa Këshilli i Qarkut rezulton me numrin më të vogël 9 vendime me karakter normativ. Bashkia Mallakastër, është bashkia me numrin më të lartë të vendimeve të kthyera në kundërshtim me ligjin me gjithsej 3 vendime. **Këshilli i Qarkut Fier, Bashkia Fier, Bashkia Divjakë dhe Lushnjë nuk kanë vendime të kthyera.** Kurse njësitë e tjera janë si më poshtë:

Bashkia Mallakastër 3 vendime

Bashkia Patos 1 vendim. .

Bashkia Roskovec 1 vendim.



Në çdo rast të kthimit të akteve të njësive të vetëqeverisjes vendore, nga ana jonë është bërë argumentimi ligjor i papajtueshmërive të konstatuara. Janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me sekretarët e këshillave të bashkive por edhe me specialistët sipas kërkesave në funksion të përmirësimit të punës në lidhje me vendimet e këshillave bashkiakë dhe besueshmërisë së tyre ligjore. Nga ana e sektorit juridik është bashkëpunuar me sekretarët e këshillave, drejtoritë juridike në bashkitë e Qarkut Fier për evidentimin e saktë të akteve me karakter normativ të cilat duhet të depozitohen nga këto të fundit për verifikim ligjor.

Standardizimi i dokumentacionit dhe i procedurave nga NJVQV-të në vendimmarrje ka qenë një sfidë edhe për vitin 2022 e cila ka dhënë edhe rezultatet e saj pozitive. Është punuar shumë në drejtim të dokumentacionit që shoqëron vendimet konkretisht në fillim të verifikimit ligjor, është kontrolluar dokumentacioni standard që shoqëron vendimin projektvendim relacion dhe dëgjese

publike kur kërkohet nga ligji. Gjithashtu një vëmendje e veçantë i është kushtuar faktit që dokumentacioni shoqërues të këtë të gjithë elementet formal që kërkohen nga ligji për arkivat dhe rregullorja e brendshme e këshillit bashkiak. Krahasuar me një vit më parë standardizimi i dokumentacionit nga NJVQV-të ka një ndryshim pozitiv të ndjeshëm që duhet evidentuar. Gjatë vitit 2022 ka më pak vendime të kthyer për plotësim dokumentacioni.

VERIFIKIMI NË VEND I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE PRANË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Në zbatim të nenit 17 të Ligjit 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Urdhrit të Kryeministrit Nr. 50, datë 12.04.2017, “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, si dhe urdhit të Ministrit të Brendshëm Nr. 175, datë 9.7.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e institucionit të Prefektit të qarkut” si dhe aneksin 1, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut “është kryer verifikimi në vend i akteve me karakter normativ në mënyrë efektive dhe periodike çdo tre muaj duke garantuar zbatimin e legjislacionit në fuqi përsa i përket verifikimit ligjor të akteve për periudhën dhjetor 2022; Janar-Shkurt 2023; Mars – Maj 2023; Qershor-Gusht 2023. Shtator – Nëntor 2023; Grupi i punës ka mbajtur për çdo verifikim procesverbalin në vend si dhe ka dërguar tek çdo bashki dhe në këshillin e qarkut raportin përfundimtar mbi kontrollin e ushtruar.

Janë verifikuar gjithsej për periudhën janar-dhjetor 113 vendime me karakter normativ.

Nuk janë gjetur akte me karakter normativ të pa depozituara për verifikim ligjor.

Krahasuar me kontrollin e mëparshëm ka përmasim për sa i përket respektimit të procedurës së vendimmarrjes apo respektimit të afateve të njoftimit nga ato NJVQV që iu është lënë rekomandim në kontrollin e mëparshëm.

Nga verifikimi në vend në të gjitha kontrollet periodike që janë kryer në NJVQV-të ka rezultuar se nuk ka akte normative të pa depozituara për verifikim ligjor të Këshillit të Bashkisë/Këshillit të Qarkut si dhe nuk ka akte me karakter normativ të Kryetarit të Bashkisë të pa depozituar për verifikim ligjor.

Përmbushja e funksioneve të Prefektit të parashikuar në Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) për konstituimin e organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore që u krijuan nga zgjedhjet e 14.05.2023.

Ky objektivi ka patur si qëllim zbatimin e procedurave ligjore gjatë konstituimit të organeve të NJVQV-ve.

- Gjatë muajit Janar iu jemi drejtuar zyrtarisht zyrave të gjendjes civile për nr. e popullsisë së datës 1 janar 2023 në çdo bashki.
- Në zbatim të detyrimit ligjor që buron nga ligji Nr. 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, neni 8 shkronja “j” dhe ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) nenet

46 dhe 73 kemi përcaktuar nr. e këshilltarëve për çdo këshill bashkiak dhe nr. e këshilltarëve përfaqësues në këshillin e qarkut për çdo bashki.

- Zyrtarisht, Prefekti iu është drejtuar çdo bashkie, Këshillit të Qarkut, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe për dijeni Ministrisë së Brendshme për nr. e këshilltarëve.
- Në bazë të Ligjit Nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) neni 93 pikat 1 dhe 2; neni 94 pika 1; Vendimit të Komisionit Rregullator Nr.3 datë 09.02.2021 “Për kriteret e caktimit dhe organizimit të vendit të numërimit të votave” neni 4 pika 1 kemi kërkuar nga çdo bashki propozimet lidhur me vendin e numërimit të votave (VNV) për çdo ZAZ, përmbushjen e kriterëve teknike si dhe planimetritë përkatëse.
- Prefekti ka dërguar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe për dijeni Ministrisë së Brendshme listën e VNV-ve të propozuara nga bashkitë si dhe planimetritë përkatëse. VNV-të ishin të njëjtat me ato të zgjedhjeve të mëparshme.
- Sektori juridik ka ndjekur mbledhjen e parë të konstituimit në të gjitha bashkitë e qarkut.
- Sektori juridik ka dërguar informacion të hollësishëm në Kryeministri dhe në Ministrinë e Brendshme për procedurën e konstituimit të NJVQV-ve të nivelit të parë.
- Sektori juridik ka përgatitur kërkesën dhe dokumentacionin e nevojshëm për konstituimin e Këshillit të Qarkut Fier drejtuar Kryetarit të Bashkisë Qendër Qarku Z. Armando Subashi, si dhe ka ndjekur procedurën e konstituimit të këshillit të qarkut. Nga ana jonë është dërguar informacion i hollësishëm në Kryeministri dhe në Ministrinë e Brendshme për procedurën e konstituimit të këshillit të qarkut.
- Sektori juridik ka verifikuar dhe konfirmuar vendimet mbi konstituimin e këshillave bashkiak dhe këshillit të qarkut të mandatuara në zgjedhjet e 14.05.2023.

Ndjekja e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit me përgjegjshmëri, efikasitet dhe në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

Ky objektivi ka si qëllim mbrojtjen e interesave ligjor të institucionit të Prefektit.

Gjatë kësaj periudhe kemi patur vetëm 1 proces gjyqësor në Gjykatën Administrative të shkallës së parë me palë paditëse Z. Enver Kasaj, i paditur: Prefekti i Qarkut Fier, Person i tretë: Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Vlorë

Objekti: *“Detyrimin e institucionit të Prefektit të Qarkut Fier për të trajtuar financiarisht paditësin Enver Kasaj me shpërblim të menjëhershëm në masën e dy pagave referuese mujore dhe pagesë kalimtare në masën 50 për qind të pagës referuese mujore për një periudhë 24 (njëzetë e katër) mujore, sipas përcaktimeve të nenit 12 të ligjit Nr. 10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të forcave të armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”.*

Nga ana jonë është paraqitur kërkesa në gjykatë për kalim procedural, që të zëvendësohej pala e paditur Prefekti i Qarkut me Bashkinë Patos që është edhe institucioni që i kanë kaluar të drejtat dhe detyrimet për këtë ish punonjës të zjarrfikëses. Kërkesa jonë është pranuar nga gjykata. Prefekti i Qarkut Fier ka kaluar në këtë mosmarrëveshje në cilësinë e palës së tretë. Aktualisht ndaj vendimit të në Gjykatës Administrative të shkallës së parë Lushnje kanë ushtruar ankim të dyja palët: pala paditëse Enver Kasaj si dhe pala e paditur Bashkia Patos.

Gjithashtu është përgatitur rekursi për në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të gjykatës Administrative të Apelit në çështjen me pale: Paditës Prefekti i Qarkut, të paditur : Këshilli i Bashkisë Roskovec dhe Bashkia Roskovec person i tretë Avokatura e Shtetit me objekt *“Deklarimin e pavlefshmërisë së aktit nënligjor normativ të Këshillit të Bashkisë Roskovec, vendimit Nr. 21, datë 29.03.2022 “Për një shtesë në vendimin Nr. 93, datë 25.11.2021 ‘Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022” dhe Shfuqizimin tërësisht të vendimit Nr. 21, datë 29.03.2022 “Për një shtesë në vendimin Nr. 93, datë 25.11.2021 ‘Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022”,.*

Rekursi është depozituar pranë Avokatit të Shtetit pasi ky institucion i cili ka tagrin ligjor të vazhdojë procedurën në Gjykatën e Lartë. Nga ana e tij Avokatura e Shtetit na ka bërë me dije që e ka depozituar rekursin për në Gjykatën e Lartë.

Për sa i përket detyrave të tjera:

Specialistja e sektorit juridik Znj. Dorjana Spaho në cilësinë e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka vazhduar përmbushjen e detyrave të ngarkuara nga Ligji Nr. 119/2014 *“Për të drejtën e Informimit”* dhe mbrojtjen e të dhënave personale

Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë vitit 2023 është kujdesur për plotësimin dhe përditësimin çdo tre muaj të regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve.

Gjatë këtij viti janë paraqitur vetëm dy kërkesa me shkrim të cilave iu është kthyer përgjigje (duke sqaruar qytetaret) brenda afateve ligjore.

Gjithashtu të shumta kanë qenë edhe telefonatat të cilat kryesisht kanë pasur për objekt kërkesa apo pyetje mbi gjendjen civile dhe duke koordinuar me punonjës të gjendjes civile është arritur ti jepet zgjidhje në një kohë të shpejt qytetarëve.

Për sa i përket përmbushjes së detyrave në zbatim të funksioneve të deleguara për Prefektin e Qarkut rezulton si më poshtë:

Nga ana e Arkivit të Gjendjes Civile pranë Prefektit të Qarkut gjatë vitit 2023 :

- 1- Janë zbatuar me përpikmëri metodikat e hartuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.
- 2- Janë marrë në dorëzim aktet e lindjeve, martesave dhe vdekjeve për vitin 2022 nga zyrat e gjendjes civile të Qarkut Fier
- 3- Është dhënë shërbim korrekt në zbatim të legjislacionit të Gjendjes Civile, për plotësimin e kërkesave ndaj qytetarëve për marrjen e certifikatave në sportel fizik gjatë periudhës Janar-Shtator
- 4- Është treguar kujdes i veçantë në mirëmbajtjen e regjistrave themeltar dhe të akteve të lindjeve, martesave, dhe vdekjeve të Zyrës së Arkivit të Gjendjes Civile pranë Prefektit të Qarkut Fier pasi ambienti ku janë në ruajtje është në kushte shumë të këqija;
- 5- Janë kontrolluar veprimtaritë e punës në Zyrat e Gjendjes Civile të Njësive Administrative pranë Bashkive të Prefekturës së Qarkut Fier.
- 6- Në bashkëpunim me Zyrat e Gjendjes Civile në të gjithë Republikën e Shqipërisë janë bërë verifikimet e akteve të lindjeve të gjithë personave që janë pjesë në plotësimin e formularit të dekriminalizimit.
- 7- Është ndjekur procesi për përgatitjen e listave zgjedhore gjatë zgjedhjeve vendore të datës 14.05.2023. Të gjitha zyrat e gjendjes civile të Qarkut Fier kanë publikuar listat zgjedhore brenda afateve ligjore.
- 8- Me shkresën Nr. 10181 Prot. Datë 28.09.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile shërbim i gjendjes civile ka kaluar nga sportel fizik në shërbim online nga portali unik qeveritar E-albania;
- 9- Është shkëmbyer në mënyrë të rregullt korrespondenca me institucionet shtetërore dhe personat juridikë privatë;
- 10- Janë ndjekur poceset gjyqësore në mënyrë të rregullt.

Për periudhën Janar- Shtator janë lëshuar në sportele fizike numri i certifikatave si vijon:

- Zyra e Arkivit të Gjendjes Civile pranë Prefektit të Qarkut Fier 14370 certifikata të ndryshme;
- Zyra e Arkivit të Gjendjes Civile Nënprefektura Mallakastër 1986 certifikata të ndryshme;
- Zyra e Arkivit të Gjendjes Civile Nënprefektura Lushnje 2450 certifikata të ndryshme.

Për periudhën Tetor-Dhjetor janë ofruar numri i shërbimeve online si vijon:

- Zyra e Arkivit të Gjendjes Civile pranë Prefektit të Qarkut Fier 3240 shërbimeve të ndryshme;
- Zyra e Arkivit të Gjendjes Civile Nënprefektura Mallakastër 410 shërbimeve të ndryshme;
- Zyra e Arkivit të Gjendjes Civile Nënprefektura Lushnje 950 shërbimeve të ndryshme.

Nga përgjegjësja e sektorit juridik është përgatitur evidenca me verifikimin e akteve normative çdo muaj, planet mujore të punës. Në cilësinë e zyrtarit raportues ka kryer vlerësimin e punës së specialistëve të sektorit juridik që janë pjesë e shërbimit civil për periudhën janar-qershor dhe korrik-dhjetor 2023. Sektori juridik ka hartuar urdhëra të ndryshëm, detyrë e dhënë nga Prefekti.

Nga përgjegjësja e sektorit në bashkëpunim me sektorin e kompetencave vendore dhe sektorin e emergjencave dhe mbrojtjes civile është dërguar çdo të enjte informacion në Ministrinë e Brendshme mbi veprimtaritë më të spikatura në Qarkun Fier. Gjatë gjithë vitit sektori juridik është kujdesur që ushtrimi i veprimtarisë së administratës së Prefektit të Qarkut të bëhet në përputhje me procedurat ligjore duke dhënë

asistencën e nevojshme ligjore. Sektori juridik ka përmbushur të gjitha detyrat që janë ngarkuar nga Prefekti apo Sekretari i Përgjithshëm.

Për periudhën janar-dhjetor 2023 nuk ka detyra të përealizuara apo në tejkalim të afateve ligjore.

III. MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME DEGËT TERRITORIALE DHE INSTITUCIONET SHETËRORE NË NIVEL VENDOR

Në varësi të Krveministrisë janë këto institucione:

AGJENCIA SHETËRORE E KADASTRËS, FIER, LUSHNJË, MALLAKASTËR

Puna e Drejtorisë Vendore, Fier për vitin 2023 paraqitet si më poshtë:

ASHK- FIER RAPORTIMI VJETOR 2023

EMËRTIMI	NR.I PRAKTIKAVE 2022
VKM-827	47
NR. OBJEKTESH ME DOK. TEKNIK TË PËRFUNDUAR DHE VENDIM PER LEGALIZIM (PLANIMETRI,GEN-PLAN)	819
NR. OBJ. TË PARA ME FUNKSION BANIM, TË NDËRTUAR NË TOKË TË VETËDEKLARUESIT	187
AMTP TË REGJISTRUARA PËR HERË TË PARË	1149
CERTIFIKATA PËR TOKËN BUJQËSORE (AMTP TË REJA + TË VJETRA) (pa përfshirë ndarjet e pasurisë, shitjet etj.)	14679
PRAKTIKA TE DALA NE VENDIM PER LEGALIZIMIN VKM-1040	240

Puna e Drejtorisë Vendore Lushnje përfshirë Bashkinë Lushnje dhe Divjakë për vitin 2022 paraqitet si më poshtë:

ASHK Lushnje Raportimi Vjetor 2023	
EMËRTIMI	NR I PRAKTIKAVE
Nr. i certifikatave	2736
Vendim për legalizim	1128
Vërtetim Pronësie	1128
Nr. i AMTP-ve	789

Të gjitha objektivat dhe pritshmërie për vitin 2023 janë të realizuara.

Puna e Drejtorisë Vendore Mallakastër për vitin 2022 paraqitet si më poshtë:

ASHK Mallakastër Raportimi Vjetor 2022	
EMËRTIMI	NR I PRAKTIKAVE
Leje Legalizimi	276
Certifikata	63
Nr. I AMTP-ve	181
Ankesa të trajtuara	15
Aplikime të kryera	1174

Janë protokolluar 726 shkresa, janë kthyer përgjigje Prokurorive, Komisariateve të Policisë, Drejtorive Vendore të Policive, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, etj.

Të gjitha aplikimet për shërbime janë kryer sipas udhëzimit të fundit nëpërmjet e-albania.

Në varësi të Ministrisë së Brendshme janë këto institucione

Drejtoria Vendore e Policisë

Drejtoria Rajonale për kufirin dhe Migracionin

Inspektorati Kombëtar për mbrojtjen e Territorit

DREJTORIA VENDORE E POLICISË

Drejtoria Vendore e Policisë Fier për periudhën Janar-Dhjetor 2023, e orientoi punën e saj bazuar mbi Strategjinë Ndërsektorale të Sigurisë në Komunitet 2021- 2026, dhe aktet normative ligjore që normojnë punën e Policisë së Shtetit.

Prioritetet e këtij institucioni :

Studimi dhe njohja e dinamikës së kriminalitetit në shkallë qarku

Rendi dhe Siguria Publike, Siguria Rrugore dhe partneriteti me Komunitetin

Rikonceptimi i shërbimeve të Qarkullimit Rrugor, me objektiva dhe parametrat e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Rrugore dhe në përputhje me kushtet konkrete të qarkut tonë

Krimet Kundër Mjedisit, Mbrojtja e Regjimit Juridik të Tokës, si ndërtimet pa leje dhe gjithë gama e krimeve mjedisore,

Lufta kundër paligjshmërisë, në territorin që mbulon DVP Fier, dhe Komisariatet e Policisë

Për Janar-Dhjetor të vitit 2023, janë evidentuar **2113** vepra penale, zbuluar **2055**, ose **97.2 %**, janë implikuar **2292** persona, nga të cilët, janë arrestuar **639**, ndaluar **104**, janë ndjekur në gjendje të lire **1461** dhe janë shpallur në kërkim **73**.

Për Janar-Dhjetor të vitit 2022 janë evidentuar **2166** vepra penale, zbuluar **2120**, ose **97.8 %**, janë implikuar **2309** persona, nga të cilët, janë arrestuar **612**, ndaluar **77**, janë ndjekur në gjendje të lirë **1539** dhe janë shpallur në kërkim **88**

Seksionet dhe Komisaritet e Policisë	Janar-Dhjetor 2022									Janar-Dhjetor 2023								
	Evidentuar	Zbuluar	Pazbuluar	%	Arrestuar	Ndalar	Gjenlirë	Keçkim	shuma	Evidentuar	Zbuluar	Pazbuluar	%	Arrestuar	Ndalar	Gj.Lirë	Keçkim	Shuma
Sek. Kri.të Rënda	28	25	3	89.2	19	2	8	1	30	34	32	2	94.1	28	1	6	9	44
Sek. Nark. Trafi	238	238	0	100	80	6	189	16	291	295	295	0	100	96	10	244	9	359
Sek. Kri.Eko. Fin.	555	554	1	99.8	37	6	445	6	494	285	279	6	97.9	24	5	259	4	292
Kom. Pol. Fier.	474	463	11	97.6	193	28	301	33	555	533	526	7	98.6	206	44	315	40	605
Kom. Pol. Lushnje.	262	248	14	94.6	68	18	196	5	287	305	280	25	91.8	76	26	192	21	315
Kom. Pol. Mallaka.	97	95	2	97.9	16	6	82	5	109	102	100	2	98	21	5	82	2	110
Kom. Pol. Divjakë.	87	82	5	94.2	15	7	92	5	119	139	127	12	91.3	21	13	109	1	144
Sek. Pol. Rrugore	425	415	10	97.6	184	4	226	10	424	420	416	4	99	167	0	254	2	423
SHUMA	2166	2120	46	97.8	612	77	1539	81	2309	2113	2055	58	97.2	639	104	1461	88	2292

Siguria Rrugore.

Gjatë Janar-Dhjetor të vitit 2023, nga Sektori Policisë Rrugore janë evidentuar **420** vepra e zbuluar **416**, me Zbulueshmëria

99 %, janë implikuar **423** persona, nga te cilët **167** arrestuar, **0** ndaluar, **254** ndiqen ne gjendje te lire, shpallur në kërkim **2**.

Gjatë Janar-Dhjetor të vitit 2022, nga Sektori Policisë Rrugore janë evidentuar **425** vepra e zbuluar **415**, me Zbulueshmëria **97.6 %**, janë implikuar **424** persona, nga te cilët **184** arrestuar, **4** ndaluar, **226** ndiqen ne gjendje te lire, shpallur në kërkim **10**..

Për këtë periudhe kemi **85** aksidente nga te cilët **22** aksidente me pasoje vdekjen e **22** shtetasve.

Sipas tendencave të veprave penale janë:

Veprat penale	Evidentuar	Zbuluar	Autor	Arrestuar	Ndaluar	Gj.Lir e	Kerkim
Shkelje te rregullave të qarkullimit Rrugor	116	115	120	34	0	83	1
Largim nga Vendi Aksidentit	14	11	11	4	0	6	1
Drejtimi Automjetit ne mënyrë te pa Rregullt	290	290	294	129	0	165	0
Shuma	420	416	423	167	0	254	2

Krahasuar Janar-Dhjetor të vitit 2022 me Janar-Dhjetor të vitit 2023, kemi :

- Ulje te veprave penale me **5** me pak.
- Rritje te zbulues mërisë me **1.4%** me shume

Nga ngjarjet e evidentuara nga Sektori qarkullimit rrugor kanë qenë me pasojë për personat si më poshtë vijon:

Aksidente Rrugore me pasoja për Janar-Dhjetor 2022				Aksidente Rrugore me pasoja për Janar-Dhjetor 2023			
Aksidente me pasoje	Të vrar	Plagosur rëndë	Plagosur lehtë	Aksidente me pasojë	Të vrare	Plagosur Rëndë	Plagosur lehtë
82	28	20	64	85	22	18	91

Krahasuar Janar-Dhjetor të vitit 2022 me Janar-Dhjetor të vitit 2023, kemi :

- Me pasoje vdekjen është **6** me pak.
- Te plagosur rende **2** me pak.
- Të plagosur lehtë **27** me shume.
-

MBROJTJA E SIGURISË SË BRENDSHME, ME QËLLIM PARANDALIMIN E MIGRACIONIT TË PARREGULLT, SI DHE PARANDALIMIN DHE GODITJEN E KRIMIT NDËRKUFITAR.

TOTALI I NGJARJEVE TË EVIDENTUARA PËR PERIUDHË JANAR - NËNTOR 2023.

Gjatë periudhës Janar - Nëntor 2023 në DVKM Vlorë , janë evidentuar **111** (njëqind e njëmbëdhjetë) ngjarje me **116** (njëqind e gjashtëmbëdhjetë) vepra penale, zbuluar **110**, me **130** autorë, ndër këto **24** të arrestuar, **103** ndiqen në gjendje të lirë dhe **3** i shpallur në kërkim.

Gjatë periudhës Janar – Nëntor 2023, në PKK_{të} e DVKM Vlorë, janë evidentuar **20** (njëzet) shtetas të kapur në kërkim, për vepra penale të ndryshme.

Operacione të realizuara në DVKM Vlorë

Janë finalizuar me sukses **9** (nëntë) Operacione Policore, të realizuara nga DVKM Vlorë në bashkëpunimin me DVP Vlorë, Komisariati ne Policisë Kufitare Sarandë, Doganën, Njësinë Speciale për Kufirin dhe Migracionin “Delta”, si dhe Frontex.

Janë realizuar **7 (shtatë)** operacione policore për veprën penale “*Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit*”, **1 (një)** operacion policore për veprën penale “*Kontrabandë me mallra të ndryshëm*” dhe **1 (një)** për, “*Prodhim dhe mbajtje të armëve të zjarrit*”

LEHTËSIMI I QARKULLIMIT LEGAL TË SHTETASVE DHE MALLRAVE

VEPRIMTARIA E PIKAVE TË KALIMIT TË KONTROLLIT KUFITAR, MENAXHIMI I FLUKSIT TË PASAGJERËVE

Një aspekt i rëndësishëm i punës së strukturave të kufirit për këtë periudhë ka qenë dhe kontrolli dhe menaxhimi i hyrjeve-daljeve të pasagjerëve dhe automjeteve në PKK e DVKM Vlorë.

Aktiviteti i DVKM Vlorë, në Pikat e Kalimit Kufitar krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Gjatë 11 – mujorit të vitit 2023, në juridiksionin që mbulon DVKM Vlorë kemi një fluks me **1258761 udhëtarë** dhe **335068 mjete**, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ku kemi një fluks me 893972 udhëtarë dhe 242047 mjete, vihet re që fluksi i udhëtarëve dhe mjete është në rritje përkatësisht me **29 %** për udhëtarët dhe **28 %** për mjetet.

Hyrja e shtetasve të huaj, sipas qëllimit të udhëtimit

Gjatë 11 mujorit të vitit 2023, kemi një ndarje për shtetas sipas qëllimit të udhëtimit në ndarjet si më poshtë vijon:




Tabela 1

Në tabelën nr.1 shikohet qartë që pothuajse në të gjitha ndarjet kemi rritje të konsiderueshme të shtetasve të huaj në hyrje, sipas qëllimit të udhëtimit. Rritje e konsiderueshme vërehet tek shtetasit e huaj në hyrje për turizëm.

Tragete të përpunuara në Hyrje / Dalje

Tragete Shqiptare Hyrje, 2837

Tragete Shqiptare Dalje, 2833

Tragete të Huaja Hyrje, 408

Tragete në Dalje të huaja, 409

Hyrje anije transport mallrash, 93

Dalje anije transport mallrash, 94

Hyrje Jahte/velere turistike, 1527

Dalje Jahte/velere turistike, 1452

INSPEKTORIATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT

IKMT, Drejtoria Rajonale Fier është një institucion i krijuar në varësi të Ministrisë Brendshme.

IKMT Drejtoria Rajonale Fier i ka realizuar objektivat dhe:

ka zbatuar të gjitha urdhërat që kanë ardhur nga IKMT qendër,

planet mujore të punës të hartuara bashkërisht me Drejtorinë Vendore të Policisë Fier, bazuar urdhrin të Task- Forcës Vendore,

ka kryer raportimet periodike javore dhe mujore për realizimin e punës së kryer pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Fier dhe IKMT qendër.

Për vitin 2023, ka marrë 9 masa administrative me gjobë dhe 5 masa administrative të mbajtura me programin unik të inspektimit online.

Tabela e monitorimeve, kontrolleve dhe inspektimeve të kryera sipas sektorëve, periudha Janar-Dhjetor 2023. Tabela e monitorimeve, kontrolleve dhe inspektimeve të kryera periudha Janar-Nëntor 2023.

Fusha Inspektimit/zona /çështja	Mjedisi/Ujëra	Ndërtimi	Pyjet	Totali
Zona me rëndësi kombëtare	3- Inspektime	123 –inspektime për objektet e ndërtimeve në vijën bregdetare të Qarkut Fier.	1	127
Zona Pyjore			40(Inspektime, kontrolle dhe monitorime)	40
Zona të tjera (Urbane/ Rurale/Industriale)	54- Inspektime	97	5	156
Burime Natyrore/ujore	5-Inspektime.	1		6
Shkresa/ankesa/informacion	51	39	29	119
Njoftime të subjekteve të inspektuara për objektet e ndërtimeve në vijën bregdetare të Qarkut Fier.		47- Njoftime bregdetare. 3- Njoftime për ekzekutim vullnetar.		50
Referim në bashkëpunim me Prokurorin Fier dhe DVP Fier	3		1	4
Masat administrative të mbajtura me gjoba	9 masa admn. Me gjobë	15 procesverbale konstatimi	4 masa administrative me gjobë	28
Procesverbal per prishje vullnetare		20		20
Masa administrative plotësuese (Sekuestro)	Sekuestro 3 mjete tip kamion dhe 2 mjete tip Ekskavator			5
totali				555

Në varësi të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë

Dega e Doganës

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit

Drejtorinë Rajonale e Formimit Profesional Publik

Drejtorinë Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave

Institutin e Sigurimeve Shoqërore

Drejtoria Rajonale Tatimore

DEGA E DOGANËS FIER

Objektivi kryesor i degës doganore është mbledhja e të ardhurave doganore si dhe shërbimi sa më profesional i punonjësve ndaj bizneseve dhe individëve.

Analiza e të Ardhurave për periudhën Janar - Dhjetor 2023

- Për vitin 2023 të ardhurat e përgjithshme janë realizuar sipas tabelës së mëposhtme:

Në mijë lek

Nr.	Emërtimi i të ardhurave të përgjithshme	Viti 2022	Viti 2023		Realizimi
			Plan	Fakt	
1	Taksa doganore	203,509	235,199	220,042	94
2	Akciza	761,506	1,121,256	1,019,417	91
3	T.V.SH	2,564,540	2,500,342	2,390,366	96
4	Renta minerare	440	109	112	102
	Totali	3,529,995	3,856,906	3,629,937	94

➤ **Analiza e të ardhurave të përgjithshme për periudhën Janar-Dhjetor 2023**

Gjatë **12 (Dymbëdhjetë) muajve** mbledhja e të ardhurave është realizuar në shumën **3,629,937**, mijë/leke ose e shprehur %, në masën 94% të totalit, planifikuar.

- Për **12 (Dymbëdhjetë)** -Mujorin 2023 janë planifikuar të ardhura për arkëtim në masën **3,856,906 mijë/lekë** dhe është realizuar nga mbledhja e të ardhurave vlera në shumën **3,629,937 mijë/lekë** ose e shprehur %, në masën **94%**.

- Në strukturë krahasimi plan/fakt Gjate **12 (Dymbëdhjetë) mujorit 2023** pasqyrohet i realizuar si më poshtë :

Taksa doganore është realizuar ne masën 94 % ,

Akciza është realizuar ne masën 91 % ,.

Tvsh-ja është realizuar ne masën 96 % e cila zë shifrën me vlere absolute me te madhe.

Renta Minerare është realizuar 102 % por edhe si tregues ne vlere absolute relativisht e ulet

I krahasuar me vitin 2022 realizimi I planit ka një rritje prej 99,942 mijë/leke ose e shprehur ne përqindje 3%.

Shkaqet e mosrealizimit të ardhurave të planifikuara janë si më poshtë :

1.Kryerja e zhdoganimeve në doganat kufitare nga subjektet që ushtrojnë aktivitetin në Qarkun Fier, në vijim të lehtësirave të krijuara nga autoritetet doganore.

2.Planifikimi i lartë i bërë nga ana DPD.

3.Ndryshimi i kursit të monedhave megjithëse janë rritur volume ,është ulur vlera e zhdoganimeve.

4.Shumë subjekte që kanë aktivitete import/eksport të produkte ushqimore kryejnë zhdoganimet në doganat kufitare.

Theksojmë se realizimi i të ardhurave për periudhën 2023 është sipas trendit të realizimit në total për të gjitha Degët Doganore e cila është në shifrën 94%.

- Realizimi i të ardhurave sekondare është si më poshtë:

Në mijë lek

Nr.	Emërtimi I te ardhurave sekondare	Viti 2022	Viti 2023
1	Te ardhura nga shitja e plumbçeve te doganës	345	280
2	Te ardhura nga gjobat e sistemit doganor për importet	2,357	3,836
3	Te ardhura nga kamatëvonesat	91	88
4	Te tjera te ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh	2	0
	Totali	2,796	4,204

Një tregues performance është koha mesatare e zhdoganimit të mallrave të importit dhe për eksportet . Për vitin 2023 koha mesatare është :

-Për e import koha mesatare e zhdoganimit është 52 min

-Për eksportet koha mesatare është 28 min

Problem shqetësues është borxhi i lartë që kanë subjektet ndaj Doganës Fier ,ku gati 95% e kanë operatorët në fushën e produkteve energjetike..

- **Procedurat e Ndjekura për Vjeljen e Borxhit Doganor.**

DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT FIER

Veprimtaria e DRAKPA Fier për vitin 2023 ishte e përqendruar në rritjen e cilësisë së shërbimeve të punësimit ndaj dy kategorive të klientëve si punëkërkues ashtu edhe punëdhënës si edhe në rritjen e shkallës së bashkëpunimit me institucione dhe organizma të tjerë që kryejnë veprimtarinë e tyre në rrethin Fier dhe kanë si objektiv të tyre uljen e nivelit të papunësisë dhe zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të rajonit tonë.

1.Situata e papunësisë së regjistruar.

Numri i të regjistruarve pranë Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit Fier është 25375 persona te ndarë sipas statusit dhe zyrave:

Punëkërkues të punësuar 406 (92 Fieri,87 Lushnja,227 Mallakastra)

Punëkërkues të papunë 6903 (2934 Fieri,2930 Lushnja,1030 Mallakastra)

Pasiv 15628 (8576 Fieri,5359 Lushnja,1693 Mallakastra)

Punëkërkues 2438(1583Fieri,568 Lushnja,287 Mallakastra)


Analiza e punëkërkuesve të papunë të regjistruar.

Për vitin 2023 nr. i punëkërkuesve të papunë të regjistruar është 6903 pupa ,të ndarë sipas zyrave:

Fieri 2943 pupa

Lushnja 2930 pupa

Mallakastër 1030 pupa




Numri i punëkërkesve të papunëve femra të regjistruara është 3738 .

Fieri 1614 pupa

Lushnja 1588 pu pa

Mallakastra 536 pupa



Analiza e të papunëve sipas gjinisë dëshmon se është më i madh numri i të papunëve të regjistruar femra të cilat zënë 54.1% ndërsa të papunëve meshkuj zënë 45.9% të të papunëve të regjistruar gjë e cila tregon se femrat po bëhen më aktive këtij tregun e punës,

Po të shikohet struktura e të papunëve të regjistruar sipas grup moshave vihet re se grup moshat mbi 40 vjeç zënë 68.2% e të papunëve të regjistruar e cila vështirëson tej mase punën për realizimin e ndërmjetësimeve për punësim, pasi të gjithë bizneset kërkojnë të punësojnë mosha më të reja se 40 vjeç.

Të gjithë specialistët nëpërmjet kontakteve me punëdhënësit janë munduar të negociojnë me ta për të bërë të mundur punësimin e pupa-ve që i përkasin këtyre grup moshave .Gjithashtu me këtë kategori punëkërkesish të papunë është punuar intesivisht (nëpërmjet planeve individuale të punësimit) në drejtim të këshillimit për punësim.

Përsa i përket nivelit arsimor :numri më i madh i të papunëve është me arsim 9 vjeçar 56.2% e të regjistruarve dhe për këtë arsye është punuar nga ana jone që nëpërmjet shërbimeve të punësimit të

orientohen këta punëkërkues drejt qendrave të formimit profesional për të marrë një profesion i cili do tu mundësojë këtyre pupa integrimin këtij tregun e punës.


Të ndarë sipas skemave të trajtimit janë:

- përfitojnë pagesë papunësie 496 (196 Fieri,90 Lushnja,203 Mallakastra) pupa
- përfitojnë ndihmë ekonomike 1863(462 ,1136,265) pupa

2.Vendet e lira të punës të ofruara pranë zyrave të punës.

Gjatë vitit 2023 nëpërmjet vizitave në ndërmarrje dhe kontakteve me e-mail dhe telefon të gjithë subjektet janë informuar mbi shërbimet e punësimit që ofron zyra e punës si dhe janë përthithur vendet e lira të punës që ata kanë ofruar .

Si rezultat i vizitave në subjekte, kontakteve me tel ose e-mail është bërë e mundur përthithja e 4978 (2221 Fieri,2626 Lushnja ,131 Mallakastra) vende të lira .



Këto vende të lira janë kryesisht në prodhim veshjesh, këpucësh, tregti etj.

Përthithja e këtyre vendeve ka ardhur si rezultat i punës së mire të specialistëve të shërbimeve dhe ndërgjegjësimit të një pjesë të biznesit të cilët kanë rritur bashkëpunimin me Zyrën e punës dhe kanë krijuar besim në shërbimet cilësore që ofron ky institucion.

Gjatë plotësimit të vendeve të lira kemi hasur probleme me plotësimin e tyre me kandidatin me të mire të mundshëm .Me zhvillimin që ka marrë industria ,kërkohen aftësi të larta profesionale të kandidatëve që duhet të plotësojnë vendet e lira të shpallura. Problematikë në plotësimin e vendeve të lira ka pasur dhe në plotësimin e vendeve të lira ,pasi nuk përpunohet moshën me eksperiencën në punë, kjo sepse shpesh punëdhënësit kërkojnë të punësojnë me një moshë të caktuar dhe me përvojë pune.

Realizimi i treguesve të monitorueshëm për vitin 2023:

1. Janë realizuar 3016 punësime nga 2694 pupa që ishte objektivi ose 112%

Të ndara sipas kategorive kemi:

- Punësime me ndërmjetësim 1213 pu pa nga 1094 pupa që ishte objektivi ose 111 %
- Punësime kategoria gjeti punë vet 1803 nga 1600 pupa ose 113%

Prej totalit të punësimeve.

-Janë punësuar nga ndihma ekonomike 159 pupa nga 74 pu pa që ishte objektivi ose 200 % .

-Janë punësuar nga grupet rome & egjiptian 92 pupa nga 54 pu pa ose 170 % .

-Janë punësuar nga grupi PAK 32 pu pa nga 5 pupa ose mbi 100 %

DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK FIER

Misioni i Drejtorisë Rajonale të Ofrimit të Formimit Profesional Publik është materializimi dhe zbatimi në praktikë i politikave të punësimit të Shtetit Shqiptar me qëllim krijimin e kushteve për aftësim profesional veçanërisht të shtresave në nevojë, duke zgjidhur drejtë moton se : "Rruga drejt punësimit kalon nëpërmjet formimit profesional"

Instruktorët të cilat janë rekrutuar kanë arsim të mesëm profesional dhe eksperiencë të profilit teknik dhe didaktik. Për periudhën janar- dhjetor kemi punësuar instruktorë part-time të cilët japin kurse të unifikuara dhe të veçanta.

Të dhëna statistikore për të certifikuarit për vitin 2023 krahasuar me vitin 2022 janë :

Të dhënat mbi trajnimin e kurseve	Nr. kursantëve 2022	Nr. kursantëve 2023
Të trajnuar gjithsej gjatë periudhës Janar-Dhjetor	908	735

2. Janë përfshirë në programet e nxitjes së punësimit 43 pu pa nga 10 pupa që ishte objektivi.

- Në zbatim të VKM 17 datë 15.01.2020 "Praktikë profesionale " janë miratuar 11 projekte me 43 pupa pjesëmarrës kjo në bashkëpunim me subjektet e mëposhtme:
 1. DR e Shërbimit Social Shtetëror Fier me 4 pupa
 2. Bashkia Lushnje me 2 pupa
 3. Spitali Mallakastër me 1 pupa
 4. Drejtoria e Kujdesit Shëndetësor Mallakastër me 2 pupa
 5. Metro Shoes me 4 pupa
 6. Shkolla Daka me 1 pupa
 7. Sabri Arapi me 1 pupa
 8. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Mallakastër me 3 pupa
 9. Qendra Arsimore Lushnje me 3 pu pa
 10. Bashkia Patos me 13 pu pa
 11. Izet Leshi PF me 1 pu pa
- Në zbatim të VKM nr.114 datë 01.03.2023" Për përdorimin e fondit të kontigjencës për kompensimin financiar të rritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për çdo të punësuar me pagë minimale për shkak të rritjes së kësaj page në shkallë vendi deri më datë 30.09.2023 kanë aplikuar për përfitimin e kompensimit financiar 260 subjekte .

- Fondi total i shpenzuar për zbatimin e kësaj VKM –je është 19605394 lekë.

Në zbatim të VKM nr. 646 datë 05.10.2022 “ Për procedurat ,kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të formimit profesional nëpërmjet mbështetjes financiare të ofruar ,sipas procedurave të konkurrimit për kurset e formimit profesional të organizuara nga institucionet e formimit profesional publike apo private , numri pjesëmarrësve në këtë program është 76 në bashkëpunim me 4 qendra të kurseve të formimit profesional .

- Fondi total i shpenzuar për zbatimin e kësaj VKM –je është 5659712 lekë.

3. Marrëdhënia me sistemin e formimit profesional publike e privat në rajon.

Në rajonin Fier funksionon Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik dhe shume qendra private të trajnimit të cilat ofrojnë kurse si :

Parukeri, gjuhë të huaja, rrobaqepësi, kuzhinë, saldator, elektrikist, asistent zyrash , etj.

Në rrethin Fier janë edhe 3 shkolla të mesme profesionale nga të cilat 2 në Fier dhe 1 në Lushnje. Në këto shkolla ofrohen studime në degët: teknologji informacioni, ekonomik, mobilier agrobiznes, teknologji ushqimore, veterinari, shërbime sociale shëndetësore ,shërbime të mjeteve të transportit ,elektroteknik ,teknologji kimike, agrikulture, hortikulture etj.

- Pjesëmarrës në formim profesional janë 735 pu pa.

Bashkëpunimi me institucionet e tjera.

Gjatë vitit 2023 institucioni ynë ka bashkëpunuar me :

Bashkitë: Fier, Patos, Roskovec, Lushnje , Divjake , Mallakastër dhe Shërbimin Social Shtetëror për të vënë në zbatim plane veprimi të përbashkëta për identifikimin e punëkërkesve të papunë apo dhe persona në nevojë kryesisht nga grupet e veçanta për ti pasur prioritet në punësim e formim.

DREJTORIA RAJONALE E SIGURIMEVE SHOQËRORE

TE ARDHURAT

Të ardhurat në total si DRSSH për vitin 2023 u realizuan në masën **121 %** ose nga 470,500 mijë lekë të planifikuara u realizuan 567,663 mijë lekë, realizuar më shumë 97,163 mijë lekë.

Realizimi i të ardhurave në total dhe me zëra

000/lekë

Totali			Bujku privat			Vullnetari			Të ardhura të tjera		
Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
470,500	567,663	121	425,000	513,558	121	45,500	54,058	119	-	47	

II. REALIZIMI I BUXHETIT

a). Të ardhurat nga **sigurimi vullnetar** u realizuan në masën **119 %**, ose nga 45,500 mijë duke realizuar më tepër 8,558 mijë lekë.

Gjatë vitit 2023 u siguruan në skemën e sigurimit vullnetar 335 persona , nga të cilët 211 ishin kontribues të rinj për herë të parë në skemë.

b). Të ardhurat nga **të vetë punësuarit në bujqësi** janë realizuar në masën **121 %**, duke realizuar më tepër 88,558 mijë lekë.

Gjatë këtij viti u siguruan në skemën e të vetëpunësuarëve në bujqësi 5,812 persona, nga të cilët 1,571 ishin kontribues të rinj për herë të parë në këtë skemë.

b. Analiza e realizimit të shpenzimeve sipas zërave

Shpenzimet e vitit 2022 në total janë realizuar në masën **103.7%**, ose 566 863 mijë lekë më shume se programi i miratuar në buxhetin e rajonit.

III. PËRFITIMET AFATGJATA DHE AFATSHKURTRA

Përfitimet afatgjata

- DRSSH Fier menaxhon **88,885 pensione aktive** ne fund te vitit 2023.
- Janë lidhur gjithsej **5,806 pensione te reja** gjate vitit 2023.

Tabela e numrit te pensioneve te reja te lidhura dhe aktive sipas llojit

Lloji	viti 2023	
	te reja	progresive
Pleqëri	4,768	70,988
Invalid	194	5,803
Familjar	182	3,914
Social	19	273
Suplementar	643	7,907
TOTALI	5,806	88,885

-Në DRSSH Fier gjatë vitit 2023 janë pritur gjithsej 6,346 kërkesa për pension pleqërie, familjar, invalid dhe 25 për pension social.

-Kemi shqyrtuar dhe caktuar ne afat:

- 99 % te pensioneve te pleqërisë

- 98 % pensionet familjare

-89 % pensionet invalidë me date kërkesë dhe 98 % me dt. KMCAP-i.

Kane qene arsye objektive qe kane sjelle pensione te caktuara jashtë afatit, këto ne një numër me te vogël krahasuar me një vit me pare.

-Pensionet ne total janë realizuar 99% brenda afatit .

-Ditët mestare te caktimit te një pensioni ne total janë 32 ditë.

-Në DRSSH Fier janë pritur gjithsej 973 kërkesa ne skemën suplementare.

- Gjate janarit 2023 vazhdoi akordimi i fondit për pensionistet i dy shpërblimeve te fundvitit sipas VKM 752 dhe VKM 897 , përkatësisht 5,000 dhe 8,000 leke
- Ne prill 2023 akordimi i bonusit prej 5,000 leke sipas VKM 187.
- Shpërblimi i fundvitit 2023 për gjithë kategoritë e pensioneve prej 5,000 leke sipas VKM 654 dt. 30.11.2023
- Bonusi sipas VKM 819 dt. 28.12.2023 prej 5,000 leke vetëm për kategorinë e pensioneve familjare dhe invalidë.
- Nga dt.01.10.2023 u be rritja e gjithë kategorive te pensioneve ne masën 8.6% .
- Pensioni social nga 8,588 leke me rritjen nga 1 tetori u be 9,327 leke

Tabela e numrit te pensioneve suplementare te lidhura

Lloji	viti 2023	
	te reja	progresiv
-Ushtarake	136	1,871
-Naftëtarë	504	5,929
-Te tjera	3	107
TOTALI	643	7,907

Përfitimet afatshkurtra

Realizimi i përfitimeve afatshkurta, numër rastesh te reja dhe gjithsej

Lloji i përfitimit	viti 2023	
	Numri i rasteve fizike	
	te reja	gjithsej
Paaftësi e përkohshme nga sëmundjet e përgjithshme	472	524
Paaftësi e përkohshme nga aksidentet ne pune	2	6
Raporte barrë lindjesh	886	1,499
TOTALI	1,360	2,029

IV. ARKIVA E VJETËRSISË SË PUNËS

A- Gjatë vitit 2022 në total janë përpunuar 21742 kërkesa. Nga këto 10808 kërkesa fizike dhe 10 934 kërkesa online. Ecuria e procesit të dixhitalizimit të shërbimeve publike. **9,884 kërkesa** i përkasin kërkesave të kryera nga DRSSH Fier dhe DRSSH e tjera,

Nga këto:

- **6,051 kërkesa** janë për vërtetimin e periudhave të sigurimit nëpërmjet punësimit para datës 01.01.1994,
- **3,833 kërkesa** janë për vërtetimin e periudha vetësigurimit nëpërmjet punësimit pas datës 01.01.1994.

Dhe **924 kërkesa** të ardhura kryesisht prej institucioneve të ndryshme si: Drejtoria e Policisë, Prokuroria dhe Gjykata, kërkesa të avokatëve etj, kthimi i përgjigjeve të të cilave realizohet brenda një kohe 7-10 ditë pune.

B- **10,934 kërkesa** i përkasin kërkesave të pranuar online nga qytetarë të ndryshëm, nëpërmjet portalit e-Albania.

Nga këto:

- **7,291 kërkesa** janë për vërtetimin e periudhave të sigurimit nëpërmjet punësimit para datës 01.01.1994,
- **3,643 kërkesa** janë për vërtetimin e periudhave të sigurimit nëpërmjet punësimit pas datës 01.01.1994.

Realizimi i kërkesave online në DRSSH për Vitin 2022:-28369 kërkesa

Emërtimi	Nr. aplikimesh
	Viti 2023
Aplikime online në DRSSH (pa përfshirë kërkesat për Arkivën e Vjetërsisë së Punës)	21,742

Për t`u ardhur në ndihme qytetarëve për sqarime të ndryshme rreth aplikimeve online dhe shërbimeve në e-albania lidhur me Sigurimet Shoqërore, DRSSH-ja Fier ka vënë në dispozicion edhe 2 numra kontakti. Sot portali e-albania kryen në total 69 shërbime të ndryshme për ISSH-në, nga të cilat në vitin 2022 janë shtuar 2 shërbime te reja :

1. Vërtetim vjetor përfitimi pensioni, me firmë elektronike.
2. Vërtetim negativ përfitimi pensioni , me firmë elektronike.

Për këto vërtetime qytetarit i kthehet përgjigje nëpërmjet portalit në e-albania të llogaria e tij personale, duke mundësuar shkurtimin në kthimin e përgjigjes, pa qenë nevoja e paraqitjes në zyrat e institucionit

DREJTORIA RAJONALE TATIMORE, FIER

Misioni i Drejtorisë Tatimore është mbledhja e të ardhurave tatimore përmes procedurave të thjeshta dhe me kosto minimale, duke zbatuar njëtrajtësisht legjislacionin tatimor, për financimin e buxhetit të shtetit shqiptar.

Plani i të ardhurave tatimore për 12- mujin 2023 është realizuar në masën 101% ose (68,373 mije lekë më shumë se plani).

Tvsh bruto është realizuar në masën 107% ose (122,728 mije lekë më shumë se plani).


Tatim Fitimi është realizuar në masën 104%ose (40,861 mije lekë më shumë se plani).

TAP është realizuar në masën 105% ose (61,502 mije lekë më shumë se plani).


Taksa nacionale është realizuar në masën 69% ose (17,672 mije lekë më pak se plani)

Plani për Kontributet e Sigurimeve për 12-mujorin 2023 është realizuar në masën 98% ose (153,925mije lekë më pak se plani).

Krahasimi Fakt23 vs Plan23 -12 Mujori



Krahasimi Fakt23 vs Fakt22 -12 Mujori



Performanca e TVSH se deklaruar sipas indikatorëve Nëntor 2023 me Nëntor 2022

FDP Totale	Nëntor 2023	Nëntor 2022	Dif.2023-2022	Dif.%
Shitjet total	8,910,760,737	8,981,555,306	-70,794,569	-1%
Shitjet me tvsh	6,108,653,298	6,053,801,645	54,851,653	1%
Blerjet me tvsh	6,278,828,674	6,050,284,164	228,544,510	4%
Teprica	-317,802,115	-253,781,965	-64,020,150	25%
Detyrim	337,537,384	343,276,931	-5,739,547	-2%

Arsyetime lidhur me analizën e strukturës së shitjeve Janar- Nëntor 2023 vs 2022.

Në Janar – Nëntor 2023 shitjet e përjashtuara janë ulur me -8 % krahasuar me 11 mujorin Janar –Nëntor 2022.

Shitjet pa tvsh janë rritur me 315% ne Janar – Nëntor 2023 krahasuar me 11 mujorin Janar – Nëntor2022.

Eksportet e mallrave janë rritur me 15% në Janar – Nëntor 2023 krahasuar me 11 mujorin Janar–Nëntor 2022.

Shitjet e tatueshme (20%) janë rritur me 8 % ne Janar – Nëntor 2023 krahasuar me 11 mujorin Janar–Nëntor 2022.

Shitjet e tatueshme 6% janë rritur me 6 % ne Janar –Nëntor 2023 krahasuar me11 mujorin Janar –Nëntor 2022.

Arsyetime lidhur me analizën e importeve ndikimi I tyre në uljen e tvsh-se për tu paguar.

Importet e mallrave (20%) janë rritur me 8 % ne 11 -mujorin Janar – Nëntor 2023 krahasuar me Janar – Nëntor 2022.

Importet e investimeve me tvsh janë rritur me 10 % ne 11-mujorin Janar –Nëntor 2023 krahasuar me Janar – Nëntor 2022.

Tvsh- ja e detyrueshme për tu paguar është rritur me 12 % ne 11-mujorin Janar – Nëntor 2023 krahasuar me Janar –Nëntor 2022.

Arsyetime lidhur me analizën e Blerjeve të përjashtuara, ndikimi I tyre në uljen e tvsh-së për tu paguar.

Blerje të përjashtuara, TVSH jo e zbritshme/pa TVSH janë rritur me 66 % në 11-mujorin Janar – Nëntor 2023 krahasuar me Janar – Nëntor 2022.

Blerje investimi brenda vendit pa TVSH janë ulur me 20 % ne 11-mujorin Janar – Nëntor 2023 krahasuar me Janar – Nëntor 2022.

Tvsh- ja e detyrueshme për tu paguar është rritur me 12 % ne 11-mujorin Janar – Nëntor 2023 krahasuar me Janar – Nëntor 2022.

Ne varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Fier.

Autoriteti Rrugor Shqiptar, Gjirokastër.

OSHEE, Drejtoria Rajonale Fier.

DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR, FIER

Shërbimet që janë kryer në DRSHTRR Fier për periudhën Janar –Dhjetor 2023.

Nr.	Shërbimi	Aplikime
		Janar-Dhjetor
1	Regjistrimi i Mjeteve	76700
2	Drejtuesit e mjeteve+ Kualifikime profesionale	64 487
3	Taksat	89 184 veprime
4	Kontrolli teknik + veprime të tjera	35 028 veprime

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR, GJIROKASTËR

Drejtorja e Rajonit Jugor Gjirokastrë është një Drejtori që varet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe është krijuar para 12 vitesh pas një reforme rrënjësore, ku i gjithë aktiviteti i mirëmbajtjes së rrugëve realizohet nëpërmjet kontratave të mirëmbajtjes me kompanitë fituese pas procedurave të prokurimit. Sqarojmë se Drejtorja jonë nuk disponon mjete. makineri. manovratore. punëtore. materiale në magazine etj.

Drejtorja e Rajonit Jugor Gjirokastrë ka patur në juridiksionin e saj 5 Qarqe të Jugut të Shqipërisë: Qarku Gjirokastrë, Fier, Vlore, Berat dhe Korçë. Në fund të vitit 2023 u krijua Drejtorja e re e Korçës. DRJGJ ka si aktivitet kryesor ndjekjen, monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të kontratave të mirëmbajtjes së rrugëve.

Akset kryesore nacionale menaxhohen nga ana e Autoritetit Rrugor Shqiptar i cili ka lidhur kontrata afatgjata për mirëmbajtjen e tyre.

Konkretisht për Qarkun e Fierit segmentet rrugore sipas Kontratave janë :

Akset rrugore:

- Kufi Rrogozhine - Fier
- Lushnje - Kufi Berat

Këto segmente janë pjese e Kontratës “C” me Sipërmarrës “2T” shpk,

Akset rrugore :

- Fier- Kufi Vlore
- Levan - Kufi Tepelene
- By Pass Fier

Këto segmente rrugore janë pjese e Kontratës “D” me sipërmarrës “Salillari”,sh.p.k.

Nga ana e kompanive sipërmarrëse gjatë vitit 2023 është punuar përgjithësisht mire në komponentin e mirëmbajtjes rutine dhe ne komponentin e mirëmbajtjes periodike ku janë realizuar punime riparimi te shtresave asfaltike. punime riparimi te veprave te artit dhe punime sinjalistike e sigurie rrugore. Ne raste emergjencash ku kërkohet operativitet, shpejtësi ka patur përmirësim te ndjeshëm në veprimet e kon traktorëve për menaxhimin e situatave emergjente.

Nga këta dy sipërmarrës janë marre gjithashtu masat e nevojshme për përballimin e situatës dimërore .

Pjesa tjetër e akseve mirëmbahen me kontrata 4 - vjeçare dhe përfshijnë segmente me të vogla në gjatësi dhe kryesisht rrugë dytësore. Aktualisht për Qarkun e Fierit akset që janë të mbuluara me kontrata mirëmbajtjeje janë :

- Aksi rrugor K/Cerme - Divjake Plazh
- Jeta e Re - Kosove
- Fier - Seman Plazh + rruga K/Pojan - Apoloni
- K/Patos - Kufi Berat
- K/Patos - Ballsh- Fratar
- Ballsh - Aranitas
- Kr/Rruga Nacionale - Bylis
- Metohasim - Kafaraj

Me kalimin e viteve gjatë aplikimit të këtyre kontratave ka patur një përmirësim të ndjeshëm. Gjatë periudhës dimërore u përballuan me sukses problemet e shkaktuara nga situatat emergjente pas reshjeve intensive të shiut dhe ngricave. Në vazhdim është punuar mirë me punimet e mirëmbajtjes rutine dhe ato periodike. Janë realizuar edhe punime të vogla riparimi. Gjatë vitit 2023 u planifikuar dhe u realizuan punime përmirësuese në elementet funksionale të rrugëve si dhe ne drejtim të sigurisë rrugore.

Në lidhje me projektet ne rrugët në inventar të Drejtorisë sonë janë realizuar disa objekte nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit siç janë:

1. Rikonstruksion rruga K/Cerme - Divjake.
2. Rikonstruksion rruga Roskovec - Poshnje.
3. Rikonstruksion rruga Topojë - Gryke. Etj

Këto objekte janë në periudhe garancie.

Një problem i madh ngelët amortizimi shumë i madh i disa akseve rrugore siç është aksi rrugor K/Patos - Ballsh - Fratar i cili përveç amortizimit kalon dhe në formacione gjeologjike të paqëndrueshme. Nga ana jone është kërkuar investim për rikonstruksionin total të këtij aksi. Gjithashtu edhe aksi rrugor Fier - Seman pjesërisht ka nevojë për rikonstruksionin total.

Përveç bashkëpunimit me strukturat e Prefekturave të Qarqeve. gjatë kësaj periudhe Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastër ka bashkëpunuar me Drejtoritë e Policisë se Qarqeve në varësi në lidhje me problemet e trafikut dhe në rastet e emergjencave rrugore. Bashkëpunim shumë të mire kemi me të gjitha Prefekturat dhe Institucionet Vendore te Qarqeve.

Gjatë kësaj periudhe punonjësit e Drejtorisë së Rajonit Jugor Gjirokastër kanë qenë të mobilizuar për realizimin sa më mirë të detyrave. Po kështu treguesit e planit janë realizuar në mënyre të kënaqshme. Janë kryer të gjitha akordimet me degën e thesarit dhe ARRSH për evidencat e realizimit të buxhetit, te regjistrin të realizimeve etj.

Janë në proces mbyllja e bilancit dhe pasqyrat financiare për vitin 2023 dhe është kryer inventarizimi për aktivet afatgjata dhe afatshkurtra si dhe materialet e konsumit. Janë në proces zbatimi detyrat e lëna nga KLSH. Është në proces regjistrimi i terreneve dhe objekteve të pargjistruara në regjistrat e ZRPP

Misioni: Përbushja e kërkesave të konsumatorëve për furnizim të pandërprerë dhe cilësor me energji elektrike nëpërmjet një shërbimi efikas dhe modern.

Ushtron aktivitetin e saj në Rajonin Jug-Perëndim, me varësi direkte nga Drejtoria e Tensionit të Lartë Tiranë/ Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a) .Mbulon me aktivitetin e saj n/st dhe linja 35kV në prefekturat Gjirokastrë, Vlorë dhe Fier. Në Fier përkatësisht me bashkitë: Fier, Roskovec, Patos, Mallakastër, Lushnjë dhe Divjakë

Objektivi: Qëllimi dhe detyra e OSSH është të sigurojë furnizimin me energji elektrike me cilësi dhe pa ndërprerje tek konsumatorët.

Puna OSSH konsiston në :

Ndjekje dhe raportim defektesh

Parandalimin dhe eliminimin e avarive në N/st dhe linjat 35 kV

Bashkërendim të punës me operatorët e N/st për të pasur një rendiment sa më të lartë në shfrytëzimin e pajisjeve dhe eliminimin e avarive .

Realizimin e humbjeve të energjisë elektrike brenda kufijve të caktuar

Realizimin me cilësi të remonteve sipas grafikut të miratuar për pajisjet e N/st dhe linjave

Zbatimit me korrektësi të rregullores së sigurimit teknik gjatë punimeve .

Punë dhe investime të kryera përgjatë vitit 2023

Punët e kryera

- Janë kryer 83 remonte të planifikuara në linja
- Janë kryer 199 remonte të planifikuara në nënstacione për mirëmbajtjen e tyre
- Janë punuar 109 avari në linja dhe nënstacione, me kohëzgjatje mesatare 1,01 ne nënstacione dhe 1.2 orë në linja.
- Janë montuar 10 matësa në nënstacione
- Janë bërë trajnime për 67 punonjës të rinj si nga sektori i sigurimit teknik ashtu edhe nga sektori i shfrytëzimit dhe i burimeve njerëzore.
- Janë bërë trajnime dhe takime me punonjësit e brigadës dhe operatorët e nënstacioneve për ditën e sigurimit teknik dhe testimin e mjeteve të punës.
- Janë bërë kontrole mujore në të gjithë nënstacionet e rajonit tonë, përkatësisht 55 n/st në lidhje me plotësimin e librave, prezencën në punë dhe mirëmbajtjen e nënstacionit.

Investimet e kryera

Gjatë vitit 2023 janë kryer punime të rëndësishme për përmirësimin e gjendjes së nënstacioneve dhe linjave 35kV të cilat kanë ndikuar në rritjen e sigurisë së furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike. Janë kryer:

- Zëvendësimi i Rrymës dhe izolatorëve në çelësat e linjave Pojan - Fier 220kV dhe Pojan-Hoxharë në N/Stacionin Pojan në datë 06.02.2023
- Zëvendësimi i Rrymës dhe izolatorëve në celën e TR.Fuqisë në N/Stacionin Pojan në datë 07.02.2023
- Zëvendësimi i Rrymës dhe pajisja me mbrojtje e celsit 35kV të linjës Kafaraj-Povelcë në N/Stacionin Kafaraj në datë 21.02.2023
- U bë pajisja me mbrojtje e celsave 35kV të TR të Fuqisë dhe të linjave Poçem - Kocul dhe Poçem - TEC Ballsh në N/Stacionin Poçem.

U bë zhvendosja e N/Stacionit Mobile nga Qarri për në Borsh për sezonin turistik 2023

- U bë fuqizimi i N/Stacionit Radhimë me një Tr.Fuqie 3.2MVA në kuadër të masave të marra për sezonin turistik 2023.
- Janë kryer investime në sistemin e matjes nëpër n/st i cili konsiston në ndërrimin e transformatorëve të rrymës, transformatorëve të tensionit si dhe vendosjen e matësve të rinj elektronik

Nyjet kritike që vijnë si pasojë e amortizimit të pajisjeve në nënstacione dhe linja mbeten :

- 1- Zëvendësimi i çelësve 110kV të transformatorit të fuqisë nr. 1 dhe 2 në n/st Gjirokastrës e Vjetër. Koha e gjatë në punë ka bërë që këto pajisje të dalin jashtë funksionimit. Djegia e sek 1 6kV në n/st lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me mosfunksionimin e çelësit 110kV të transformatorit nr 1-20MVA
- 2- Zëvendësimi i çelësve 110kV të transformatorit nr 1 në n/st e Plasmasit.
- 3- Zëvendësimi i çelësit 110kV të transformatorit 25 MVA në n/st e Jagodinës.
- 4- Zëvendësimi i çelësit 110kV të transformatorit nr 1, 2 dhe 3 në Selenicë.
- 5- Rikonstruksioni dhe ri kompozimi i n/st Shën Vasil.
- 6- Fuqizimi dhe rikonstruksioni i n/st Ardenicë.
- 7- Trakti i ri 110/20kV me Transformator fuqie 40MV 10/20 në nënstacionin e Plasmasit.
- 8- Trakti i ri 35kV me dalje 20kV dhe transformator 35/20kV për të furnizuar Spitalin Rajonal Fier
- 9-Nënstacioni i ri Fieri i Ri 2 110/20kV me fuqi të instaluar 80MV, i nevojshëm për përballimin e ngarkesave në rritje duke parë zhvillimin e rrjetit 20kV
- 10-Fuqizimi i n/st Radhimë duke zëvendësuar TR e fuqisë 7.5MVA me TR fuqie 12 MVA.
- 11-Nevojitet të bëhet ndërhyrje në nënstacionin Kocul për shkak të rrëshqitjes së tokës.

Në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Drejtoria Rajonale Arsimore, Fier

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, FIER

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, Fier ka për mision ofrimin dhe sigurimin e shërbimit arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit Parauniversitar në përputhje me politikat, strategjitë kombëtare dhe kurrikulën e arsimit Parauniversitar me qëllim zhvillimin dhe edukimin e plotë e të gjithanshëm të nxënësit, në mënyrën që të përballojë sfidat e së ardhmes.

DRAP, Fier ka në varësi të saj :

ZVA, FIER

ZVA, LUSHNJE

ZVA , MALLAKASTËR

ZVA, DIVJAKË

ZVA, PATOS

ZVA, ROSKOVEC

Numri i shkollave sipas nivelit arsimor (9-Vjeçare, Mesme, SH.M.B), si dhe shkollat e rikonstruara për vitin 2023 për ZVAP e Qarkut Fier është:

1. ZVAP Fier.

Shkolla 9- vjeçare	41	
Shkolla të mesme	7	
SH.M.B	4	
Shkolla në rikonstruksion	1	“N. Frashëri” vazhdon

2. ZVAP Patos.

Shkolla 9- vjeçare	6	
Shkolla të mesme	1	
SH.M.B	2	
Shkolla në rikonstruksion	1	“M.Shehu” përfunduar

3. ZVAP Roskovec.

Shkolla 9- vjeçare	10	
Shkolla të mesme	1	
SH.M.B	1	
Shkolla në rikonstruksion	2	“Didin Bishani”, “5 Dëshmorët” përfunduar

4. ZVAP Mallakastër.

Shkolla 9- vjeçare	7	
Shkolla të mesme	2	
SH.M.B	1	
Shkolla në rikonstruksion	0	

5. ZVAP Lushnje.

Shkolla 9- vjeçare	25	
Shkolla të mesme	6	
SH.M.B	7	
Shkolla në rikonstruksion	1	“Irakli Bozo” pezulluar për problemeve teknike

6. ZVAP Divjakë.

Shkolla 9- vjeçare	10
Shkolla të mesme	1
SH.M.B	6
Shkolla në rikonstruksion	0

Në IA-të e Qarkut Fier nuk ka problematika me infrastrukturën.

Gjatë vitit 2023 DRAP Fier ka realizuar :

Rritjen e nivelit të drejtimit të institucioneve arsimore dhe fuqizimin e burimeve njerëzore në institucionet e vartësisë.

Mbështetjen fuqimisht të DPAP dhe ASCAP për zbatimin e strategjive dhe politikave reformuese në sistemin e arsimit Parauniversitar.

Realizimin e zhvillimit profesional të mësuesve nëpërmjet bashkëpunimit mes tyre dhe aktorëve të specializuar.

Inspektimin e procesit të punësimit të mësuesve sipas portalit, në bashkëpunim me sektorin e inspektimit dhe kurrikulës dhe me DPAP.

Ndjekjen e procedurave për emërimin dhe shkarkimin e drejtuesve të IA, është ndjekur procedura 100%, por për shkak të mosplotësisë së kriterëve nga kandidatët nuk është finalizuar emërimi i të gjithë drejtuesve.

Verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë.

Verifikimin e regjistrimeve të nxënësve në ZVAP dhe institucionet arsimore para universitare publike dhe private.

Është monitoruar procesi i regjistrimit të nxënësve të rinj nëpërmjet portalit e-Albania dhe sistemit të menaxhimit të informacionit Parauniversitar (SMIP). Në këtë proces DRAP ka përpunuar informacionin drejtpërdrejt nga ZVAP e vartësisë

Ndjekjen e zbatimit të kurrikulës së re.

Monitorimin e procesit të shpërndarjes së teksteve shkollore në ZVAP-të dhe institucionet arsimore publike.

Monitorimin e procesit të provimeve kombëtare në arsimin bazë dhe në Maturën Shtetërore sesioni i parë dhe i dytë dhe vlerësimin e arritjeve në arsimin fillor.

Vlerësimin e procesit të praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit.

Vlerësimin e procedurave të Kartës së Performancës së shkollave në ZVAP-të e vartësisë.

Analizimin e gjetjeve nga inspektimet dhe monitorimet, të cilat do të shoqërohen me rekomandime për përmirësim të punës në institucionet arsimore

Trajtimin e ankesave të mundshme dhe çështjet e dërguara nga Portali i Bashkëqeverisjes.

Zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për mallrat dhe shërbimet ne funksion të përmirësimit të sistemit arsimor.

Në varësi të Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe administrimit te Ujërave

Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor, Lushnjë

Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve Vlore, Sektori Veterinar Qarku Fier

Sektori i Bordit të Kullimit

Autoritetin Kombëtar i Ushqimit

Për vitin 2022 AREB, Lushnje ka patur objektivat si më poshtë:

1.Në ofrimin e informacionit dhe këshillimit për zhvillimin teknik dhe teknologjik të fermave bujqësore , me qëllim rritjen e konkureshmërisë në treg.

2.Në ofrimin e informacionit dhe të asistencës për fermerët dhe subjektet e interesuara për të përfituar nga skemat mbështetëse kombëtare, të programeve dhe projekteve të tjera në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

3.Në nxitjen dhe në ndihmesën për krijimin, organizimin dhe funksionimin e formave të ndryshme të kooperimit të fermerëve .

4.Në organizimin dhe në kryerjen e trajnimit profesional të ekstensionistëve dhe të fermerëve në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural.

5.Në informimin dhe këshillimin e fermerëve për përzgjedhjen dhe përdorimin e makinerive dhe pajisjeve bujqësore.

6.Në sigurimin e informacionit për standardet lidhur me mjedisin, cilësinë, marketingun e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, bujqësinë organike, produktet me tregues gjeografik, etj.

7.Në përdorimin e masmedias për të ofruar informacion të përgjithshëm dhe mesazhe ekstensionit për të gjithë komunitetin e fermerëve dhe për publikun.

8.Në kryerjen e vrojtimit për sistemin e të dhënave të kontabilitetit të fermës dhe në mbledhjen e të dhënave statistikore në fushën e bujqësisë

Realizimi i objektivave për periudhën Janar – Dhjetor 2023 në SEB – Fier.

Gjatë vitit 2023 treguesit e zhvillimit të bujqësisë në qarkun e Fierit në përgjithësi janë pozitivë. Këto arritje janë tregues të punës së specialistëve dhe drejtimit e bashkërendimit të aktiviteteve në nivel sektori. U prodhuan gjithsej **176585 ton** drithëra ose në masën 103.2%, duke realizuar rendimentin mesatar prej **40.1 kv/ha** në kulturën e grurit dhe **72.6 kv/ha** në kulturën e misrit. Prodhimi i perimeve u realizua në masën **543081 ton** ,me rritje të ndjeshme të prodhimit të perimeve në sera. Është prodhuar këtë vit **37700 ton** ullinj ose 86% në krahasim me vitin 2022 (arsye pasi ulliri është kulturë me prodhim periodik), **42630 ton** fruta ose 100.4 % dhe **39176 ton** rrush. Janë prodhuar në nivel qarku **53583 ton** patate dhe **4788 ton** fasule

Prodhimi foragjer është realizuar me **1838885 ton** dhe për rrjedhojë në sektorin e blegtorisë është prodhuar **164256 ton** qumësht i freskët , **28421 ton** mish ose dhe **618 ton** mjaltë ose **128.8 %** krahasuar me vitin 2022 .

Për periudhën Janar-Dhjetor 2023 në Qarkun Fier janë eksportuar **163662 ton** perime dhe fruta, ose duke krahasuar me vitin 2022 në masën 98% . Peshën kryesore e zënë perimet në sera,

si domatja, trangulli, speci, perimet e fushës sidomos bostanoret dhe frutat si pjeshka, nektarina, luleshtrydhe dhe, etj.

Tregjet bujqësore të rajonit të Fierit dhe me gjerë janë furnizuar më mirë nga prodhimet e rreth **3025** fermerëve potenciale. Janë ngritur dhe funksionojnë mbi **58** pika të grumbullimit të frutave dhe perimeve në zonat me intensive të rrethit të Lushnjës dhe Fierit.

Për vitin 2023 ishin planifikuar :

- të realizohen **12 - të programe (objektiva) të ekstensionit** në rrethet Fier, Lushnje dhe Mallakastër.

- në funksion të programeve të planifikuara të ekstensionit të zhvillohen në çdo zonë dhe qendër të informacionit bujqësor **15 aktivitete:**

- **4 demonstrime praktike**
- **1 tryezë e rrumbullakët**
- **10 takime në grupe të fermerëve**

- për realizimin e programeve të ekstensionit të ngrihen **252 grupe të kontaktit** me pjesëmarrjen e **2520** fermerëve .

- të përgatiten edhe **6 tituj të rinj fletëpalosje** .

- për trajnimin e specialistëve në bashkëpunim me QTTB-të e vendit të realizohen **12 - të tema të trajnimeve të hapura**.

- për **trajnimin e fermerëve**, sipas problematikës specifike të çdo zone ekstensionistët të përgatisin dhe zhvillojnë **245** tema trajnimi, në **357** fshatra dhe me pjesëmarrjen e **2503** fermerëve.

- në median lokale të jepen deri **2 informacione në muaj** për problematikën e kohës dhe mesazhe të ekstensionit dhe të realizohet **1 emision TV**.

- për problemet e ekonomisë së fermës të ndiqet përgatitja e **40 buxheteve në fermë**.

Realizimi i objektivave për periudhën Janar – Dhjetor 2023 në SEB – Fier.

Nga monitorimi i aktiviteteve të Sektorit të Ekstensionit Bujqësor Fier të zhvilluara gjatë vitit 2023 janë evidentuar këta tregues:

Nga ekstensionistët e SEB Fier në funksion të realizimit të Planit Vjetor të Ekstensionit janë zhvilluar 327 takime në grupe dhe demonstrime praktike me fermerë që kanë pasur si objektiv për Njohja dhe informimi i fermerëve për masat e financimit, kriteret për aplikim në skemat mbështetëse kombëtare që do të zbatohen gjatë vitit 2023 asistimi i tyre për përgatitjen e projekteve dhe dokumentacionit, Njohuri për sistemin e plehërimit në kulturën e ullirit, Krasitjet formuese dhe prodhuese në pemët frutore bërthamore (pjeshka, kajsia, kumbulla, qershia , etj , Njohja e sëmundjeve dhe dëmtuesve kryesore dhe teknikat e kontrollit të tyre (gomoza, fletëpërdredhësja breshkëzat , etj., Përgjithësimi i përvojave pozitive të fermave të asistuar nga ekstensionisti gjatë vitit 2022, Njohuri për mbrojtjen e ullinjve të rinj nga sëmundjet dhe dëmtuesit kryesore (hundëgjati ullirit, tenjat, tuberkulozi i ullirit, Njohuri për mbarështimin e shpendit në kushtet e fermës, Njohja me konceptet bazë të marketingut bujqësor, Njohja me rrugët për shtimin e plehrave organike, për manipulimin dhe përpunimin e tyre në kushtet e fermës, planifikimi i aktiviteteve në fermë orientimi drejt strukturës optimale për rritjen e të ardhurave, etj. Në këto aktivitete kanë marrë pjesë 2368 fermerë të kontaktit në rrethet Fier, Lushnje dhe Mallakastër.

1. Janë zhvilluar nga specialistët e ekstensionit gjithsej 237 tema të trajnimit me fermerë me 3111 pjesëmarrës në 317 fshatra me problematikë për Trajtimet dimërore në pemëtari. Krasitja prodhuese në vreshta, Shërbimet gjithëvjetore në ulli, Teknologjia e kultivimit të ullirit në fushe, Shërbimet dhe krasitja në drufrutore, Krasitja e vreshtit në prodhim ,Plehërimi në kulturën e domates, Mbjellja dhe shërbimet e perimeve në sera, Krasitja dhe plehërimi i ullirit, Mbrojtja e tokës nga kripëzimi, Operacionet e gjelbërta në vreshta, sëmundjet dhe dëmtuesit e perimeve në sera, Kultivimi i hasëlleve të përziera, Luftimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve në bostanore, Teknologjia e tharjes së barit të thate vitaminoz, Prodhimi i foragjereve kryesore, Teknologjia e kultivimit të lulediellit, Mbarështimi i shpendëve në kushte shtëpie, Dëmtuesit e ullirit dhe masat e luftimit të tyre, Teknikat e ujitjes në kulturat e perimeve në sera, Shërbimet agroteknike në perime, Spërkatja dhe operacionet e gjelbërta në vreshta, Teknologjia e kultivimit në tunel në bostanoreve , farërat me rendimente të lartë, Teknikat e rrallimit të frutave, Luftimi i hirit dhe vrugut në hardhi, Afatet optimale të lënies së jonxhës për fare, Tenja e domates, Kultivarët e rinj në misër, Pemëtaria alternative, Teknologjia e kultivimit të misrit, Luftimi i syrit të palloit në ullinj, Prodhimi i rrushit në sera, Teknologjia e kultivimit të fasules, Monitorimi dhe masat e luftimit të miut të arave ,Mbarështimi i të imëtave për mish dhe remont, Plehërimi organik mineral në ullinj dhe peme frutore, Racioni ushqimor për lopët e qumështit, Teknologjia e të ushqyerit të balancuar e gjedhit për qumësht, Mbarështimi i lopëve për qumësht.
2. Janë realizuar 504 vizita në fermë për të vrojtuar planifikimin në fermë, diagnostikimi i saj me ndihmën e të ardhurave bruto, ku të qartësohet efekti i përfitimit nga përdorimi me efikasitet i faktorëve të tillë si : baza materiale, aplikimi i teknologjive, shfrytëzimi i plotë i kapaciteteve prodhuese të tokës e blegtorisë, ndryshime në strukturën e mbjelljeve dhe kafshëve që mbarështon, përfshirja në procesin e marketingut, etj.

3. Për përdorimin me efektivitet të medias në pasqyrimin e aktiviteteve të ekstensionit dhe përhapjen e mesazheve të ekstensionit te fermerët janë dhënë në median TV lokale 23 informacione për problematikën e kohës dhe mesazhe të ekstensionit.
4. Për ofrimin e informacionit dhe këshillimit për zhvillimin teknik dhe teknologjik të fermave bujqësore me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë në treg, për furnizimin me inpute, tregun, kredi, kooperimin, etj., në 7-të qendrat e informacionit bujqësor në Qarkun e Fierit janë pritur 3178 vizitorë. Ekstensionistët e zonave kanë kryer në terren 5519 takime individuale me fermerë dhe 504 takime me tregtarë inputesh, grumbullues e përpunuesit të prodhimeve bujqësore e blegtorale dhe kanë shpërndarë për fermerët 54 tituj të riprodhuar fletëpalosje me 1186 copë dhe 6 titull të ri me 1453 copë.
5. Përfundoj hedhja në afat e të dhënave statistikore në data bazë për treguesit në nivel ferme të prodhimit bujqësor e blegtoral, të shpenzimeve, të shitjeve, të të ardhurave, investimeve, etj., për 2715 ferma të përzgjedhura nga MBZHR në qarkun e Fierit për Vrojtimin Vjetor Bujqësor për vitin 2022.
6. Në zbatim të programit të trajnimeve të hapura me specialistë bazuar në problematikën e evidentuar, nevojat dhe kërkesat e paraqitura për trajnime nga specialistët, SEB Fier ka përcaktuar tematikën për trajnimet gjatë vitit 2023 që do të zhvillohen në bashkëpunim me specialistët e QTTB-ve dhe të institucioneve të tjera. Gjatë periudhës Janar-Shtator u zhvilluan nga specialistët e QTTB Lushnje 1 temë trajnimi me pjesëmarrjen e 22 specialistëve të SEB Fier me tematikë. Elementë të rinj të teknologjisë së kultivimit të perimeve në mjedise të mbrojtura. Dhe në fushë. U zhvilluan nga specialistët e QTTB Fushë-Krujë 1 temë trajnimi me tematikë, Krijimi I kadastrës së ullirit, Gjatë muajit Korrik u realizua nga QTTB Korçë tema e trajnimit me specialistë me tematikë, “Racat përmirësuese të bagëtive të imta dhe puna racore në vendin tone”, dhe “Rëndësia e përdorimit të suplementeve ushqimorë në të ushqyerit e kafshëve bujqësore “,një ditë fushore në fshatin Levan nga QTTB Shkodër për “Testimi I hibrideve të misrit “me pjesëmarrjen e 25 specialistëve. Gjatë muajit Shtator u realizua nga QTTB Lushnje tema e trajnimit me specialistë me tematikë, ” Teknologjia e kultivimit të trangullit industrial në sera “.me pjesëmarrjen e 25 specialistëve. Gjatë muajit Tetor u realizua nga QTTB Vlorë tema e trajnimit me specialistë me tematikë: “Krahasimi i teknologjive për mbajtjen e ullishtave të zakonshme , intensive dhe super intensive”. Gjatë muajit Nëntor u realizua nga QTTB Fushë-Krujë tema e trajnimit me specialistë me tematikë: “Të ushqyerit dhe sëmundjet metabolike te gjedhi për qumësht”. Gjatë muajit Dhjetor u realizua tema e trajnimit me pjesëmarrjen e 25 specialistëve me tematikë: Mbarështimi i shpendëve në sistemin ekstensiv dhe gjysmë intensive, me QTTB Fushë - Krujë.

7. U realizua evidentimi i 3050 fermerëve intensiv, në rrethet Fier, Lushnje dhe Mallakastër, sipas kriterëve të përcaktuar për aktivitetet në bujqësi dhe blegtori, në nivel fshati, njësie administrative dhe rrethi.
8. Gjatë muajit Prill 2023 u realizua evidentimi i aktivitetit të 58 pikave të grumbullimit të frutave dhe perimeve dhe bimëve aromatike mjekësore, në qarkun e Fierit për kapacitetet magazinuese, frigoriferike, eksportet, tregjet dhe numrin e fermerëve që bashkëpunojnë gjatë vitit 2023.
9. Në zbatim të Udhëzimit Nr. 1, datë 08.01.2021 "Për kriteret , procedurat dhe mënyrën e administrimit të skemës së mbështetjes me naftë për bujqësinë" të MBZHR gjatë muajit Mars janë informuar të gjithë fermerët intensiv, potencial, grupet e interesit dhe subjektet me aktivitet bujqësor, që kanë tokë bujqësore në pronësi dhe kryejnë punime të mekanizuara në kulturat bujqësore, të pajisur me NIPT - fermeri, fermerë të regjistruar në Regjistrin e fermës, etj, nëpërmjet takimeve individuale, takimeve në grupe, vizitave në fermë, njoftimeve me telefon, nëpërmjet medias lokale, etj., duke i njohur me kriteret dhe normativat e përfitimit, afatet dhe procedurat e aplikimit, vlerësimit, përfitimit me naftë për bujqësinë. Në skemat kombëtare të vitit 2023 kanë aplikuar në qarkun e Fierit 18687 fermerë , nga të cilët përfitues 17882 sipas masave

Numri i aplikuesve dhe i përfituesve në Skemat Kombëtare për vitin 2023

Qarku	Emërtimi i masës	Numri i aplikuesve	Numri i përfituesve
FIER	1. Për tufën baze te matrikulluar - Lope	549	526
	2. Për tufën baze te matrikulluar - Dele dhe/ose dhi	342	331
	3. Mbarështimi i bletarisë	358	356
	4. Mbështetje për fara/fidanë dhe inpute-e te tjera	435	331
	5. Fermat Organike	78	22
	6. Identifikimi dhe certifikimi Global GAP	27	1
	9. Mbështetje me naftë për kryerjen e punimeve të mekanizuara	16898	16315
		18687	17882

Gjatë periudhës 20 Mars– 11 Prill 2023 vetëm në zyrat e bujqësisë Fier, Lushnje dhe Mallakastër janë asistuar duke realizuar aplikimet për skemën e naftës për bujqësinë dhe skemat kombëtare për 8800 fermerë. Gjatë muajit Prill-Dhjetor nga 16898 fermerë aplikantë te skema e naftës u krye kontrolli administrativ dhe u dorëzuan kartat e naftës 16315 fermerëve aplikantë.

1. Në kuadrin e evidentimit të subjekteve agropërpunuese me aktivitet në qarkun e Fierit gjatë muajit shkurt u krye listimi i 270 subjekteve agropërpunuese, nga të cilat u përzgjedhën nga ministria 83 subjekte për të cilat u realizua në afat nga specialistët e ekstensionit dhe statistika mbledhja, përpunimi, hedhja në databazë dhe raportimi i të dhënave statistikore në muajin Korrik 2023 pe 6-mujorin e parë dhe po grumbullohen të dhënat për 6-mujorin e dytë, prej të cilave,52 në rrethin e Fierit, 26 në rrethin e Lushnjës dhe 5 në rrethin e Mallakastrës. Janë listuar të gjitha subjektet agropërpunuese me aktivitet në përpunimin e ullirit për vaj, të perimeve dhe frutave, sallameri, mulli bloje e furra buke, prodhim të ëmbëlsirave, stabilimente e baxho për përpunimin e qumështit, prodhim vere, të pijeve jo alkoolike, etj.
2. Në kuadrin e përgatitjes të “Regjistrin të serave” nëpërmjet listimit të të gjithë fermerëve të qarkut Fier që kultivojnë kulturat bujqësore në ambiente të mbrojtura, gjatë muajit prill 2023 u evidentuan rreth 4550 fermerë për sipërfaqet në sera, kulturat e mbjella (perime, luleshtrydhe, agrume, vreshta, etj.), konstruksionin dhe tipin e serës, sistemin e ngrohjes, etj.
3. Në zbatim të Udhëzimit të MBZHR nr.14, datë 20.10.2020, “ Për kushtet dhe mënyrën e mbajtjes së Regjistrin të fermës” ka vazhduar puna në drejtim të plotësimit të regjistrin me të dhëna për identitetin e fermerit, pronësinë e tokës bujqësore, aktivitetin që zotëron, llojin dhe numrin e kafshëve bujqësore, mekanikën bujqësore, etj. ,për 21678 ferma në Qarkun e Fierit.
4. Ndërkohë për tu ardhur në ndihmë tregtarëve të pikave të grumbullimit dhe të tregtarëve me shumicë dhe pakicë të prodhimeve bujqësore e blegtorale si dhe shoqatave të fermerëve, SHBB-ve, grupeve prodhuese dhe fermerëve potencialë për tregtimin e prodhimeve të tyre gjatë muajit Maj përfundoi plotësimi i pasqyrave të parashikimit të potencialeve prodhuese të kulturave bujqësore (fruta, perime, patate, etj.) dhe blegtorale (mish, qumësht, mjaltë, etj.) për treg të brendshëm dhe eksport për vitin 2023 dhe krijimi i një hartë të potencialeve prodhuese për tregun e brendshëm dhe për eksport të 3025 prodhuesve në qarkun e Fierit dhe të grafikëve konvejer për periudhën e daljes së këtyre prodhime bujqësore e blegtorale në treg.
5. U realizua nga specialistët e ekstensionit mbledhja e të dhënave statistikore për parashikim e I-rë dhe të II-të të prodhimit bujqësor dhe blegtoral në nivel bashkie, rrethi dhe qarkut Fier për vitin 2023, përpunimi nga specialistët e statistikës, plotësimi dhe raportimi i pasqyrave në MBZHR brenda afatit të përcaktuar.
6. U krye në afat Vrojtimi Pilot i Sipërfaqes së Mbjellë për 2579 fermat e përzgjedhura në Qarkun e Fierit për vitin 2023,anketimi,kontrolli,hedhja e të dhënave në databazë dhe raportimi në MBZHR.

7. Gjatë muajit Nëntor 2023 në zyrën e bujqësisë Fier, sektori i statistikës u bë hedhja në program e buxhetit të 17 fermave të përzgjedhura dhe raportimi i tyre në MBZHR brenda afatit të përcaktuar gjatë muajit Nëntor.
8. është realizuar çdo ditë dhënia e informacionit mbi çmimet e fruta- perimeve në tregun e shumicës Fier dhe Lushnje.
9. është kryer evidentimi ose konstatimi në teren dhe vlerësimi i dëmeve në bujqësi për shkak të kushteve të motit, ose zjarreve , sipas rastit.
10. Ka vazhduar puna për formalizmin e fermerëve dhe plotësimin e dokumentacionit për pajisjen e tyre me NIPT fermeri. Deri më sot në nivel Qarku kanë aplikuar në DPTT Fier për tu pajisur me NIPT fermeri 33478 fermerë dhe gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023 kanë aplikuar 3657 fermerë.

Planifikimi dhe realizimi i objektivave dhe aktiviteteve për vitin 2023 në SEB Fier :

Nr.	Objektivat	Planifikuar 2023	Realizuar 2023	Gjithsej
		Janar - Dhjetor	Janar - Dhjetor	
1	Objektivat e ekstensionit	18	18	18
2	Aktivitetet e ekstensionit	24	24	24
3	Vizitorë në Qendrat e Informacioni	4000	3178	3178
4	Takime individuale të ekstensionistëve	5000	5519	5519
5	Demonstrime fushore	84	96	96
	Pjesëmarrës	840	907	907
6	Ditë fushore		1	1
	Pjesëmarrës		20	20
7	Takime në grupe & tryeza të rrumbullakëta	238	232	232
	Pjesëmarrës	2380	2202	2202
8	Vizita në fermë	500	504	504
9	Trajnime me specialistë	12	11	11
	Pjesëmarrës	250	271	271

10	Trajnime me fermerë	245	256	256
	pjesëmarrës	2503	2484	2484
11	Emisione dhe rubrika në TV	24	23	23
12	Kërkime në Fermë	2	2	2
13	Demonstrime në Fermë	1	1	1
14	Buxhete në fermë	42	50	50
15	Teknologji të shpërndara te fermerët	280	200	200
16	Fletëpalosje	46	60	60
a.	Tituj të rinj	6	6	6
	Shpërndarë copë	1200	1453	1453
b.	Tituj të riprodhuar	40	54	54
	Shpërndarë copë	800	1186	1186
17	Broshura të MBZHR	10	12	12
18	Fermerë të skemave mbështetëse të vizituar	350	395	395
19	QIB të promovuar gjatë vitit	7	7	7
20	Takime me tregtarë, grumbullues, përpunues.	240	427	427

SEKTORI I BORDIT TË KULLIMIT

Realizimi i punimeve për mirëmbajtje për vitin 2023 është si më poshtë:

Objekte te mirembajtjes ne ujtje	ne leke		Tregues te projektit			Realizimi	
	Vlera per vitin 2022	Bashkia perfituese	m ³ dhera te larguar	km te pastruar/ mirembajtur	ha qe i permiresohet ujtja nga mirembajtja	m ³ dhera	Km
Total ujtje & Kullim	2,765,654		112,001	113	81,750		
Total ujtje	2,765,654		36,000	37.8	27,250	63000	28
Sektori Lushnje	1,310,054		18,000	17	6,450	18000	12
Dega e Lushnjes	749,634	Lushnje	10,300.0	5.8	3,800.0	10300	6
V-1 Dega Terbuf	560,420	Lushnje & Divjake	7,700	11	2,650	7700	6
Sektori Fier	1,455,600		20,000	21.0	20,800	45000	16
Vepra e marjjes ne Selishte	1,310,040	Fier	18,000	1	16,000	30000	1
Sistemi Kurjan-Strum	145,560	Roskovec & Patos & Fier	2,000	20.0	4,800	15000	15
Objekte te mirembajtjes ne kullim (kanale kullues, kanale te ujrave te larta dhe argjimaturo etj)	Vlera per vitin 2022	Bashkia	m³ dhera te larguar	km te pastruar/ sistemuar	ha qe i permiresohen treguesit e kullimit		
Totali Kullim	32,659,180		426,000	37	25,200	310393	19.79
Sektori Lushnje	13,451,680		176,000	27.10	14,700	80403	8.35
KUL Grabian-Gradishte	4,700,445	Divjake	61,500	6.4	2,300		
KUL Golem	1,872,535	Lushnje	24,500	3.00	1,200	24500	2.3
Perroi i Lushnjes	1,375,740	Lushnje	18,000	2.00	2,500	29903	2.05
LUK 3-4-0	1,987,180	Divjake	26,000	6.20	1,300	21916	3.2
LUK 3-4	1,987,180		26,000	4.50	2,000	26000	4
Mbing. argji. Emisarit te Myzeqese	1,528,600	Divjake	20,000	5.00	5,400	19995	3
Sektori Fier	19,207,500		250,000	10.00	10,500	229990	11.44
Kolektori Roskovec-Hoxhare (K-R-H)	13,061,100	Roskovec-Patos-Fier	170,000	5.00	6,000	147000	5.14
KUL Levan-Pojan	6,146,400	Fier	80,000	5.00	4,500	70000	3
Shtrati perbashket Hekal-Mollaj						2990	1.3
Nderhyrje ne Kolektorin e Shushecit,Fr						10000	2

DREJTORIA RAJONALE E VETERINARISË DHE MBROJTJES SË BIMËVE VLORE,SEKTORI VETERINAR QARKU FIER

I- Objektivat e Shërbimit Veterinar:

- 1- Ndjekja e situatës së Influcencës Aviare në fermat dhe stabilimentet e rritjes së shpendëve.
- 2- Ndjekja e situatës së Murtajës Afrikane në fermat dhe stabilimentet që mbarështojnë derra.
- 3- Ndjekja e situatës së Aftes epizotike dhe gjuhës blu.
- 4- Kontrollin e stabilimenteve të mbarështimit të gjedhit për qumësht dhe mish.
- 5- Kontrollin e stabilimenteve të mbarështimit të shpendëve për mish.

- 6- Kontrollin e stabilimenteve të mbarështimit të imtave për qumësht dhe mish.
- 7- Kontrollin e stabilimenteve të mbarështimit të derrave për mish.
- 8- Kontrollin e stabilimenteve të mbarështimit të parqeve të bletëve.
- 9- Kontrollin e stabilimenteve të grumbullimit dhe tregtimit të lëkurëve dhe leshit.
- 10- Kontrollin e depove dhe farmacive veterinare.
- 11- Kontrollin e subjekteve që importojnë kafshe të gjalla (gjedh, të imta, derra dhe shpend).

II-GJETJET DHE MASAT E MARRA:

1/1 Gjatë vitit 2023 nuk kemi pasur asnjë raste pozitiv për Influcencën Aviare (gripin e shpendëve), vazhdojnë monitorimet nga Veterineret Zyrtar të Kontrollit dhe Veterineret Zyrtar të Shërbimit. Gjatë kësaj kohe çdo ditë marrim informacione nga Veterineret e Shërbimit që janë në terren në lidhje me situatën epidemiologjike për zonat që ata mbulojnë. Duke patur parasysh që qarku Fier është qarku që ka numrin më të madhe të stabilimenteve të mbarështimit të shpendit për mish, prioritet i monitorimeve nga ne si Shërbim Veterinar kanë qenë stabilimentet e mbarështimit që kanë numër të madhe shpendësh, shpendët e ujit, zonat lagunore, zonat bregdetare si dhe fermat e oborrit. Çdo ditë Veterineret e Shërbimit të cilët janë në terren japin informacion fermerëve në lidhje me këtë sëmundje për shenjat që ajo shfaq, si duhet të ruhem dhe se kur duhet të njoftohemi ne si Shërbim Veterinar. Në stabilimentet e mbarështimit të shpendëve monitorimi bëhet nga Veterineret e Kontrollit për të evidentuar situatën epidemiologjike, masat e biosiguris nëse janë në nivele të larta si dhe dhënien e informacionit nga ne si Shërbim Veterinar për këtë sëmundje. Mbështetur në programin e mbikëqyrjes sipas muajve janë monitoruar 14 fshatra në qarku Fier.

MURTAJA AFRIKANE

2/2 Nisur nga situata e MAD në rajon Shërbimi Veterinar i Qarkut Fier u njohe me sëmundjen në aspektin teorik nga informacioni i dërguar në mënyrë të vazhdueshme nga AKVMB. Qarku Fier ka një popullacion të madhë për mbarështimin e derrave në ferma të mëdha të mesme dhe të vogla. I gjithë territori i qarkut monitorohet në mënyrë permanente nga Veterineret Zyrtar të Kontrollit dhe Shërbimit. Informacioni është i përditshëm, fermerët që merren me mbarështimin e derrave janë të informuar për këtë situatë, janë të njohur me klinikën dhe ju është bere e ditur që të njoftojnë shërbimin veterinar kure kanë raste ngordhje. Deri me tani janë monitoruar 447 ferma në të gjithë qarkun. Pjesë e monitorimeve dhe dhënies së rëndësishme kanë qenë dhe thertoret të cilat therin derra. Kemi krijuar ura bashkëpunimi me Agjencinë e zonave të mbrojtur që operojnë në brezin pyjor bregdet dhe pyjet në zonat kodrinore ku qarkullojnë dhe derra të egër që janë mbartës të virusit të MDA dhe në rate se konstatojnë derra të ngordhur të njoftojnë menjëherë Shërbimin Veterinar. Ky monitorim do të vazhdojë gjatë gjithë kohës.

Afta epizotike dhe gjuha blu

3/3 Pjese e monitorimeve nga Shërbimi Veterinar janë dhe sëmundjet e aftës epizotike në derra dhe gjuhës blu në gjedh dhe te imta për të cilën jemi mbështetur në strategjinë e ardhur nga Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë Dhe Mbrojtjes Se Bimëve. Fermat të cilat janë monitoruar janë marrë kampione gjaku dhe janë analizuar në ISUV nga të cilat kanë rezultuar negativ.

Fermat e gjedhit

4/4-Në stabilimentet e gjedhit për qumësht dhe mish janë ndjekur plotësimi i standardeve sanitaro-veterinar, rritja e bisigurisë në ferma si dhe dokumentacioni veterinar (regjistrat e fermës, hyrje – dalje, regjistrat e mjekimit dhe dezinfektimit si dhe certifikatat shëndetësore –veterinare të lëvizjes së kafshëve nga ferma në ferme, nga ferma në treg dhe nga ferma në thertore). Monitorimi bazohet në Cheklistat e miratuara nga M. Bujqësisë. Në të gjitha rastet janë lënë detyra për përmirësimin e masave të lartpërmendura, gjithashtu në rastet e përsëritura janë paralajmëruar për masa administrative.

Fermat e shpendëve

5/5-Në stabilimentet e shpendëve për mish është ndjekur situata e Influences Aviare si dhe plotësimin e standardeve sanitaro-veterinare dhe biosigurisë në këto ferma. Gjithashtu janë ndjekur masat profilaktike vaksinimet, dezinfektimet, dokumentacioni veterinar. Janë lënë detyra dhe është tërhequr vëmendja për të mos përsëritur gjetjet në mos plotësim të standardeve sanitaro-veterinare dhe ato të biosigurisë në ferme, për të garantuar një produkt të sigurt për konsumatorin.

Fermat e te imtave

6/6-Në fermat e mbarështimit të të imtave për qumësht dhe mish janë ndjekur të njëjta kontrole bazuara në cheklista tip për plotësimin e standardeve sanitaro-veterinar dhe ato të biosigurisë si dhe dokumentacioni veterinar (regjistrat e mjekimit, të fermës dhe të masave profilaktike). Qëllimi kryesor është ndërgjegjësimi i fermerëve për të zbatuar Ligjin “Për Shërbimin Veterinar” në Republikën e Shqipërisë”, ku vetë fermeri është përgjegjës për mbajtjen e dokumentacionit dhe lëvizjes së kafshëve nga ferma në drejtim të tregjeve dhe thertoreve. Janë lënë detyra dhe janë paralajmëruar për masa administrative kur ka pasur shkelje të kërkesave ligjore.

Fermat që mbarështojnë derra

7/7-Në fermat e mbarështimit të derrave për mish janë ushtruar kontrole për plotësimin e standardeve sanitaro-veterinar dhe ato të biosigurisë dhe dokumentacioni veterinar. Janë kontrolluar në veçanti regjistrat e mjekimeve për respektimin e karencës (kohës së pezullimit) të medikamenteve para se produkti të dalë në treg. Në të gjitha gjetjet janë lënë detyra dhe janë paralajmëruar për masa administrative. Pjese e kontrollit në këto ferma ka qenë dhe sëmundja e murtajës afrikane.

Parqet me blete

8/8-Në parqet e mbarështimit të bletëve me mbi 50 zgjoje që janë dhe përfitues nga skema e subvencionimit plotësimi i standardeve sanitaro-veterinar dhe ato të biosigurisë janë kritere të forta për të siguruar mjalti të shëndetshëm për konsumatorët. Dokumentacioni në stabilimente është kusht i pa tolerueshëm për të përfituar nga skema e subvencionimit. Për të gjitha gjetjet janë lenë detyra dhe janë paralajmëruar për masa administrative.

Subjektet e tregimit të lëkurëve dhe leshit

9/9-Në stabilimentet e grumbullimit dhe tregimit të lëkurëve dhe leshit janë ushtruar kontrole për plotësimin e standardeve sanitaro-veterinar dhe dokumentacioni veterinar. Në qarkun e Fierit nuk kemi fabrika të përpunimit të lëkurëve dhe leshit, por vetëm pika grumbullimi që janë thertoret të cilat grumbullojnë lëkuret që rezultojnë nga therja e kafshëve. Këto lëkura trajtohen me kripe ,mbahen për disa ditë dhe shkojnë në Qendrat e përpunimit. Për të gjitha lëkurat lëshohen certifikata sanitaro-veterinar për të vërtetuar pastërtinë e tyre nga sëmundjet infektive dhe parazitare dhe të mos shërbejnë si përhapës të sëmundjeve.

Kontrolli i farmacive dhe klinikave

10/10-Subjektet e tregimit me shumicë dhe pakice të PMV (medikamenteve) janë objekt i kontrollit të Shërbimit Veterinar. Kontrolli bazohet në cheklistat e miratuara për plotësim të standardeve sanitaro-veterinar dhe dokumentacionit përkatës, ku në themel qëndron certifikata e regjistrimit dhe tregimit, gjithashtu regjistri i blerjeve dhe shitjeve të PMV si dhe kontrolli i rreptë për PMV e ndaluar dhe skaduara. Në të gjitha rastet kur ka patur shkelje janë marrë masa administrative sipas ligjit të shërbimit veterinar. Ndryshe nga vitet e kaluara këto subjekte janë kontrolluar më shpeshë nëpërmjet një urdhëri të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme kjo për të parandaluar shitjen e PMV-ve pa recet apo çdo parregullsi tjetër.

Subjektet e importit

9/9-Subjektet e importit të kafshëve të gjalla i nënshtrohen kontrollit veterinar jo vetëm për plotësimin e standardeve sanitaro-veterinar por edhe për zbatimin e nenit 41 të Ligjit “Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë për karantinën veterinarë”. Qarku Fier është qarku më i madh për importet e gjësë së gjalle. Të gjitha subjektet i nënshtrohen një kontrolli të rreptë duke zbatuar praktikën e futjes dhe daljes nga karantina. Kur shkelet ky nen subjektet penalizohen me masa administrative gjobe dhe në raste përsëritje me pezullim të licencës.

Me poshtë në formë tabelore po ju dërgojmë aktivitetin e këtij shërbimi me numrin e kontrolleve të kryera:

DRVMB		2023	Plani	Realizimi
Nr.		Sektori i Shërbimit Veterinar		
1		Kontroll i farmacive	42	45
1,2		Kontroll I klinikave veterinare	4	4
2		Kontroll i depove farmaceutike	2	2
3	R	Kontroll në ferma gjedhi mbi 5 Krerë	468	468
4	A	Kontroll në ferma të imta mbi 70 krerë	228	228
5	U	Kontroll në stabilimente të derrave	24	24
6	K	Kontroll në stabilimente të shpendëve	56	56
6,1		Kontroll ne stabilimente te akuakultures	-	-
6,2		Kontroll i tregtimit te materialit racor	-	-
7	I	Kontroll i parqeve me bletë mbi 50 koshere	49	49
8	F	Kontroll në tregjet e kafshëve të gjalla	48	48
9	I	Monitorim i programeve të profilaksisë veterinare dhe i sëmundjeve		Ne proces
9,1	N	Monitorim Vaksinimeve PLASJE	-	-
9,2	A	Monitorim i Vaksinimeve REV.	-	Ne proces
10	L	Dërgim mostrash në ISUV në kuadër të Planit Kombëtar të mbetjeve	-	Ne proces
11	P	Kontroll i subjekteve qe tregtojnë produkte me origjine shtazore (Lesh, lëkurë)	8	8
12		Përditësimi i sistemit Ruda		Ne proces
12,1		Raportim i sëmundjeve		Ne proces
12,2		Regjistrim i fermave te reja		Ne proces
13		Matrikullim		Ne proces
13,1	R	Matrikullim gjedhi + therje		Ne proces
13,2	A	Matrikullim të imta		Ne proces
13,3	U	Matrikullim të imta për therje		Ne proces
13,4	K	Matrikullim Derri		Ne proces
14	I	Therje		Ne proces
14,1	F	Gjedh		Ne proces
14,2	I	Të imta		Ne proces

14,3		Derra		Ne proces
14,4	N	Shpendë		Ne proces
15	A	Çregjistrim i kafshëve të therura, eliminuara, ngordhura nga sistemi RUDA	-	-
16	L	Certifikata për lëvizjen e kafshëve		Ne proces
16,1		Certifikata Eksporti Veterinari		20
17	P	Marrje dhe dërgim kampionesh në ISUV për monitorimin e sëmundjeve të programeve të miratuara		Ne proces
18		Marrje dhe dërgim kampionesh në ISUV për konfirmimin e sëmundjeve të dyshuara	ne ndjekje	
19	A	Kontroll i stabilimenteve të importit	ne ndjekje	
20	P	Kontroll i therjeve nga importi	ne ndjekje	
21		Licencime Subjektesh	ne ndjekje	
22		Masa administrative te marra	ne ndjekje	

Misioni kryesor i AKU-së është garantimi i shëndetit të qytetarëve dhe mbrojtja e konsumatorit.

Të vendosë dhe të konsolidojë në vijimësi bazat për sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe interesat e konsumatorit, në të gjitha fazat e prodhimit primar dhe në të gjitha fazat e trajtimit, përpunimit dhe shpërndarjes së ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë. Mbështet punën e vet në Ligjin Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për Ushqimin” i ndryshuar, Ligjin Nr.10433 datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në Nenin 22 të Ligjit Nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” Drejtoria Rajonale e AKU Fier i’u informon mbi situatën për Vitin 2023.Gjatë Vitit 2023 DRAKU Fier ka kryer 2236 inspektime si më poshtë:

Nga këto 1743 inspektime janë kryer në zbatim të planit për vitin 2023 të inspektimeve , dhe 493 inspektime jashtë planit

Janë vendosur :

- 714 masa administrative "Paralajmërim"
 - 41 masa administrative “gjobë” në vlerën 4, 830,000 lekë
- Arsye:
- Mungesë e gjurmueshmërisë së produktit
 - Nxjerrja në treg e ushqimit të pasigurt
 - Mosrealizim i detyrave të lëna nga inspektimi i mëparshëm
 - Mungesë e kundëretiketës në gjuhën shqipe
 - Mosimplementim i planit HACCP
 - Mungesë e licencës për kryerjen e aktivitetit
 - Detyrimet e OBU
 - Mungesë e kushteve higjieno-sanitare

20 bllokime produkti

- 77.86 ton
- 1848.61 litra

6 asgjësime (produkte ushqimore)

- 80.384 ton
- 9.32 litra

2 ndërprerje aktiviteti

*Në zbatim të planit të marrjes së mostrave për Vitin 2023 janë marrë 762 mostra si më poshtë:

mostra qumësht dhe nënprodukte të tij

mostra fruta-perime, miell, vaj ulliri, bukë, produkte peshku

Në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale :

Drejtoria e Spitalit Rajonal

Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror

DREJTORIA E SPITALIT RAJONAL, FIER

74% 12:21 PM

Vjetore 2023.xlsx
XLSX - 102 KB

	A	B	C
2	Aktiviteti spitalit Vjetore 2023		
3			
4	Te shtruar ne spital pa neonat dhe urgjence	11770	
5	Te shtruar ne spital total spitali	49447	
6	Shfrytezim shtrati pa neonat dhe urgjence	27.12%	
7	Shfrytezim shtrati total spitali	54.40%	
8	Dite qendrimi mesatar pa neonat dhe urgjence	2.61	
9	Dite qendrimi mesatar total spitali	1.41	
10	Xhiro shtrati pa neonat dhe urgjence	37.94	
11	Xhiro shtrati total spitali	140.55	
12	Lindje normal	373	
13	Lindje me sexio	623	
14	Lindje gjithsej (normal+sexio)	996	
15	Aborte	363	
16	Operacione gjithsej	2546	
17	Analiza lab.klinik-biokimik	286001	
18	Vizita Poliklinikene e Specialiteteve	120090	
19	Ekografi	22731	
20	Grafi	29318	
21	Scanner	4211	
22	EKG	19301	
23	Mamografi	1173	
24	EEG	423	
25	Spiometri	813	
26	Fundus okuli	1652	
27	Fibrogastroskopi	156	
28	Fibrokolonoskopi	69	
29	katarakta	215	
30	Densitometri	3547	
31	Pacientet qe trajtohen ne urgjence(kartela ditore,mjekime+intervente.vizita dhe urgjencat paraspitalore)	75956	
32	Transferime ne tirane nga urgjenca	550	
33	transferime ne tirane nga sherbimet	158	
34			

aktiviteti i spitalit aktiv. i spitalit me +

Spitali Rajonal Fier ka realizuar të Ardhurat dytësore për realizimin e rikonstruksionit të godinës së maternitetit si dhe ka përgatitur projektin .

NJËSITË VENDORE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Në Qarkun Fier operojnë Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor :

NJVKSH, Fier

NJVKSH, Lushnje

NJVKSH, Mallakastër

NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR FIER

Gjatë kësaj periudhe punonjësit e këtij shërbimi e kanë përqendruar punën e tyre në zbatimin e detyrave të përcaktuara.

Gjatë vitit 2023 Sektori i Higjienës së Ujit të Pijshëm e ka realizuar punën në këto drejtime:

Monitorimi i linjës së jashtme dhe depove në Qafë-Koshovicë.

1. Për qytetin Fier, Patos, Roskovec

a)-Gjatë vitit 2023 janë marrë çdo ditë pune kampionet e ujit të pijshëm në 26 pikat e rrjetit të për analizë Bakteriologjike, Fiziko Kimike. E Hënë e Premte dhe është bërë rregullisht çdo ditë pune 2 herë në ditë monitorimi i klorit të lirë. në ujë në të gjitha pikat e rrjetit

2. Është bërë rregullisht monitorimi i vlerave të klorit të lirë. në ujë në Njësitë Administrative të Bashkisë Fier, Patos, Roskovec

3. • Gjithashtu janë analizuar gjatë muajve ujërat Sipërfaqësorë Lumi Seman ,Vija e Ngjalës, Lumi Gjanicë ,Lumi Vjosë

Sektori: Higjiëna e Punës

Gjatë vitit 2023 është realizuar monitorimi i nivelit të ndotjes së ajrit të jashtëm në pikat fikse të qytetit të Fierit si dhe në pikën fikse të laboratorit.

(për LNP) Është realizuar monitorimi i nivelit të ndotjes së ajrit të brendshëm në Fasoneritë e Bashkisë Fier dhe Patos. (për CO2)

Sektori i Higjienës Fëminore

Gjatë vitit 2023 duke u bazuar edhe në planet mujore të miratuara nga shefi I shërbimit Sektori i Higjienës Fëminore dhe shkollore realizuar detyrat .Monitorim-Vlerësim dhe Ekspertizë në subjektet arsimore publike dhe jo publike me ushqim dhe pa ushqim. Gjatë këtij viti janë realizuar gjithsej 96 monitorime nga të cilat 78 janë monitorime në institucionet publike dhe 18 në jopublike.

Ruajtja e produkteve ushqimore në ambiente higjienikisht të pastra dhe pa lagështirë .

Në fund të monitorim, vlerësim, ekspertizës janë lënë rekomandimet përkatëse lidhur me problematikat e hasura si dhe rikontroll në ato subjekte ku ka patur mangësi.

Sektori i Higjienës Komunale

Gjatë vitit 2023 H. Komunale ka realizuar këto detyra:

Monitorim, vlerësim dhe ekspertizë në lidhje me:

Kanalizimet e ujërave të zeza, si (Puseta, Shimbledhëse) në lagjet e qytetit Fier.

Marrje mostre të kripës për analizë fiziko-kimike.

Hartim ankesash të ardhura nga persona publik në lidhje me ujërat e zeza. Dhe të bardha.

Bashkëpunim me Sektorin e Higjienës Shkollore dhe Fëminore, Sektorin e ajrit në lidhje me detyrat e caktuara.

Kujdesit Shëndetësor Parësor kanë realizuar punën në këto drejtime:

Kujdesi Parësor ka monitoruar punën e kryer nga Qendrat shëndetësore ne Bashkitë Fier, Patos dhe Roskovec.

Janë mbledhur dhe përpunuar informacionet shëndetësore, ditore dhe mujore nga të gjitha Qendrat shëndetësore dhe është kryer raportimi i tyre në kohë në institucionet eprore. Ne te gjitha qendrat shëndetësore është kryer Check- up-i për grup moshën 35- 70 vjeç.

Informacioni rreth Shërbimit Stomatologjikë Publik

Në institucionet e Shërbimit Shëndetësor Stomatologjik publik ofrohet falas shërbimi profilaktik dhe mjekues stomatologjik për:

- a) personat nga mosha 0 deri 18 vjeç
- b) të sëmurët e shtruar dhe ata që trajtohen në institucione spitalore publike për mjekime

urgjence

- c) kategori të veçanta individësh që me ligje dhe akte nënligjore të veçanta, përfitojnë shërbim shëndetësor stomatologjik falas.

NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR, LUSHNJE

NJVKSH Lushnjë për 12–mujorin 2023 ka kryer aktivitetin si me poshtë:

Kontroll mjekësor baze janë planifikuar 23155 persona dhe 24026 e kane kryer.

- Total i vizitave te kryera nga mjeket janë 228096 vizita
- Totali i vizitave te kryera nga infermieret janë 161452 vizita.
- Paciente ne total te referuar tek mjeku specialiste janë 38821 .
- Numri i depistimeve për shëndetin stomatologjik ne total janë 13277 vizita 0-18 vjeç.
- Kemi hedhur kurbat e rritjes ne sistem
- Edukimi shëndetësor dhe promocioni kane kryer 135 aktivitete me numër pjesëmarrësish 5000.
- Janë plotësuar dosjet e infermiereve për rilicensim
- Janë bere kërkesat për regjistrim ne ASCK dhe hedhjen e krediteve ne sistem .
- Është bere raportimi i sistemit LMIS ne ISHP
- Numri i rasteve te reja me Diabet janë 340.
- Numri i lindjeve deri tani 332
- Numri i aborteve 90
- Përgjatë 9-mujorit 2023 shërbimi i shëndetit mendor ka realizuar 94 aktivitete sensibilizuese duke e vënë theksin tek roli i shëndetit mendor në mirëqenien psiko-sociale dhe fiziologjike. Disa prej temave të trajtuara janë: rëndësia e shëndetit mendor, inteligjenca emocionale, rëndësia e vaksinimit nga covid. Në këto aktivitete janë përfshirë kategori të ndryshme të individëve, në varësi të temës. Kjo me qëllim përfshirjen e target grupeve të ndryshme për të përfituar nga ky shërbim. Gjithashtu janë realizuar 158 seanca këshillimi me qytetarë të cilët kanë marrë shërbimin psikologjik pranë zyrës së shëndetit mendor.

Aktiviteti i Shërbimit të Epidemiologjisë dhe Shëndetit Mjedisor

Vjetore 2023

- 1- Marrja e të dhënave nga Qendrat Shëndetësore, dy Urgjencat e Spitalit Lushnje (ALERT), dhe dërgimi i tyre në ISHP dhe DROShKSh, çdo javë.
- 2- Përpunimi i të dhënave të marra nga dy urgjencat e Spitalit, Qendrat Shëndetësore (14 Sh) dhe dërgimi i tyre në ISHP, në fillim të çdo muajit.
- 3- Analizimi i rasteve me Sëmundje Infektive të denoncuara nga mjekët e familjes, laboratorët private dhe Spitali i Lushnjes çdo ditë.
- 4- Monitorimi i rasteve me **Hepatit B 139, Hepatit C 18, Varicel 134, Erizipel 5, TBC pulmonare 15, Salmonel 1, Gripp 116, COVID - 19 pozitiv 793, Gastroenterite 2121.**
- 5- Kontroll në Laboratorët Private dhe Shtetërore, çdo javë.
- 6- Testimi, monitorimi dhe raportimi çdo ditë, çdo javë dhe çdo muaj i rasteve suspekt dhe pozitive për COVID-19 si dhe sëmundjet e tjera infektive të detyrueshme për tu raportuar (mbështetur në urdhërin 632 të datës 29.08.2018 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale)

- 7- Testime në total për Covid-19 janë kryer 4792.
- 8- Kontakt i përditshëm me Zyrën Arsimore Lushnje dhe Zyrën Arsimore Divjakë për Covid-19 pozitiv dhe sëmundjet e tjera infektive në institucionet shkollore.
- 9- Monitorimi dhe raportimi i të dhënave çdo ditë, çdo javë dhe çdo muaj të procesit të vaksinimit rutinë, vaksinimit anti-COVID , vaksinimit anti- Gripp si dhe vaksinimit HPV
- 10- Monitorimi dhe promovimi për vaksinimin anti-COVID, vaksinimit anti- Gripp si dhe vaksinimit HPV në Ambulanca, Qendra Shëndetësore, Institucionet Shtetërore
- 11- Vaksina anti-covid që nga fillimi i procesit janë kryer 127333 doza , ndërsa për vitin 2023 janë kryer në total 675 doza.
- 12- Vaksina anti-gripp deri në dhjetor 2023 janë kryer 13232 doza.
- 13- Mbulesa vaksinale për vitin 2023 është 99%.
- 14- Aktivitetet promovimi për imunizimin rutinë me prindërit refuzues dhe hezitues
- 15- Lëshimi i kartelave të vaksinimit për jashtë shtetit
- 16- Ndarja e vaksinave për Qendra Shëndetësore fshat, qytet dhe materniteti
- 17- Testimi Mikrobiologjik i popullatës çdo dite
- 18- Analiza mikrobiologjike për vitin 2023 janë kryer 3105.
- 19- Monitorim i ujit të pijshëm në fshat dhe në qytet
- 20- Analiza në total për ujin e pijshëm janë kryer 55989.
- 21- Grumbullim të mostrave të kripës në qytet dhe fshat (në bazë të Udhëzimit nga Ministria e Shëndetësisë për monitorimin e deficienës jodike)
- 22- Total analiza të mostrave të kripës janë kryer 220.
- 23- Monitorime Higjieno- Sanitare për vitin 2023 janë kryer 138.

NJËSIA VENDORE E KUJDESIT SHËNDETËSOR MALLAKASTËR

Gjatë vitit 2023 sektori epidemiologjisë dhe shëndetit mjedisor ka realizuar punën si më poshtë:

Gjatë vitit 2023 është monitoruar me vëmendje të shtuar uji i pijshëm në të gjithë territorin e rrethit Mallakastër. Në pikat e monitorimit të ujit të pijshëm janë marrë çdo kohë sipas përcaktimeve analiza fiziko-kimike të ujit dhe nuk ka rezultuar asnjë prej analizave me probleme. Gjithashtu merren dhe analizohen 2 (dy) herë në javë analiza mikrobiologjike në pikat e monitorimit. Këto analiza kanë rezultuar brenda parametrave të miratuara.

Po ashtu, dy herë në ditë (paradite dhe pasdite), në ujin e pijshëm është bërë matja e klorit të lirë në 14 (katërbëdhjetë) pikat e marrjes së kampionëve. Vlerat kanë rezultuar brenda normave të lejuara dhe në raste të veçanta, janë marrë masat e duhura për parregullsitë mundshme të hasura.

Në institucionin tonë **nuk është prezent një Laborator mikrobiologjik** ku mund të kryhen analizat mikrobiologjike dhe fiziko-kimike. Aktualisht kampionet e marra dërgohen në Laboratorin mikrobiologjik pranë NjVKSh Fier. Janë bërë shkresa zyrtare drejt institucioneve eprore për zgjidhje të mëtejshme për mungesën e laboratorit mikrobiologjik në NjVKSh Mallakastër.

Gjatë vitit 2023 janë kryer analizat si më poshtë:

1. Analiza mikrobiologjik 312
2. Fiziko-kimik 102
3. Klori lirë në ujin e pijshëm 6,720
4. Analiza mikrobiologjike në depo 3
5. Analiza mikrobiologjike në çezma publike 3

Analiza klori i lirë i ujit:	Analiza fiziko-kimike të ujit:	Analiza mikrobiologjike të ujit:	Analiza mikrobiologjike të ujit në depo:	Analiza mikrobiologjike të ujit në çezma publike:
6720	102	312	3	3

Gjatë vitit 2023 janë marrë dhe diagnostikuar **1,155** (Njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e pesë) mostra nazo-faringeale personave të dyshuar, referime këto nga Mjekët e Familjes, Urgjenca Kombëtare 127 dhe vlerësimet epidemiologjike të NjVKSh Mallakastër. Këto teste janë kryer si nëpërmjet testeve të shpejta të antigenit ashtu edhe sipas testimit molekular nëpërmjet metodës PCR. Të ndara sipas llojit, testet e kryera paraqiten si vijon:

-Teste të shpejta të antigenit/Rapid Test:	1,153
- Teste molekulare PCR/ rRT-PCR:	2
Total teste të kryera	= 1,155

Nga analizimi i mostrave në laboratorin virologjik në ISHP Tiranë dhe në laboratorin e NjVKSh Mallakastër, përgjigjet për këto mostra kanë qenë si më poshtë:

Periudha	Total Mostra Covid-19 NjVKSh Mallakastër – Viti 2023		
	Testime Total	Pozitiv	Negativ
01.01.2023 - 30.06.2023	1,155	32	1,123

Të dhënat e tjera më të përmbledhura përsa i përket situatës ndaj Covid-19 në rrethin Mallakastër për periudhën janar-dhjetor 2023, janë si vijon:

- Total testime Covid-19 = **1,155**
- Nr. i pacientëve rezultuar pozitiv = **32**
- Përqindja e pozitivitetit (gjithsej Rt+PCr) = 28%
- Nr. i jetëve të humbura prej Covid gjatë janar-qershor 2023 = **0**
- Nr. i pacientëve të shtruar në spital gjatë janar-qershor 2023 = **1**
- Nr. i pacientëve që janë trajtuar në kushte shtëpie gjatë vitit 2023 = **1,154**

Burimet Njerëzore

- Gjatë **vitit** 2023 në QSh janë punësuar 0 (zero) personel infermieror me kontratë pune të përkohshme.
- Nga portali “*Infermier për Shqipërinë*” gjatë **vitit** 2023 nuk ka pasur infermier të interesuar edhe pse ka patur vende të lira në QSh-të e rrethit Mallakastër.
- Nga portali “*Mjek për Shqipërinë*” edhe pse kemi mjaftueshëm vende vakante, nuk ka patur mjekë të punësuar në institucionet shëndetësore parësore

INSPEKTORIATI SHETËTOR SHËNDETËSOR

Misioni i Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor është: “Garantimi i respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik”.

Misioni

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor ka për mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor është përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, me përjashtim të inspektimit të veprimtarive në fushën farmaceutike, i cili kryhet nga struktura përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi. Misioni i përgjithshëm i Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor Rajonal Fier është: kontrolli, konstatimi, këshillimi, njoftimi, formimi, parandalimi dhe sanksionimi. Inspektorati Shtetëror Shëndetësor ngarkohet:

- Të sigurojë zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e shëndetësisë në rang qarku, inspektorët e shëndetësisë ngarkohen të sigurojnë zbatimin e këtyre dispozitave.
- T’u japë të dhëna dhe këshilla teknike subjekteve për mjetet më efikase të shqyrtimit të dispozitave ligjore.
- Të vërë në dijeni subjektet përgjegjës për mangësitë dhe shkeljet, si dhe të propozojë dhe përdor mjetet dhe instrumentet e nevojshme për përmirësimin e gjendjes shëndetësore.

Viti 2023, Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, punoi në drejtim të sensibilizimit të subjekteve, për respektimin e kërkesave ligjore në fushën e shëndetit, inspektimet e kryera për planin e punës, kërkesat, ankesat e subjekteve të ndryshme, e ku çdo rast, është ndjekur, trajtuar, zgjidhur e adresuar në kohë.

Qëllimi

ISHSH Fier duhet të garantojë që veprimtaria inspektuese e inspektorëve të jetë në frymën e ligjit dhe në koherencë të plotë me objektivat strategjike të tij:

- Identifikimi i rreziqeve dhe kërcënimet nga aktivitetet që përbëjnë rrezik për shëndetin publik.
- Kryerjen e inspektimeve në kohë dhe me saktësi, si dhe kryerjen e inspektimeve të përbashkëta sipas programimit vjetor.
- Dhënia e informacionit në kohë dhe cilësi për organet e prore.
- Rritja e nivelit të transparencës për procesin e inspektimit.

- Shmangien e abuzimit me detyrën në shkelje të ligjit nga të dy aktorët e përfshirë në këtë proces, inspektorë të shëndetësisë dhe subjektet.

Inspektime, ri-inspektime dhe monitorime.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor Rajonal Fier kreu 1784 inspektime, ri-inspektime dhe monitorime në të gjithë territorin e qarkut gjatë vitit 2023 si më poshtë vijon:

- 1643 Inspektime.
- 37 Ri-inspektime.
- 2180 Monitorime

Masa Administrative

Trupat inspektuese të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor Rajonal Fier kanë vendosur gjatë vitit 2023 masat administrative si më poshtë vijon:

- 6 Gjoha në vlerën 1 920 000 Lekë.
- 292 Paralajmërimë.

Inspektime Shëndetësore

Gjatë vitit 2023, trupat inspektuese të ISHSH Fier kryen 454 inspektime dhe ri-inspektime shëndetësore, me qëllim:

- Mbrojtjen e shëndetit të popullatës përmes procesit inspektues të respektimit të legjislacionit në fuqi në institucionet e kujdesit shëndetësor.
- Rritjen e cilësisë së ofrimit të shërbimeve shëndetësore dhe standardeve ndaj popullatës në institucionet e kujdesit shëndetësor.

Inspektime për Kujdesin Shëndetësor Parësor

Gjatë vitit 2023, trupa inspektuese e ISHSH Rajonal Fier ka kryer 343 inspektime dhe ri-inspektime me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës përmes procesit inspektues të respektimit të legjislacioneve në fuqi për kujdesin shëndetësor parësor.

- 342 Inspektime
- 1 Ri - inspektim
- 99 Paralajmërimë

Inspektime për zbatimin e Ligjit nr. 9928 “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik” të ndryshuar

Gjatë vitit 2023, trupat inspektuese të ISHSH kryen 102 inspektime dhe ri-inspektime në kabinetet dentare publike dhe jo publike dhe laboratorët dentarë publikë dhe jo publikë.

- 101 inspektime.
- 1 ri-inspektime
- 4 Paralajmërimë

Mangësitë e konstatuara gjatë procesit inspektues kanë qenë si më poshtë vijon:

- Mungesa e Akt- Miratimit Higjiëno-Sanitar.
- Mungesa e licencës nga QKL

Inspektime Për Kujdesin Shëndetësorë Spitalor

Gjatë vitit 2023, trupa inspektuese e ISHSH Rajonal Fier ka kryer 4 inspektime dhe ri-inspektime me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës përmes procesit inspektues të respektimit të legjisllacioneve në fuqi për kujdesin shëndetësorë spitalor.

- 4 Inspektime
- 0 Ri – inspektime
- 2 Paralajmërimë

Inspektime Sanitare dhe Inspektime për Ligje të tjera

Gjatë vitit 2023, trupa inspektuese e ISHSH Rajonal Fier ka kryer 1330 inspektime, ri-inspektime dhe monitorime sanitare dhe inspektime të tjera.

Inspektime para dhe gjatë sezonit turistik

Gjatë vitit 2023 u kryen 178 inspektime dhe ri-inspektime në subjekte të sezonit turistik veror me qëllim inspektimin e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore në sektorët shtetërorë, private dhe veprimtaritë e ndryshme të ushtruara nga persona fizikë e juridike, vendas e të huaj.

Gjatë vitit 2023 janë vendosur masat administrative si më poshtë vijon:

- 18 Paralajmërimë.

Mangësitë e konstatuara gjatë procesit inspektues kanë qenë si më poshtë vijon:

- Mungesë e Akt-Miratimit Higjiëno-Sanitar
- Mungesa e certifikatës së kryerjes së shërbimit të dezinfektimit

- Mungesa e librezave shëndetësore për personelin
- Mungesa e furnizimit me uji të rrjedhshëm për subjektet e vijës së parë bregdetare
- Subjektet e vijës bregdetare janë subjekte provizore që ofrojnë kushte modeste shërbimi
- Mungon kontrata me një firmë të licencuar për zvuotimin e gropave septike
- Dokumentacioni vërtetues i kryerjes së trajnimit për dhënien e ndihmës së parë në pishina

Inspektime në institucione parashkollore, shkollore dhe subjekte të akomodimit dhe shërbimit të tyre.

Gjatë vitit 2023 u kryen 410 inspektime dhe ri-inspektime të subjekteve publike dhe jopublike arsimore parashkollore, shkollore, si dhe në konviktet dhe mensat e institucioneve të arsimit të mesëm me qëllim inspektimin e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore në institucionet arsimore për të siguruar optimumin shëndetësor të kushteve të mësimin, jetesës e shlodhjes.

- 404 inspektime
- 6 ri-inspektime

Mangësitë e konstatuara gjatë procesit inspektues kanë qenë si më poshtë vijon:

- Mungesa e dokumentacionit të detyrueshëm Higjieno sanitar për subjektin dhe për personelin.
- Moskryerja e shërbimit të dezinfektimit (DDD)
- Amortizim i ndërtesave të shkollave.
- Prania e lagështisë në ambientet e institucioneve.
- Amortizimi i bazës materiale të shkollave (banka, karrige, dyer, dritare, etj).
- Amortizim i rrjetit elektrik dhe hidraulik.
- Mungesë e ngrohjes në ambiente
- Mungesë e rrethimit të subjektit
- Mungesa e palestrës dhe ambienteve sportive në shkolla.
- Mungesa e laboratorëve mësimorë.
- Kushte të pa përshtatshme higjieno – sanitare të anekseve hidro-sanitare
- Anekset hidro-sanitare ndodhen jashtë ambienteve të shkollës dhe të amortizuara

- Mos furnizim me ujë të rrjedhshëm, mungesa e ujit të ngrohtë.
- Mangësi në pajisjen e bllokut të gatimit në kopshte.
- Mungesa e ambienteve me hapësira të mjaftueshme për nr. e fëmijëve në çerdhe dhe kopshte.
- Tualete të papërshtatshme për grup moshën në institucione arsimore parashkollore.

Gjatë vitit 2023 janë vendosur masa administrative si më poshtë vijon:

- 148 Paralajmërimë

Inspektimi i ndërmarrjeve për shëndetin në punë.

Gjatë vitit 2023 trupat inspektuese kryen 51 inspektime dhe ri inspektime me qëllim mbulimin me shërbim mjekësor, nëpërmjet mjekut të punës, të përshtatshëm për rreziqet që paraqet vendi i punës, duke përfshirë normat, rregullat dhe procedurat për të siguruar kontrollin mjekësor të pranimit në punë dhe ato periodike për punëmarrësin. Garantimin e kujdesit shëndetësor profesional dhe praninë e dokumentacionit shëndetësor në subjekt ku pasqyrohet puna e tij.

Kontrollin e kushteve higjieno sanitare në mjediset e punës.

- 46 inspektime
- 5 ri-inspektime

Gjatë vitit 2023 janë vendosur masat administrative si më poshtë vijon:

- 5 Paralajmërimë.

Inspektime në shtëpitë e të moshuarve

Gjatë vitit 2023 trupa inspektuese e ISHSH Rajonal Fier ka kryer 1 inspektim në Shtëpinë e të Moshuarve Fier, institucionet rezidencial publik i kujdesit për të moshuarit, me qëllim monitorimin e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore për respektimin e kushteve higjieno- sanitare në këto institucione të kujdesit social.

Mangësitë e konstatuara gjatë procesit inspektues kanë qenë si më poshtë vijon:

- Prani të lagështisë në ambientet

Inspektime sanitare për pajisjen me Akt – Miratim Higjieno Sanitar, inspektime sanitare në bazë të ankesave apo denoncimeve

Gjatë vitit 2023 trupat inspektuese të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor Rajonal Fier kanë kryer 35 inspektime në subjektet që kanë aplikuar për pajisjen me Akt-Miratim Higjieno- Sanitar dhe rastet e denoncimeve apo ankesave të depozituara pranë institucionit.

- 33 Kërkesa për pajisjen me Akt – Miratim Higjiene Sanitar
- 2 Denoncime

PROBLEMATIKAT E INSPEKTORIATIT SHËNDETËSOR RAJONAL FIER:

Inspektimet e realizuara na vënë në vëmendje rritjen e ndërjegjësimin mbi detyrimin ligjor të subjekteve për pajisjen me dokumentacionin shëndetësor të detyrueshëm, si dhe për vënien në zbatim të legjislacionit shëndetësor me qëllim garantimin e ruajtjes së shëndetit të popullatës. Për realizimin në kohë dhe me efektivitet të detyrave të ngarkuara për tu realizuar bazuar në planin e punës dhe detyrimet ligjore që lindin gjatë aktivitetit të institucionit, lind nevoja për krijimin e kushteve të përshtatshme të punës dhe plotësimin me baze materiale të nevojshme.

- Mungesa e ambienteve për ushtrimin e aktivitetit – prej 9 vitesh institucioni qëndron në 3 zyra të institucionit NJVKSH-FIER. Këto zyra përdoren gjithashtu për arshivim dokumentesh dhe magazinim materiale. Është emergjente zgjidhja përfundimtare e problemit pasi është i pamundur ushtrimi i aktivitetit në këto kushte.
- Detyra e lënë nga Drejtoria e Arshivave për krijimin e ambienteve për arshivimin e dokumentacionit në përputhje me legjislacionin në fuqi për arshivat.
- Mungesa e ambienteve për magazinimin e materialeve.
- Mungesa e bazës materiale: kompjuter, printer, pajisje zyrash.
- Mungesa e automjeteve – prej muajit mars 2023 nuk kemi asnjë automjet në dispozicion.
- Mungesa e tabletave dhe amortizimi i atyre që kemi në përdorim. Shpesh për mos funksionim të tabletave çështjet mbyllen nëpërmjet aparateve celulare apo laptopit, për këtë arsye nuk arrin të kryhet procesi i firmosjes elektronike të procedurës inspektuese.
- Profilizimi i inspektoreve sipas fushave të inspektimit.
- Problematikat e ndryshme që dalin gjatë plotësimit të procedurave në sistem, mungesa e informimit dhe trajnimeve për ndryshimet që ndodhin në sistem.
- Përshtatja e rregulloreve të inspektimit me ndryshimet ligjore.

Fondi I Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor

Kontrolle në qendra shëndetësore të kontraktuara me Fondin u realizuan 29 në të cilat u vunë kushte penale në vlerën 267 000 lekë, dëme ekonomike 309 000 lekë dhe gjoba 18 000 lekë.

Gjatë vitit 2022 kanë marrë shërbimin e Hemodializës 110 pacientë në muaj me 14 435 seanca.

Check-up i realizuar për vitin 2022 është në masën 102 %.

DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Fier , ka zhvilluar aktivitetin e saj mbi bazën e Planit Vjetor 2021 të Miratuar nga DPSHSSH, mbi të cilën është programuar gjithë aktiviteti i drejtorisë me sektorët e saj:

- I- Sektori i Pranueshmërisë
- II- Sektori i Shërbimeve Sociale dhe IT

Qarku Fier përfshin në juridiksionin e saj 42 njësi administrative në 6 bashki. Ka një popullsi prej 511'701 banorësh, që i korrespondon afërsisht 141'859 familjesh, prej të cilave në dhjetor 2023, rezultojnë me ndihmë ekonomike 1,131 familje ose afërsisht 0.7 % e numrit të familjeve të Qarkut:

Për Qarkun Fier kemi patur këtë dinamikë vjetore të shtrirjes së skemës së ndihmës ekonomike:

Në muajin Janar 2023 ka pasur gjithsej 2,705 aplikime nga familjet pretenduese për ndihmë ekonomike. Si rrjedhojë e këtij procesi, rezultuan si përfitues 1,919 familje duke filluar nga muaji janar 2023, ndërkohë që u refuzuan nga sistemi i pikëzimit, 786 familje.

· Për vitin 2023 janë realizuar të gjitha kontrollet e NE-së të programuara, pra 24 kontrolle duke patur si objektiv kryesor evidentimin e rasteve të mashtrimit nga verifikimet social ekonomike në terren.

· Duke krahasuar muajin janar 2023 me 1,919 familje përfituese me muajin dhjetor 2023 me 1,331 familje përfituese kemi një ulje të skemës së NE-se me 588 familje, nga këto 51 familje u larguan nga skema si pasojë e identifikimit të rasteve të mashtrimit nga verifikimet social ekonomike gjatë kontrolleve në terren nga grupi i kontrollit vetëm në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023.

Me synimin kryesor, kthimin e Programit të Asistencës Sociale, nga një skemë pasive në skemë aktive, të lidhur ngushtë me skemat e arsimit, punësimit dhe formimit profesional, u nënshkrua Urdhri i Përbashkët i MSHMS & MF Nr.624 dt. 29.08.2019, “Për Miratimin e Planit Operacional për Punësimin e Anëtarëve në moshë Aktive Pune, të Skemës së NE, 2019-2020” si një mekanizëm referimi që do të drejtojë drejt tregut të punës dhe arsimit profesional, anëtarët në moshë pune të familjeve nga skema e ne, të regjistruar si të papunë nga zyrat e punësimit ;

Për vitin 2023 janë orientuar drejt tregut të punës sipas referimeve, 1,421 persona nga të cilët janë punësuar 122 individë në moshe aktive pune.

OBJEKTIVAT E SKEMËS SË NDIHMËS EKONOMIKE PËR VITIN 2024.

· Objektiv i realizimit të kontrollit dhe monitorimit të veprimtarisë e të zbatimit të legjislativës së asistencës sociale duke realizuar të paktën 3 kontrolle çdo muaj dhe duke rritur numrin e verifikimeve social ekonomike në terren bazuar në vlerësimin e riskut me qëllim kryesor evidentimin e rasteve të mundshme të mashtrimit dhe largimin nga skema e NE-se të rasteve të tilla.

· Objektivi i rritjes së numrit të daljeve nga Sistemi i Ndhmës Ekonomike të përfituesve të aftë për punë që përfitojnë NE dhe integrimi i përfituesve në moshe aktive pune të NE-së në tregun e punës.

· Objektivi i zbutjes së varfërisë dhe përjashtimit shoqëror për individët e familjet vërtet në nevojë nëpërmjet evidentimit të tyre si dhe të krijimit të mundësive për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre.

ARRITJET E SKEMËS BIO – PSIKO – SOCIALE

- Implementimi dhe funksionimi i 4 (katër) Komisioneve Shume disiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar sipas skemës bio psiko sociale në Qarkun e Fierit, ku gjatë vitit 2023 janë pranuar për tu rikomisionuar në total 2620 dosje, ndërsa komisionime për raste të reja janë pranuar 597 dosje.
- Dakortësimi i Marrëveshjes Bashkëpunuese ndërmjet DRShSSH Fier me AKPA për të siguruar punësimin me kohë të plotë apo të pjesshme të personave me aftësi të kufizuara për punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe të Formimit Profesional nëpërmjet shkëmbimit reciprok të informacionit për kërkuesit dhe përfituesit e moshës aktive për punë.
- Për vitin 2023 kemi referuar te Drejtoria Rajonale e AKPA Fier kemi referuar 615 persona me aftësi të kufizuar nga të cilat kemi pasur 32 raste suksesi, pra punësimi i personave me aftësi të kufizuara për Qarkun Fier.
- Dakortësimi i Marrëveshjes Bashkëpunuese ndërmjet DRSHSSH Fier me gjashtë Bashkitë e Qarkut, përkatësisht Bashkisë: Fier, Lushnje, Roskovec, Divjakë, Mallakastër dhe Patos me qëllim marrjen e detyrave dhe përgjegjësi të reja nga ana e administratës së shërbimit social në nivel lokal lidhur me menaxhimin e rasteve të vlerësuara nga komisioni shumë disiplinor dhe koordinimin e mbështetjes për përfituesit. Detyrat e reja të administratës do të përbëjnë bazën e shërbimeve komunitare për personat me aftësi të kufizuara.
- Dakortësimi i Marrëveshjes Bashkëpunuese ndërmjet DRShSSH Fier me Shoqatën ANAD, për të ndihmuar integrimin social të personave që nuk dëgjojnë, por që përdorin gjuhën e shenjave për komunikim si dhe për të nxitur përhapjen e saj, sipas kushteve të kësaj marrëveshjeje do të ofrohet përfitimi i shërbimit të përkthyesit/interpretuesit të gjuhës së shenjave.

Të dhëna nga Komisionet Bio - psiko – social

✓ ***3217 persona të komisionuar***

✓ ***2868 përfitues***

✓ ***349 të refuzuar***

SEKTORI SHËRBIMEVE SHOQËRORE DHE IT.

Në përputhje me Ligjin 21/2016 “Për Shërbimet Shoqërore” si dhe Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale të miratuar së fundmi me Vendim nr. 866 date 24.12.2019 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2020-2023 dhe të Planit të Veprimit në zbatim të saj", ndërsa kemi ndërmarrë iniciativën për nxitjen dhe bashkërendimin e procesit të hartimit të planeve sociale, si një mjet i rëndësishëm në ngritjen e fondeve dhe ofrimin e shërbimeve; me të gjitha bashkitë e qarkut Fier:

Janë kryer në mënyrë periodike monitorimet në qendrat si më poshtë:

- Qendra Sociale Murialdo
 - Qendra Komunitare Levan
 - Shërbimi Lëvizës Drizë
 - Qendra Komunitare pranë Banesave Sociale
 - Qendra Rezidenciale për të moshuar Fier
 - Qendra Horizont
 - Qendra Ditore e Zhvillimit Lushnje
 - Qendra Komunitare Roskovec
-
- Mbledhja dhe dërgimi evidencave 2-mujore për IPSH-të Qarkut, përkatësisht Qendra ditore PAK” Horizont” Fier , Qendra e zhvillimit Lushnje, Qendra Rezidenciale për të moshuar Fier, Qendra Rinore “Epoka e Re”
 - Është dërguar për përfitim /rinovim të statusit të jetimit pranë SHSSH Tiranë, dokumentacioni për 57 përfitues.
 - Janë kryer vlerësime për karrige me rrota 9 raste.
 - Për periudhën Janar- Dhjetor 2023 janë kryer 56 monitorime pranë qendrave që ofrojnë shërbime sociale.
 - Hedhja e të dhënave në sistemin RomAlb, nga punonjësja sociale.
 - Pjesëmarrje dhe rekomandime të përgatitura nga DRSHSSH për monitorimin të Planeve Sociale të Bashkive, Patos, Mallakastër, Lushnje, Divjakë dhe Roskovec ku aktualisht të gjitha bashkitë kanë përfunduar planet sociale dhe kanë filluar implementimin e tyre. Bashkia Fier dhe Divjakë janë në proces të realizimit të planit social, pasi i ka përfunduar në vitin 2023
 - Përditësimi i Hartës së Shërbimeve Sociale të Bashkive të Qarkut Fier,
 - Pjesëmarrje në tryezat teknike për ngritjen e mekanizmit të koordinimit dhe referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare në të 6 – ta bashkitë e qarkut Fier. Aktualisht në të gjitha bashkitë e qarkut Fier, në bashkëpunim me PNUD- in janë ngritur dhe

funksionojnë të gjitha MKR- të. Gjithashtu u ngritën Ekipet Teknike Ndërsektorale (ETN-të) ku dhe jemi anëtarë të përhershëm të grupit.

- Kemi zhvilluar 1 takim të ETN – së në bashkinë Divjakë ku kemi qenë pjesë e tryezës. Në bashkinë Roskovec janë zhvilluar 3 takime ku kemi qenë pjesë e tryezës. Në Fier janë zhvilluar 2 takime me ETN- në
- Kemi zhvilluar 4 mbledhje GTN-je në Bashkinë Patos ku kemi qenë pjesë e tryezës, 1 mbledhje GTN - je në Bashkinë Roskovec, 1 mbledhje GTN - je në Bashkinë Lushnje, 5 mbledhje GTN - je në Bashkinë Fier.
- Janë menaxhuar 6 raste të moshuar për sistemimin e tyre në IPSH për të moshuar.
- Kthim përgjigje 5 ankesave të qytetarëve (PAK), të ardhura nga platforma e bashkëqeverisjes me qytetarët.
- Janë realizuar 3 takime sensibilizuese në shkolla në kuadër të muajit Tetor 2023 në bashkitë Mallakastër, Fier si dhe takim me përfaqësuesit e Ministrisë së Mbrojtjes dhe aktorë lokal të qarkut Fier .
- Nuk ka pasur raste të viktimave të trafikimit.

Bonusi i Bebes

Gjatë vitit 2023 nga DRSHSSH Fier janë shpërndarë në total 2,706 bonuse.

Në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit

Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura

Drejtoria Rajonale e Mjedisit

ADMINISTRATA RAJONALE E ZONAVE TË MBROJTURA

Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura ka si mision monitorimin e vazhdueshëm dhe ruajtjen e gjendjes ekzistuese të zonave mjedisore të mbrojtura; menaxhimin e tyre në mbështetje të kërkesave të kohës dhe standardeve ndërkombëtare.

Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura ka si mision monitorimin e vazhdueshëm dhe ruajtjen e gjendjes ekzistuese të zonave mjedisore të mbrojtura; menaxhimin e tyre në mbështetje të kërkesave të kohës dhe standardeve ndërkombëtare.

Aktivitetet kryesore të realizuara për vitin 2023 në drejtim të menaxhimit të ZM-ve janë:

- Ruajta dhe pasurimi i vlerave të biodiversitetit .
- Parandalimin e aktiviteteve të paligjshme brenda ZM.(prerje, gjueti, ndotje, gjermime)
- Mirëmbajtja dhe përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese.
- Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetëve lokale nëpërmjet promovimit të turizmit të qëndrueshëm
- Promovimi i vlerave natyrore dhe kulturore të ZM-ve me efekt rritjen e numrit të turistëve
- Rritjes së kapaciteteve njerëzore nëpërmjet trajnimeve
- Parandalimin e rasteve të kultivimit të bimëve narkotike brenda sipërfaqes që në administrojmë.
- Bashkëpunimi me pushtetin vendor, me organizatat mjedisore , bashkëpunimin me shkollat për rritjen e ndërgjegjësimit të vlerave natyror

Aktivitetet kryesore të realizuara në drejtim të menaxhimit të ZM-ve janë;

- Monitorim i vazhdueshëm për mbrojtjen e ZM-ve dhe parandalimin e aktiviteteve të paligjshme në ZM.
- Aktivitete me qëllim edukimi dhe ndërgjegjësimi për ZM me universitete dhe shkollat që ndodhen brenda dhe jashtë ZM.
- Promovim nëpërmjet televizioneve lokale dhe ato kombëtare , prodhimit dhe shpërndarjes së materialeve informuese .

- Promovimi i produkteve bujqësore të zonës dhe ushqimeve tradicionale për vizitorët e huaj dhe vendas në panairë në rang Qarku.
- Organizimi i eventeve sensibilizues në kuadër të ditëve mjedisore.
- Organizimi i takimeve me përfaqësues të prefekturës Fier dhe Bashkive Fier, Lushnje , Mallakastër, Divjake mbi planin e masave të emergjencave civile dhe planit të masave për sezonin turistik 2023.
- Lidhja e kontratave me subjektet që operojnë në park .
- Dërgimi i materialeve drusore në ishullin e pelikanit për sezonin e çeljes së vezëve.
- Informacion me turiste vendas dhe të huaj për promovimin e vlerave natyrore dhe kulturore të zonës .
- Plotësimi i protokolleve mbi faunën e egër dhe numërimi periodik për çdo muaj dhe përdorimi i aplikacionit i Naturalist.
- Mbrojtja nga zjarret duke ngritur grupet vullnetare të zjarreve me në krye kryepelqët e fshatrave, përdorimi i kullave për vrojtimin nga zjarri në zonën e Gjenerukës dhe në Pishë Poro dhe marrëveshjeve me subjektet që operojnë në ZM në rast të zjarreve.

Monitorimet

- **Monitorime në total 3239**

- Parku Kombëtar Divjake –Karavasta-----2243 monitorime
- RNM Pish Poro-----456 monitorime
- RNM Levan-----149 monitorime
- PK Lugina e Lumit Vjose-----285 monitorime
- MN-----106 monitorime

Kontrolle me Policinë e Shtetit

- Parku Kombëtar Divjake –Karavasta-----9 kontrolle
- RNM Pish Poro -----3 kontrolle
- RNM Levan-----0 kontrolle
- PK Lugina e Lumit Vjose-----1 kontrolle

AKT KONSTATIME

- Parku Kombëtar Divjake –Karavasta 5 akt-konstatime

- RNM Pish Poro 2 akt-konstatime
- RNM Levan 0 akt-konstatime
- Parku Kombetar Lugina e Lumit Vjose 5 akt-konstatime
- Monumenti i Natyrës 0 akt-konstatime

Zjarret

- **1** Rast zjarri në Parkun Kombetar Divjake-Karavasta në zone e Ekonomisë Pyjore Argjinatura e Lumit Seman 1 pa dem, sipërfaqe e përshkuar barishtore. Zjarri u izolua pa u futur në zonën të pyllëzuar.
- **1** Rast zjarri ne PM Pishporo në muajin Shtator me sipërfaqe të përshkuar 816 ha.

Masat e marra për zjarret

- Plani i masave ndaj zjarreve me MZSH (Divjake, Lushnje, Fier dhe Mallakastër).
- Aktmarrëveshjet me subjektet që ushtrojnë aktivitet ne ZM.
- Ngritja e grupeve vullnetare me fshatrat në ZM.
- Aktmarrëveshje me banoret për djegien e hamulloreve që kufizojnë me ZM.
- Funkionimi i pikës së vrojtimit me punonjësit tanë.
- Mbajtja në gatishmëri edhe te “Zjarrfikëses Mobile” që disponojmë.

Censusi i shpendëve murgatorë 2023

Censusi i shpendëve murgatorë 2023 u zhvillua në datën 14 Janar.

Nga numërimi që u be në 20 pika te Parkut Kombetar Divjake Karavasta janë evidentuar ne total **26000** shpendë ujqorë.

PROBLEMATIKAT

1. Bashkëpunimi ndërinstitucional me pushtetin vendor dhe IKMT Fier
2. Peshkimi i pakontrolluar në Lagunën e Karavastasë, mungesa e informacionit mbi llojet, sasinë.
3. Mungesa e një liste pronarësh (n.q.s. ka) që kanë përfituar pronën (ne mënyre ligjore) brenda territorit te ZM-ve nuk disponon.

4. Shtimi i aktiviteteve intensive private brenda ZM dhe në kufi (Fotovoltaike, Sera Diellore).
5. Mungese stafit.
6. Menaxhimi i vizitoreve, kërkohet staf shtesë në periudhën e sezonit turistik.
7. Qendra e Vizitoreve mjaft e frekuentuar nga vizitoret ka probleme në mirëmbajtje.
8. Restaurim i zyrave te AdZM-se.
9. Shkarkimi i ujërave të ndotura në Lagune, Lumenj dhe ne Det.
10. Mbetjet urbane të territor të ZM.
11. Bujqësia intensive.
12. Gjuetia sporadike gjatë natës.
13. Ndezja e pakontrolluar e zjarreve nga fermerët në tokat përreth ZM.
14. Detyrime prapambetura të papaguara i subjektit Don-Jugen.
15. Mungesa e uniformave për stafin.
16. Mungese kancelarie.
17. Amortizimi i mjeteve te AdZM Fier që shërbejnë për kryerjen e objektivave.
18. Mungesa e fidanëve në kuadër të vitit të pyjeve.
19. Mospërputhje të koordinatave të MN sipas VKM me terrenin.
20. Shtim të numrit të punonjësve në PK Lumi Vjosa.

Pritshmëria

- Rritje e vlerave të diversitetit biologjik.
- Zhvillim i turizmit të qëndrueshëm.
- Rritje e ndjeshmërisë se komunitetit ndaj natyrës.
- Përmirësimi i bashkëpunimit ndër-institucional.

KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

Me qëllim përmirësimin e menaxhimit te ZM-ve për vitin 2024 kërkohet :

- Krijimi i një strukture për mire menaxhimin e peshkimit në Lagunën e Karavastasë.
- Në bashkëpunim me Bashkinë Divjake të gjendet një zgjidhje për vend depozitimin e mbetjeve në fshatin Gur.

- Subjektet që operojnë në park si restorante hotele të gjendet mënyra për vjeljen e të ardhurave për përdorim të sipërfaqes. Gjithashtu të unifikohen materialet për tabelat reklamuese të këtyre restoranteve dhe kthimin e tyre me materiale prej druri.
- Bashkëpunim me i ngushte me Pushtetin vendor dhe bizneset lokale.
- Sipërfaqet e pyllëzuara në zonën rekreative të PKDK të futen në fond pyjor
- Mbledhja e Komitetit të Menaxhimit të vijoje të mblidhet të paktën 2 here në vit për zgjidhjen e problemeve në park
- Të përmirësohet buxheti për aktivitetet që kanë qëllime edukimi dhe ndërgjegjësimi nëpërmjet AKZM.
- Te rriten kapacitetet e stafit te AdZM Fier duke marre pjese në seminare dhe trajnime, si dhe pajisja me uniforma te stafit.
- Përgatitja e materialeve informuese dhe vendosja e tabelave informuese dhe promovuese ne gjuhen angleze dhe shqip për te bere te mundur aksesin ne park dhe ne ZM .
- Organizmi i punës për mbajtjen dhe përmirësimin e materialeve kadastrale dhe te vihet ne zbatim sa m pare dixhitalizimi i hartave .
- Mirëmbajtje e mjeteve te AdZM Fier qe shërbejnë për monitorime
- Mirëmbajtja e Qendrës së Vizitoreve.

ARM Fier, Vlorë, Gjirokastrë ushtron funksionet e saj në këto tre qarqe.

❖ **Fusha e Veprimtarisë dhe Objektivat**

- a) Mbikëqyr dhe mbron territorin e të gjithë rajonit
- b) Organizon punën e ARM-së dhe shpërndan detyrat sipas objektivave specifike të secilit punonjës;
- c) Bashkëpunon me ARM-të e tjera dhe mbështet punën e AKM-së në lidhje me aplikime, monitorime, inspektime që kanë të bëjnë me rajonin përkatës;
- d) Harton programin vjetor të inspektimit dhe ja dërgon për miratim Drejtorit të ARM-së.

❖ **Spektori i inspektimit mjedisor**

ka realizuar objektivat si më poshtë:

SEKTORI I INSPEKTIMIT MJEDISOR			
Inspektime Janar - Dhjetor 2022	Procedura Asgjësimi	Ankesa	Inspektime jashtë programit
66	00	05	17

❖ **Spektori i lejeve mjedisore**

ka realizuar objektivat si më poshtë:

Dhënie për mjedisi A dhe B	Mendimi leje	Dhënie për Paraprake/Thelluar	Mendimi VNM	Aplikime për Dëgjesë me publikun
190		291		133

❖ **Spektori i inspektimit të burimeve natyrore dhe ujërave**

Ka realizuar objektivat si më poshtë:

- Përpunim të database për subjektet e pajisur me leje shfrytëzimi të burimeve ujore për të 3 Qarqet

- Evidentim të zonave dhe subjekteve që bëjnë shkarkime të ndryshme në mjedise të ndryshme
- Sensibilizim i shoqërisë mbi situatën pandemike në vend

SEKTORI I INSPEKTIMIT TE BURIMEVE NATYRORE DHE UJRAVE		
Inspektime total	Masa administrative	Ankesa
32	1	2

❖ **Sektori i monitorimit**

Sektori i Monitorimit ka vlerësuar që të gjitha monitorimet që kanë ardhur gjatë gjithë vitit nga subjektet kanë qenë brenda kushteve të lejeve mjedisore.

Problematikë mbetet : Menaxhimi i mbetjeve.

ZYRA E ADMINISTRIMIT DHE KOORDINIMIT TË PARQEVE ARKEOLOGJIKE

Parqet Arkeologjike Apoloni dhe Bylis kanë patur një vit të suksesshëm në vijueshmëri dhe realizimin e shërbimeve ndaj vizitorëve dhe monumenteve.

Gjatë vitit 2023 në Parqet Arkeologjike Apoloni dhe Bylis vizitueshmëria ka qenë 40 % më e lartë në krahasim me vitin 2022. E shprehur në shifra ,në periudhën Janar- Nëntor 2022 ishin 52244 vizitorë në parkun Apolonia ndërsa për të njëjtën periudhë Janar-Nëntor 2023 kaluan 80979 vizitorë. Për Parkun Bylis për periudhën Janar-Nëntor 2022 ishin 3672 vizitorë ndërsa për periudhën Janar- Nëntor 2023 kaluan 5628 vizitorë .Kjo rritje eksponenciale e numrit të vizitorëve në të dyja parqet ka ndikuar në rritjen e të ardhurave nga biletat që konsiston në vlerat: 32 358 060 lekë, periudha Janar-Nëntor 2023, për Parkun Arkeologjik Apolonia dhe 1 258 940 lekë për Parkun Arkeologjik Bylis për të njëjtën periudhë.

Vëmendje e madhe i është kushtuar mirëmbajtjes së territorit dhe restaurimit të monumenteve duke punuar me kujdes dhe përkushtim edhe për ruajtjen e origjinalitetit të tyre .Gjithashtu është bërë punë e vazhdueshme për përpunimin e mbetjeve ekologjike dhe grumbullimin e tyre në vende të posaçme. Promovimi i parqeve arkeologjike nëpërmjet rrjeteve sociale dhe aplikacioneve dixhitale për telefonat inteligjentë ka mundësuar dhe lehtësuar vizitorët të informohen saktë dhe në kohë reale duke patur një guidë specifike të personalizuar.

Gjithashtu edhe faqja e Web-it është informuese dhe orientuese. Është krijuar gjithashtu hapësira shlodhëse dhe relaksuese e piknikut për qëndrimin e vizitorëve .

Problematika e vetme është mungesa e stafit të specializuar që krijon mangësi dhe vështirësi të vazhdueshme.

TABELA PËRMBLEDHËSE PËR VIZITORËT 1 JANAR - 31 DHJETOR 2022

NR	Emërtimi	Vizitorë totali 2022	Totali i vizitorëve 2023	Totali / lekë
1	Parku Arkeologjik Apoloni	52244	80979	32 358 060
2	Parku Arkeologjik Bylis	3672	5628	1 258 940

1. Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Rajoni II, Vlorë Sektori Inspektimit Fier

- Gjatë këtij 12- mujori janë kontrolluar gjithsej **453** subjekte. Subjekte të programuara **396**, subjekte të inspektuara për ankesë **24**, subjekte me tematik **0**, inspektime për aksident në punë **8**, inspektim me kërkesë të subjektit për AZHBR/IPARD II **20**, inspektim për punësim të mitur nën 18- vjeç **1**, inspektim rastësor **1**, inspektim parashikuar nga legjislacioni i posaçëm **1**, subjekte të inspektuara për ri inspektim **1** dhe inspektim leje pune para fillimit të aktivitetit **1**. Nga të cilat **427** janë subjekte Shqiptare, **5** subjekte të përbashkët (Shqiptare-e Huaj) dhe **14** subjekte të huaj, nga këto kemi **36** subjekte shtetërore.

Nga këto inspektime rezultojnë të punësuar **13115** punëmarrës nga të cilët **6769** janë femra.

Gjatë kontrollit janë konstatuar **79** punëmarrës informal, Futur në skemën e sigurimeve shoqërore **78**, Inspektime ankesë janë **24**, Inspektim për AZHBR/IPARD II janë **20**, Inspektim leje pune para fillimit të aktivitetit 1një, Inspektim për punësim të mitur -18 vjeç, **1**, masa urgjente për marrëdhëniet e punës **41**, Punëmarrës informal **79**, Punëmarrës të formalizuar, **78**, Gjoha të vendosura **4**, Vlera e gjobës së vendosur, **1800000** lekë, Inspektime për orë shtesë Punëmarrës pa kontratë punë **121**, Inspektime aksident në punë **8**, Punëmarrës me vdekje **2**

Treguesit kryesor të inspektimit (për muajt janar - dhjetor 2023)

Norma mujore e inspektimit është **396**, Inspektime realizuara gjithsej **453**, Punëmarrës të evidentuar, **13115**, informal **79**, Punëmarrës të formalizuar **78**, Punëmarrës të huaj **103**, me leje pune **103**, Punëmarrës me kontratë individuale **12994**, Punëmarrës pa kontratë pune **121**, Numri subjekteve me kontrate kolektive **1**, Punëmarrës me kontratë kolektive **252**

Inspektive aksident në punë,8,Aksident me vdekje 2,Gjoha të vendosura 4,Vlera e gjobave të vendosura1800000 lekë.

Punëmarrës nën 18 vjeç 9,

Punëmarrës femra 6769,Subj. me masë urgjente (për marrëdhënie punë),41

-Sanksione:

Gjatë muajit janar - dhjetor 2023 janë vendosur sanksionet si më poshtë:


Paralajmërimet : 56

Pezullim për Marrëdhëniet e Punës dhe Sigurinë në Punë: 0


Gjoha: 4 me 1800000 lek

Investimet sipas Bashkive :

BASHKIA	INVESTIMET NE QARKUN FIER (me tvsh)
FIER	51.106.929
LUSHNJE	71.619.561.4
MALLAKASTËR	3.121.320
DIVJAKË	71.351.626.06
PATOS	88.846.563,5
ROSKOVEC	217.754.379
Total Qarku Fier	1.052.904.682



Infrastruktura	Projekte Urbane	Shpronësime	Arsim	Familje ne nevoje	Total Investimet
849.317.694	61.607.970	10.236.000	111.389.348	20353670	1.052.904.682



Ndjekja dhe monitorimi i veprimtarive të Institucioneve Qendrore dhe Vendore për mbarëvajtjen e sezonit turistik 2022, ndjekja e detyrave nga Task-Forca të veçanta për sezonin turistik në Qark si dhe ndjekjen dhe realizimin e detyrave të Komitetit Rajonal të

Turizmit. Ndjekja e problemeve të sigurisë, të higjienës dhe të shëndetësisë në plazhe dhe në zona të tjera turistike.

Ky objektivi u realizua nëpërmjet:

- Ngritjes së grupit të punës me anëtarë të degëve territoriale për sigurimin e një sezoni të suksesshëm turistik.
- Drejtimi i Komitetit Rajonal të Turizmit

Konkretisht :

Për një mbarëvajtje sa më të mirë të Sezonit Turistik 2022/23, Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier, i kushtoi një vëmendje të veçantë koordinimit dhe monitorimit të punës të Institucioneve Qendrore në nivel vendor që kanë impakt në mbarëvajtjen e sezonit, për këtë krahas punës së vazhduar gjatë gjithë vitit është realizuar koordinimi dhe është ofruar bashkëpunimi nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut bazuar në kërkesat e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për bashkëpunim me NJVQV për një mbarëvajtje sa më të mirë të Sezonit Turistik dhe për sigurimin e një sezoni të suksesshëm turistik. Janë zhvilluar mbledhjet e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit 2023, përkatësisht në datë 03.04.2023 dhe 12.07.2023. Ndërkohë është kryer Raportimi në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit si dhe në Ministrinë e Brendshme për veprimtarinë e task – forcës për sezonin turistik veror. Është krijuar databazë për emrat e kontaktit të task-forcës për sezonin turistik, është kryer menaxhimi I grupit të Whatsapp për veprimtarinë javore të Task – Forcës së Turizmit. Çdo të hënë është raportuar në Ministri. Institucioni I Prefektit ka hartuar edhe raportin përfundimtar pas mbylljes me sukses të sezonit turistik. Sakaq është zhvilluar dhe Takimi I Komitetit të Zonave të Mbrojtura datë 27.06.2023.

Zhvillimi i marrëdhënieve, midis Institucioneve të pavarura dhe Institucioneve të varësisë në Qark si dhe Institucioneve qendrore të qeverisë , Ministrinë, KM, etj me qëllim koordinimin e tyre për realizimin e objektivave qeveritare dhe strategjive të miratuara në drejtim të funksioneve në fushën e sigurisë publike, fushën e zhvillimit ekonomik vendor, në fushën e bujqësisë, natyrës dhe biodiversitetit, në fushën e kulturës, sportit, shërbimeve argëtuese etj, si dhe në drejtim të kompetencave të deleguara pranë pushtetit vendor duke adresuar çdo pengesë dhe problematikë në zbatimin e detyrave.

Ky objektivi u realizua nëpërmjet:

- krijimit të mundësive për një bashkëpunim më të mirë dhe më të frytshëm ndërmjet Institucioneve në nivel horizontal dhe vertikal në mënyrë që problematikat të zgjidheshin dhe të mos krijohen mbivendosje kompetencash, mosmbulim të funksioneve të sipërpërmendura apo moskoordinim të tyre
- Kontrollit dhe monitorimit të veprimtarisë së Degëve Territoriale në Qark.
- Hartimit të raporteve të monitorimit të Degëve Territoriale në Qark

Konkretisht :

Analizimi i veprimtarive vjetore 2022 të Degëve Territoriale dhe adresimi i problematikave të konstatuara Ministrive përkatëse. Pjesëmarrja në analizat vjetore të disa prej degëve territoriale. Përkatësisht : Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, ZVA Fier, Lushnje, Mallakastër, Divjakë, Patos, Roskovec. Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Fier, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Fier, Administrata e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier/ Vlorë/ Gjirokastrë, Dega territoriale Shërbimit të Provës Fier. Është kërkuar dhe përpunuar informacion mujor për veprimtarinë e Degëve Territoriale në Qark dhe janë ndjekur evidencat e dërguara nga degët territorial. Janë hartuar materialet informative Drejtorisë për Çështjet Vendore dhe Funkcionet e Deleguara. Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga shkolla “ Numani” me temë : “ Ti japim kuptim jetës do të thotë të gjesh rrugën e duhur drejt etnografisë dhe shkencës”. Ngritja e grupit të punës “ Paketa e sigurisë në shkolla” bazuar në nismën e Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit I cili do të shërbeje për implementimin e kësaj pakete.

Më datë 04.09.2023 në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier u realizua takimi me kërkesë të Ministrisë së Brendshme , Z. Taulant Balla, për informimin dhe fillimin e implementimit të Paketës së sigurisë në shkolla. Në këtë takim morën pjesë Kryetarët e Bashkive, Zyrat Vendore Arsimore të Qarkut Fier, si dhe përfaqësues të institucioneve të tjera në qark me rol në zbatimin e paketës. Raportimi është kryer çdo ditë të premtë pranë Ministrisë së Brendshme për veprimtarinë e NJVQV-ve dhe degëve territoriale lidhur me paketën e sigurisë në shkolla. Ndërkohe që kemi marrë pjesë në aktivitetin “Tetori Rozë” organizuar nga NJVKSH Mallakastër, Takim me Njësine Vendore të Kujdesit Shëndetësor Fier, Lushnje, Mallakastër dhe UK Fier dhe Lushnje në lidhje me gjendjen higjienike të ujit të pijshëm. Në Institucion u organizua takimi me degët territoriale dhe Bashkitë në lidhje me masat që duhet të merreshin në kuadër të festave të fundvitit më datë 11.12.2023. Takim I organit këshillues pranë Institucionit të Prefektit u mbajt në datat 09.03.2023 dhe 26.10.2023.

Detyra të tjera:



Është mbledhur informacioni nga NJVKSH dhe është kryer raportim javor në ZOS për situatën e Covid 19 si dhe çdo situatë tjetër e krijuar

Janë hartuar dhe plotësuar databazë për vdekshmërinë foshnjore dhe cilësinë e ujit të pijshëm Çdo ditë është bërë legalizimi i dokumentacionit për jashtë vendit. Për ndryshimet në drejtuesit e NjVQV-ve, Njësive administrative, apo punonjësit e gjendjes civile është mbajtur korrespondence dhe komunikim i vazhdueshëm. Në total janë legalizuar **10360** certifikata.(Në bashkëpunim me sektorin e mbështetjes. Janë kryer Azhurnimet në faqen ËEB të Institucionit të Prefektit. Pjesëmarrje në Divjakë për mbjelljen e 300 fidanëve pishë e butë në zonën e parkut Divjakë – Karavasta në kuadër të ditës së Shërbimit Pyjor Kombëtar. Pjesëmarrje në dëgjuesën publike për shpalljen e Vjosës Park Kombëtar mbajtur në Qendrën Kulturore Vlorë.

Pritja dhe dhënia e informacionit për çdo qytetar që është paraqitur pranë Institucionit

Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier ka ndjekur ecurinë e zbatimit të Planeve të Përgjithshme Vendore, bazuar në ligjin 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”.

- *Ndjekja e zbatimit të Planeve të Përgjithshme Vendore për gjashtë bashkitë e qarkut : Fier, Lushnje, Mallakastër, Divjakë, Patos, Roskovec.*




- **Kontroll mbi besueshmërinë ligjore të akteve të nxjerra nga organet e pushteti vendor në fushën e planifikimit të territorit:**

Gjatë kësaj periudhe është shqyrtuar 3 vendime :

- *Vendimin Nr. 8 datë 21.02.2023 “ Rehabilitimi i Rrëshqitjeve në Rrugën Hekal –Klos-Poçem”*
- *Vendimi Nr.35 datë 20.03.2023 “Për miratimin e listës Përfundimtare të inventarit të pronave të paluajtshme ne pronësi ose në përdorim të Bashkisë Fier, për Njësinë Administrative Levan”*
- *Vendimin Nr. 30 datë 24.03.2023 të Këshillit Bashkiak Lushnje “Mbi përditësimin e inventarit të miratuar me VKM-në Nr.75, datë 06.03.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Lushnje”.*

- **Është kryer Raporti i Kontrollit të Zhvillimeve në Territor**

Është kryer procesi i kontrollit të zhvillimeve në territor me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për vitin 2022. Bazuar në Ligjin Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” (i ndryshuar)!



BASHKI A	Leje infrasa	Deklarat a paraprak e	Leje ndërtim i	Leje Zhvilli mi	Leje shtyrj e afati	Njoftim për fillim punimes h	Leje ndryshim projektes h	Çertif. përdori mi
Fier	6	86	24	15	0	0	0	7
Lushnje	8	85	71	37	1	0	0	8
Mallakast ër	2	13	4	1	2	8	1	4
Divjakë	0	50	31	18	2	18	1	14
Patos	8	32	7	15	0	3	1	1
Roskovec	7	21	8	6	1	0	1	3
TOTAL	31	287	145	92	6	29	4	37

- **Kontroll mbi besueshmërinë ligjore të akteve të nxjerra nga organet e pushteti vendor në fushën e planifikimit të territorit, bazuar në ligjin nr.107/2014 datë 31/07/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar me ligjin Nr.73 /2015 , dhe rregulloreve te planifikimit te territorit.**

Gjatë kësaj periudhe është shqyrtuar 3 vendime :

- *Vendimin Nr. 8 datë 21.02.2023 “ Rehabilitimi i Rrëshqitjeve në Rrugën Hekal –Klos-Poçem”*
 - *Vendimi Nr.35 datë 20.03.2023 “Për miratimin e listës Përfundimtare të inventarit të pronave të paluajtshme ne pronësi ose në përdorim të Bashkisë Fier, për Njësinë Administrative Levan”*
 - *Vendimin Nr. 30 datë 24.03.2023 të Këshillit Bashkiak Lushnje “Mbi përditësimin e inventarit të miratuar me VKM-në Nr.75, datë 06.03.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Lushnje”,*
- **Ndjekja e Aksionit të Pastrimit për gjithë Qarkun Fier !**

Në kuadër të nismës së Kryeministrit “ SHQIPËRIA E PASTËR”, me Urdhër të Prefektit Nr.49 datë 25.11.2021 është ngritur grupi i punës ndërinstitucional për marrjen e masave për pastrimin dhe higjienizimin e mjedisit nga mbetjet në Qarkun Fier! Për vitin 2023 Sektori i Zhvillimit Urban vijon koordinimin e aksionit të pastrimit , shoqëruar me planifikime javore dhe raportime mujore .

Planifikimet Javore përmbledhen në rang qarku dhe dërgohen në grupin Whatsapp në Planin Kombëtar të Pastrimit ,

Raporti Mujor përmbledhës dërgohet në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (deri në datë 7 të muaji pasardhës)

Raporti Përmbledhës i Muajit Janar 2023 me shkresë Nr.142 Datë 06.02.2023.

Raporti Përmbledhës i Muajit Shkurt 2023 me shkresë Nr.246 Datë 03.03.2023

Raporti Përmbledhës i Muajit Mars 2023 me shkresë Nr.365 Datë 03.04.2023.

Raporti Përmbledhës i Muajit Prill 2023 me shkresë Nr.490 Datë 04.05.2023

Raporti Përmbledhës i Muajit Maj 2023 me shkresë Nr.592 Datë 07.06.2023.

Raporti Përmbledhës i Muajit Qershor 2023 me shkresë Nr.696 Datë 04.07.2023

Raporti Përmbledhës i Muajit Korrik 2023 me shkresë Nr.834 Datë 01.08.2023

Raporti Përmbledhës i Muajit Gusht 2023 me shkresë Nr.934 Datë 06.09.2023

Raporti Përmbledhës i Muajit Shtator 2023 me shkresë Nr.1025 Datë 04.10.2023

Raporti Përmbledhës i Muajit Tetor 2023 me shkresë Nr.1139 Datë 07.11.2023

Raporti Përmbledhës i Muajit Nëntor 2023 me shkresë Nr.1239 Datë 11.12.2023

Raporti Përmbledhës i Muajit Dhjetor 2023 me shkresë Nr.36 Datë 08.01.2024



➤ Buxheti i pastrimit

Njësia Vetëqeverisjes Vendore	Buxheti i Pastrimit 2021	Buxheti i Pastrimit 2022	Buxheti i Pastrimit 2023	Buxheti i Pastrimit 2024
Bashkia Fier	185.836.000	186.307.812	235.855.353	272.318.972
Bashkia Lushnje	83.454.000	109.887.000	111.649.522	115.876.745
Mallakastër	12.786.675	43.374.143	48.621.551	50.420.551
Bashkia Divjakë	25.292.820	40.093.484	112.691.790	115.521.105
Bashkia Patos	34.193.648	35.593.648	41.167.487	53.388.366
Bashkia Roskovec	31.617434	37.493.422	45.330.221	50.999.686


Njësia Vetëqeverisjes Vendore	Buxheti i Pastrimit 2023	Buxheti i Pastrimit 2024	RRITJA	RRITJA NË %	% NDAJ TOTALIT TE BUXHETIT
Bashkia Fier	235.855.353	272.318.972	36.463.619	1.4%	10.9 %
Bashkia Lushnje	111.649.522	115.876.745	4.227.223	0.2%	6.9 %
Bashkia Mallakastër	48.621.551	50.420.551	1.799.000	0.1%	4.6 %
Bashkia Divjakë	112.691.790	115.521.105	2.829.315	0.4%	15.9 %
Bashkia Patos	41.167.487	53.388.366	12.220.879	2%	8.8 %
Bashkia Roskovec	45.330.221	50.999.686	5.669.465	0.9%	8.4 %

Njësia Vetëqeverisjes Vendore	TOTAL BUXHET 2024	Buxheti i Pastrimit 2024	RRITJA	RRITJA NË %	% NDAJ TOTALIT TE BUXHETIT
Bashkia Fier	2.481.149.542	272.318.972	36.463.619	1.4%	10.9 %
Bashkia Lushnje	1.671.867.610	115.876.745	4.227.223	0.2%	6.9 %
Bashkia Mallakastër	1.074.041.900	50.420.551	1.799.000	0.1%	4.6 %
Bashkia Divjakë	723.045.191	115.521.105	2.829.315	0.4%	15.9 %
Bashkia Patos	604.518.000	53.388.366	12.220.879	2%	8.8 %


Bashkia Roskovec	604.412.171	50.999.686	5.669.465	0.9%	8.4 %
-------------------------	-------------	------------	-----------	------	-------



➤ Depozitimi i mbetjeve urbane



TOTALI I MBETJEVE SIPAS BASHKIVE



Bashkia	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali (ton)
Fier	2322	2137	2246	1623	1909	2078	2603	2686	1838	1880	1756	2021	25099
Lushnje	1087.136	636.57	926.93	962.28	866.52	917.17	854.43	1091.57	1015.76	1032.92	1018.8	1105.42	11515.51
Mallaka	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Divjakë	333.66	283.35	385.69	389.246	242.63	0	320.96	552.11	388.26	353.09	399.08	400.44	4048.516
Patos	320.84	231.56	317.13	269.42	199.51	232.66	69.3	152.13	166.756	245.52	260.79	259.76	2725.376
Roskovec	235.8	180.34	218.82	196.32	214.8	262.32	181.74	194.72	177.64	187.65	122.318	169.86	2342.328
Total	4299.436	3468.82	4094.57	3440.266	3432.46	3490.15	4029.43	4676.53	3586.416	3699.18	3556.988	3956.48	45730.73

➤ Monitorimi i përdorimit dhe tregimit të qeseve plastike


Në kuadër të Task-Forcës së ngritur me Urdhër të Kryeministrit Nr.190 datë 15.11.2022 “Për përbërjen, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Task-Forcës “Për qeset plastike” dhe bazuar në kërkesën me nr. 1167 Prot. datë 16.02.2023, Për bashkëpunim dhe koordinim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, është ngritur një grup pune me përfaqësues nga çdo njësi, për të koordinuar procesin. Mbledhim raportime *javore* dhe *mujore* në mënyre periodike. Gjatë periudhës Mars - Shtator 2023 Sektori i Zhvillimit Urban ka ndjekur dhe koordinuar aksionin e pastrimit në rang qarku, shoqëruar me planifikime javore dhe raportime mujore. Afati i fundit i parashikuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave për funksionimin e kësaj task-force ishte data 1 Tetor 2023.

➤ Ndjekja e Mbledhjeve të Komitetit të Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur : Parku Kombëtar Divjakë Karavasta

Janë mbajtur 2 (dy) Mbledhje të Komitetit të Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta:

- Datë 27.06.2023 në ambientet e Prefektit të Qarkut Fier.

▪ Datë 18.12.2023 ne ambientet e AdZM Fier, Divjakë
 Problematikat e trajtuara kishin të bënin me uljen e safisë së peshkut dhe janë adresuar në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural .



➤ Shtimi i sipërfaqeve të gjelbra në rang Qarku !

BASHKIA	SIPËRFAQE TË GJELBRA TË SHTUARA (m ²)
FIER	18200
LUSHNJE	16441
MALLAKASTËR	0
DIVJAKË	9200
PATOS	2560
ROSKOVEC	1750




➤ Gjendja e Infrastrukturës Rrugore Rang Qarku


BASHKIA	INFRASTRUKTURA RRUGORE
BASHKIA FIER	<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i shtresave rrugore në segmentin e rrugës Levan-Kafaraj. • Rikonstruksion i unazës bujqësore Verri-Kallm i Madh. • Rikonstruksion i rrugës në lagjen 1-Maj segmenti rrugor “Naun Kaçaku” – “Shën Gjergji” – (Stacioni i Patosit-ish Ura me shkallë).
BASHKIA LUSHNJE	<ul style="list-style-type: none"> • Bashkia ka përdorur një pjesë të buxhetit për përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe ka realizuar disa investime të rëndësishme. • Falë këtyre investimeve si dhe shërbimeve të mirëmbajtjes të ofruara, janë rikonstruktuar disa segmente rrugore si dhe është mirëmbajtur rrjeti rrugor ekzistues si në zonat rurale ashtu dhe në ato urbane. • Kjo ka sjellë që të ketë një përmirësim të ndjeshëm të infrastrukturës rrugore që administrohet nga bashkia në të gjithë territorin e saj, por disa akse paraqesin problematikë si: ruga në Fshatin Allprenaj, ruga në Fshatin Dushk, ruga në Fshatin Hajdaraj, ruga në Fshatin Zhelizhan etj. të cilat do të planifikohen në buxhetin e ardhshëm për investim.
BASHKIA MALLAKASTËR	<ul style="list-style-type: none"> • Gjendja ekzistuese e akseve urbane dhe rurale brenda territorit administrativ është përgjithësisht e mirë.
BASHKIA DIVJAKË	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Gjendja ekzistuese e akseve urbane dhe rurale brenda territorit administrativ është përgjithësisht e mirë. Janë rikonstruktuar 14 akse urbane brenda bashkisë Divjakë

BASHKIA PATOS	<ul style="list-style-type: none"> • Në të gjithë territorin e Bashkisë Patos është bërë verifikimi i gjendjeve të akseve rrugore urbane dhe rurale ku janë pasqyruar nevojat për ndërhyrje në segmentet përkatëse. • Akset rrugore çdo vit mirëmbahen pasi vetë Bashkia Patos dhe Agjencia e Shërbimeve Publike zhvillon procedura për blerje bazë materiale për përmirësimin e infrastrukturës rrugore.
BASHKIA ROSKOVEC	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Qendra e Fshatit Marinëz ▪ Sistemimet brenda pallateve te Kopshtit nr.1 ▪ Sistemimi i ambienteve brenda pallateve tek Grandi

BASHKIA	INVESTIMET NE QARKUN FIER (me tvsh)
FIER	51.106.929
LUSHNJE	71.619.561.4
MALLAKASTËR	3.121.320
DIVJAKË	71.351.626.06
PATOS	88.846.563,5
ROSKOVEC	217.754.379
Total Qarku Fier	1.052.904.682



Infrastruktura	Projekte Urbane	Shpronësime	Arsim	Familje ne nevoje	Total Investimet
849.317.694	61.607.970	10.236.000	111.389.348	20353670	1.052.904.682



- Në Institucionin e Prefektit të Qarku Fier është organizuar një takim koordinues në lidhje me situatën në Parkun Natyror Lugina e Lumit Vjosë datë **15.04.2023!**

Të pranishëm ishin, drejtori i IKMT Fier , përfaqësues i ZABU-së Vlorë, përfaqësues të Administratës së zonave të Mbrojtura Fier!

Janë ndjekur forumet e organizuara nga Ministria dhe Agjencia e Planifikimit të Territorit në lidhje me shpalljen e Lumit Vjosa Park Kombëtar Lumor!

- Ndjekja e procedurës me Ministrinë e Financave për privatizimin e trojeve shtesë funksionale të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare të objekteve shtetërore të veçuara të privatizuar të objekteve apo të ndërtesave të shitura të ish-kooperativave bujqësore si dhe të ndërtesave të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit”.

Nuk ka pasur asnjë kërkesë për privatizim truell shtesë funksional gjatë këtij 6 mujori!

- Nënshkrimi i genplaneve që vijnë nga Dega e Shoqërive Publike, për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore , që privatizohet apo transformohet, dhe procedurën e shitjes.


Nuk ka pasur asnjë kërkesë për konfirmim genplani gjatë këtij 6mujori!

- Sektori i Zhvillimit Urban është pjesë e komisionin e shqyrtimit të lejeve të drejtimit për shkeljet e kryera nga drejtuesit e mjeteve që zotërojnë leje drejtimi të lëshuara në një shtet i huaj, bazuar në Ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Ligjin nr.8378 datë 22/07/1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”(i ndryshuar).

Për këtë periudhë nuk ka pasur asnjë procesverbal për shqyrtim !

- Është hartuar *Detyra e Projektimit* për Tenderin: *Rikonstruksion i Objektivit!*
- Është hartuar *Projekti Teknik i Rikonstruksionit !*
- Është hartuar *Preventivi i Rikonstruksionit !*
- Është realizuar procedura e tenderit, si pjesë e Njesisë së Prokurimit !

- Prezantimi i në PowerPoint i Qarkut Fier! (Realizuar dhe dorëzuar Prefektit)




- Aktiviteti i Ditës së Tokës **22 Prill 2023:**

Është miratuar programi i Ditës së Tokës me temë “Investo ne Planetin Tone” me Nr. Prot 426 Datë 18.04.2023:

1.*Qyteti pa makina në fashën orare 8.00-12.00*

2.*Shpërndarja e fletëpalosjeve të punuar nga Sektori i Zhvillimit Urban .*



➤ 100 vjetori i Shërbimit Pyjor Kombëtar

Sektori i Zhvillimit Urban ka marrë pjesë në Divjakë për mbjelljen e 300 fidanëve “Pishë e butë” në Zonën e Parkut Kombëtar Divjakë – Karavasta në kuadër të ditës së Shërbimit Pyjor Kombëtar.

IV. MBROJTJA CIVILE

Veprimtaria e institucionit të Prefektit në drejtim të mbrojtjes civile është fokusuar në marrjen e masave për parashikimin, parandalimin, lehtësimin, gatishmërinë dhe përgjigjen për rimëkëmbjen nga fatkeqësitë natyrore, fatkeqësitë e tjera me qëllim mbrojtjen e jetës së njerëzve, gjësë së gjallë, të pronës, trashëgimisë kulturore si dhe mjedisit. Për këtë janë organizuar mbledhjet e KECQ “Për marrjen e masave për përballimin e situatave të mundshme të shkaktuara nga përmytjet”. Janë hartuar dhe rifreskuar: Plani i Përballimit të Emergjencave në nivel Qarku; Plani Evakuimit; Plani i Gatishmërisë me skenar për përmytjet; Plani i bashkëpunimit të strukturave monitoruese, vepruese dhe operacionale dhe janë përditësuar pikat e kontaktit, mënyrat e marrjes së informacionit dhe shkëmbimin e ndërsjellët me të gjitha institucionet qendrore dhe lokale.

Janë përcaktuar dhe evidentuar burimet dhe kapacitetet njerëzore dhe logjistike që disponon qarku dhe çdo drejtori në nivel qendror dhe lokal si dhe janë përcaktuar parashikimet e dëmeve të, janë përcaktuar kërkesat për mbështetje logjistike nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile.

I është kushtuar vëmendje ndjekjes konkretisht në terren të dinamikës së krijuar për shkak të emergjencave si dhe koordinimit dhe mbështetjes së strukturave, anëtare të KECQ, për normalizimin e situatave të krijuara nga reshjet e shiut, dhe të emergjencave verore.

Vëmendja kryesore në fushën e emergjencave civile ka qenë evidentimi dhe ndjekja e masave parandaluese për emergjencat civile në nivel qarku dhe ndjekja e ritmikës së realizimit të tyre si dhe angazhimi i strukturave operacionale nëpërmjet koordinimit të Prefektit në rastet e situatave emergjente të krijuara, kryesisht gjatë periudhës së verës.

Gjatë vitit është punuar edhe për përmbushjen e objektivave vjetore sektoriale të përcaktuara që në fillim të vitit 2023 si:

1. Forcimi i kapaciteteve institucionale në fushën e mbrojtjes civile.
2. Hartimi i dokumentit të vlerësimit të riskut.
3. Organizimi i fushatave sensibilizuese, pjesëmarrja në trajnime apo aktivitete.

Gjithashtu, vlen të theksohet fakti i padiskutueshëm i vijimit të rolit dhe vëmendjes së treguar nga Qeveria Shqiptare dhe strukturave qendrore në fushën e mbrojtjes civile, nëpërmjet

Thirrjes për aplikim për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore në programin “Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive”, program nga i cili; Bashkia Roskovec ka përfituar gjatë viti 2023 një projekt për sigurinë në rezervuarin e Ngjeqarit, në fshatin Ngjeqar, Njësia Administrative Kurjan.

Transfertës për përdorim të fondit, nga buxheti i shtetit të kushtëzuar për mbrojtjen civile, për 6 (gjashtë) bashkitë e qarkut Fier.

Përzgjedhjes dhe mbështetjes nëpërmjet një projekti pilot të koordinuar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, të financuar nga UNDP për hartimin e setit të dokumenteve strategjikë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë.

Mirëmbajtjes dhe investimeve të bëra nga Drejtoria Rajonale e Ujitjes dhe Kullimit Fier si:

- Investimeve për mirëmbajtje të sistemit të kullimit në kanalet e ujërave të larta dhe të ulta në një gjatësi prej 34 km/ linear, në nivel qarku.
- Investimit (me gurë) për mbrojtjen nga gërryerja në krahun e majtë të lumit Seman me një gjatësi prej 230 ml.
- Ndërhyrja në krahun e majtë të argjinaturës së lumit Shkumbin në një gjatësi prej 6 km në Sulzotaj, Divjakë dhe Fier me qëllim rritjen e sigurisë së mbrojtjes nga përmbytja.

Forcimi i kapaciteteve institucionale në fushën e mbrojtjes civile

Objektivi është realizuar nëpërmjet konkretizimit të veprimeve, të rritjes dhe forcimit të bashkëpunimit ndërmjet strukturave vendore dhe atyre qendrore në fushën e mbrojtjes civile me rolin e institucionit të Prefektit si koordinuesi kryesor në përballimin me sukses të situatave emergjente.

Për realizimin e objektivit, Prefekti;

- Në kuadër të koordinimit dhe bashkëpunimit efektiv ka zhvilluar 5 (pesë) mbledhje të Komisionit të Mbrojtjes Civile Qarku Fier, me fokus rritjen e gatishmërisë së mjeteve teknike dhe burimeve njerëzore, bashkëpunimit midis strukturave si dhe të forcimit të masave të mbrojtjes nga zjarri në qarkun Fier.
- Duke vlerësuar rëndësinë e situatës ka marrë pjesë drejtpërdrejtë në 22 ngjarje emergjente nga zjarret.
- Nën koordinimin e Prefektit, referuar kërkesave të bashkive, kemi angazhuar në 6 (gjashtë) raste trupa të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në 4 (katër) raste helikopterin e Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe në 1 (një) rast aktivizimin e Sistemit të Mekanizmit Evropian të Mbrojtjes Civile.

Konstatim:

Strukturat operacionale të Mzsh-ve, në nivel qarku, në situatat emergjente të shkaktuara nga zjarret gjatë sezonit të verës, kanë patur një angazhim dhe bashkëpunim të lartë, por gjatë veprimtarisë së tyre janë evidentuar mangësi në kapacitet teknike dhe logjistike, si në sasi ashtu edhe në cilësi.

Hartimi i dokumenteve të vlerësimit të riskut

Përmbushja e detyrime ligjore të parashikuara në ligjin Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” dhe plotësimi me setin e domosdoshëm të dokumentacionit për “Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë”,

është realizuar me sukses përsa i përket hartimit dhe miratimit të dokumentit të Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë, në nivel qarku.

Ky dokument vjen pas hartimit dhe miratimit të dokumentit të Vlerësimit të Riskut për gjashtë bashkitë e qarkut Fier, nëpërmjet një projekti pilot të koordinuar nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe me mbështetjen e UNDP-së.

Në kuadër të procesit të hartimit të dokumenteve strategjike për “Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë”, konkretisht në hartimin e dokumentit të “Vlerësimit të Riskut” në nivel vendor për 6 (gjashtë) bashkitë e qarkut Fier, Prefekti i Qarkut Fier ka pasur një rol thelbësor në proces, për realizimin e të cilit:

- Është koordinuar puna e strukturave vendore me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) dhe ekspertët kombëtar të përzgjedhur për hartimin e dokumenteve.
- Janë mbledhur, përpunuar dhe dërguar informacion sipas kërkesave të ardhura nga ekspertët e hartimit të dokumentit të vlerësimit të riskut apo AKMC.
- Janë organizuar disa takime me pjesëmarrje të strukturave përgjegjëse në proces dhe grupeve të interesit.
- Janë kryer inspektime në terren së bashku me ekspertët kombëtar në lidhje me identifikimin e risqeve.

Gjithashtu nën koordinimin e Prefektit të Qarkut Fier, ka filluar edhe faza e hartimit të dokumentit të Strategjisë Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, në gjashtë bashkitë e qarkut Fier.

Organizimi i fushatave sensibilizuese, pjesëmarrja në aktivitete apo trajnime në fushën e mbrojtjes civile.

Objektivi është realizuar nëpërmjet organizimit të aktiviteteve:

1. “Fuqizojmë gjeneratën e re” - Program ndërgjegjësimi me nxënësit e shkollave të mesme në 6 bashkitë e qarkut Fier mbi zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë përmes të cilave synojmë t’i pajsim nxënësit e shkollave me njohuritë e duhura mbi fatkeqësitë dhe të kultivojmë dëshirën për të reaguar dhe kontribuar në përballimin e fatkeqësive, konkretisht:
 - Rritjen e ndërgjegjësimit dhe të kuptuarit për rreziqet e fatkeqësive dhe ndikimin e tyre në komunitet.
 - Njohuri praktike mbi gatishmërinë dhe reagimin ndaj emergjencave civile.
 - Njohjen me institucionet, pjesë e reagimit mbrojtës ndaj fatkeqësive.
 - Inkurajimin e nxënësve, të marrin një rol aktiv dhe të kontribuojnë në ripërtëritjen ndaj fatkeqësive.
2. Në bashkëpunim me strukturat e Mbrojtjes Civile, pranë bashkisë Fier, kemi organizuar takime sensibilizuese me fermerë dhe banorë të Njësisë Administrative Qendër, Cakran dhe Topojë në lidhje me mos ndezjen e zjarreve në toka bujqësore, ullishte apo pyje.

Pjesëmarrja në trajnime:

1. “Avancimin e planifikimit afatmesëm dhe afatgjatë të Shqipërisë për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike, përmes zhvillimit të një procesi të Planifikimit Kombëtar të Përshtatjes” (NAP), organizuar në Tiranë më datë 7-8-9 Mars 2023.

“Fuqizimi i lidhjes Paralajmërim i Hershëm - Veprim i Hershëm” në kuadër të projektit IPA Flood & FIRE, organizuar në Tirane më datë 6-7 Korrik 2023

1. DETYRA TË TJERA TË REALIZUARA

- Përditësimi i dosjes me aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e Mbrojtjes Civile.
- Rifreskimi i planit të masave për sezonin vjeshtë - dimër dhe pranverë - verë 2023.
- Grumbullimi, përpunimi dhe përditësimi i të dhënave të nevojshme nga bashkitë dhe strukturat që veprojnë në qark për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe menaxhimin e tyre.
- Hartimi dhe konceptimi i shkresave, informacioneve dhe raporteve ditore, javore dhe mujore, etj.
- Pjesëmarrja, ndjekja dhe zbatimi i detyrave që rrjedhin nga urdhrat e brendshëm të institucionit.

Emergjencat e ndodhura

Zjarre

Gjatë vitit të 2023, nga raportimet e strukturave vendore të mbrojtjes civile dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, janë evidentuar 213 raste zjarri nga të cilat:

- Në objekte **32** raste, nga të cilat 30 objekte private dhe 2 raste në objekte publike.
- Në sipërfaqet e veshura me bimësi patëm **171** raste, nga të cilat 22 raste në pyje, 32 raste në ullishte dhe 117 në sipërfaqe të djerra private e publike me shkurre dhe ferra.
- Në depozita bari të thatë për bagëti **4** raste.
- Në automjete **6** raste.

Emërtimi NJ.V.Q.V	Raste Gjithsej	Objekte			Sipërfaqet e veshura me bimësi					Depozit a bari për blegtori në	Automjete	
		Rastet	Private	Publike	Rastet	Pyje		Ullishte				Sip.të djerra
						Rastet	Sipërf · Djerr r (në ha)	Rastet	Sasia e Djerr r (në rrënjë)			

Qarku Fier	213	32	30	2	171	22	1016	32	8675	117	4	6
Bashkia Fier	63	13	13	0	49	17	1006.2	9	4940	23	1	0
Bashkia Lushnje	52	11	10	1	37	0	0	2	664	35	2	2
Bashkia Mallakastër	13	1	1	0	10	0	0	5	660	5	1	0
Bashkia Patos	31	2	2	0	27	1	0.2	5	1136	21	0	2
Bashkia Divjake	27	1	1	0	26	1	0.1	3	130	22	0	0
Bashkia Roskovec	27	3	3	0	22	3	9.5	8	1145	11	0	2

Konstatime:

- Në raport me vitin 2022 ka të njëjtën tendencë në numra të përgjithshëm të rasteve të zjarreve, por gjatë 2023 ka një rritje të numrit të rasteve të zjarreve në pyje. Kjo rritje më së shumti evidentohet në territorin e bashkisë Fier, ku edhe sipërfaqja e djegur ka qenë rreth 1000 ha.
- Mungojnë investime në infrastrukturën rrugore për zonat malore apo kodrinore të veshura me ekonomi pyjore, ullishte apo bimësi të egër duke vështirësuar edhe më shumë punën e shërbimit zjarrfikës.
- Mbetet problem sensibilizimi i duhur i fermerëve, si për rrezikun që mund të sjell dalja jashtë kontrollit e ndezjes dhe përdorimit të zjarreve për djegien e mbeturinave në parcelat e tyre, si dhe për dëmtimin strukturor dhe varfërimin e fuqisë prodhuese të tokës bujqësore.

Konstatime:

Infrastruktura rrugore në drejtim të pyjeve/maleve apo zonave kodrinore me ullishte ka qenë jashtë funksioni apo ka munguar plotësisht.

Strukturat e M.C së bashkive në shumë raste nuk realizuan do të angazhimin e strukturave të tjera të bashkisë të planëzuara prej tyre, në mbështetje të MZSH-së, për vënin nën kontroll të situatës para se zjarri të rriste përmasat e tij.

Mbetet problem sensibilizimi i duhur i fermerëve, si për rrezikun që mund të sjell dalja jashtë kontrollit e ndezjes dhe përdorimit të zjarreve për djegien e mbeturinave në parcelat e tyre, si dhe për dëmtimin strukturor dhe varfërimin e fuqisë prodhuese të tokës bujqësore.

Repartet e MZSH-ve në përgjithësi janë të pakompletuara me stacione qëndrimi, personel, apo pajisje të tjera logjistike, çka ul ndjeshëm forcën e tyre reaguese.

Përgjatë rrjedhës së lumenjve në qarkun Fier, mungojnë pajisjet teknike/teknologjike për matjen e nivelit/prurjeve që do ndihmonte në situatat emergjente pozitivisht në realizimin sa me efikas të paralajmërimit të hershëm dhe njoftimit të komuniteteve të rrezikuara.

PROBLEMATIKA

Në fushën e emergjencave civile

Në pjesën më të madhe të rasteve të zjarreve, sidomos në sipërfaqet me ekonomi pyjore, **kemi të bëjmë me veprimtari të pastër kriminale, me qëllime dhe interesa te caktuara.** Zbulueshmëria dhe vënia përpara përgjegjësisë ligjore personave zjarrvënës ka qenë e ulët. Strukturat Vendore të Policisë, duhet të rrisin bashkëpunimin me strukturat e bashkive, për emergjencat në tërësi e tyre dhe ne veçanti për parandalimin e zjarreve.

Është i domosdoshëm hartimi dhe nxjerrja e një akti ligjor, për ndalimin e ndezjes dhe përdorimit të zjarreve në sipërfaqet e veshura me bimësi dhe objektet me risk të lartë zjarri, gjatë muajve të verës..

Bashkitë duhet të marrin përsipër përgjegjësitë dhe të përmbushin detyrat e tyre ligjore, në kontrollin e territorit që kanë në juridiksionin e tyre, si dhe të rrisin dhe përmirësojnë kapacitetet reaguese, teknike dhe njerëzore të strukturave të M.C dhe MZSH-ve.

V. TASK FORCA, KOMITETET RAJONALE SI DHE ORGANI KËSHILLUES PRANË PREFEKTIT TË QARKUT

KOMITETI RAJONAL I TURIZMIT

Ndjekja dhe monitorimi i veprimtarive të Institucioneve Qendrore dhe Vendore për mbarëvajtjen e sezonit turistik 2022, ndjekja e detyrave nga Task-Forca të veçanta për sezonin turistik në Qark si dhe ndjekjen dhe realizimin e detyrave të Komitetit Rajonal të Turizmit. Ndjekja e problemeve të sigurisë, të higjienës dhe të shëndetësisë në plazhe dhe në zona të tjera turistike.

Ky objektivi u realizua nëpërmjet:

- Ngritjes së grupit të punës me anëtarë të degëve territoriale për sigurimin e një sezoni të suksesshëm turistik.
- Drejtimi i Komitetit Rajonal të Turizmit

Konkretisht :

Për një mbarëvajtje sa më të mirë të Sezonit Turistik 20223, Institucioni i Prefektit të Qarkut Fier, i kushtoi një vëmendje të veçantë koordinimit dhe monitorimit të punës të Institucioneve Qendrore në nivel vendor që kanë impakt në mbarëvajtjen e sezonit, për këtë krahas punës së vazhduar gjatë gjithë vitit është realizuar koordinimi dhe është ofruar bashkëpunimi nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut bazuar në kërkesat e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për bashkëpunim me NJVQV për një mbarëvajtje sa më të mirë të Sezonit Turistik dhe për sigurimin e një sezoni të suksesshëm turistik. Janë zhvilluar mbledhjet e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit 2023, përkatësisht në datë 03.04.2023 dhe 12.07.2023. Ndërkohë është kryer Raportimi në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit si dhe në Ministrinë e Brendshme për veprimtarinë e task – forcës për sezonin turistik veror. Është krijuar databazë për emrat e kontaktit të task-forcës për sezonin turistik, është kryer menaxhimi I grupit të Whatsapp për veprimtarinë javore të Task – Forcës së Turizmit. Çdo të hënë është raportuar në Ministri. Institucioni I Prefektit ka hartuar edhe raportin përfundimtar pas mbylljes me sukses të sezonit turistik. Sakaq është zhvilluar dhe Takimi I Komitetit të Zonave të Mbrojtura datë 27.06.2023.

VEPRIMTARIA E TASK-FORCE “PËR LUFTËN KUNDËR KANABISIT”.

Veprimtaria “Për luftën kundër Kanabisit”.

Për luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, ka vijuar ndjekja e veprimtarive të punës nga strukturat vendore si me bashkitë dhe Degët Territoriale dhe në mënyrë të veçantë me strukturat e DVP Fier.


Përgjatë vitit 2023, janë zhvilluar tre takime me pjesëmarrës të strukturave vendore.

Është bërë administrimi i planeve dhe informacioneve mujore ardhur nga bashkitë përkatëse mbi aktivitetin e tyre në luftën kundër kultivimit të kanabisit.

Në bazë të të dhënave të administruara nga Komunikatat e Policisë apo raportimeve periodike nga strukturat e tjera vendore, është përditësuar baza e të dhënave për rastet e kultivimit të kanabisit nga ku rezulton se, për periudhën janar - dhjetor të vitit 2023, janë evidentuar **22** raste të kultivimit të kanabisit, dhe asgjësuar **2385** bimë narkotike të dyshuara kanabis sativa, për këto raste janë arrestuar **23 shtetas** dhe shpallur në kërkim **3 të tjerë**.

Rastet e kultivimit kanbisit

■ 2023 ■ 2022



1. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2024

ANTITRAFIKIMI E PERSONAVE NË QARKUN FIER (KRAT)

Strukturat e KRAT Fier janë të angazhuara në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit përfshirë identifikimin në kohën dhe mënyrën e duhur të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit, të rritur apo të mitur, për të gjitha format e shfrytëzimit, të trafikimit të brendshëm apo ndërkombëtar, të lidhur apo jo me krimin e organizuar, duke kryer në çdo rast veprimet e procedurale dhe duke vënë përpara përgjegjësisë ligjore autorët.

Si pjesë e përmbushjes së detyrimeve tona ligjore, vazhdon puna për parandalimin, evidentimin dhe luftimin e këtij fenomeni duke bashkëpunuar me të gjitha strukturat e Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Trafikimit të Personave .

Në Bashkinë Lushnje përgjatë periudhës Janar -Dhjetor 2023 janë identifikuar dhe trajtuar 2 raste të viktimave të mundeshe trafikimi.

Rasti i parë është rasti i një vajze me inicialet K.T e datëlindjes 20/02/2010, dhe I përket komunitetit Rom. Në bashkëpunim me Njësinë e Mbrojtës së Fëmijëve janë marrë të gjitha masat e nevojshme ,për ndjekjen dhe trajtimin e rastit duke bërë te gjitha veprimet e duhura .Rasti i dytë

është gjithashtu i një vajze minorene me inicialet A.Ç e datëlindjes ,30/04/2008 e cila është e pajisur me urdhër mbrojtje. Për rastin është bashkëpunuar me Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve duke e ndjekur dhe marrë te gjitha masat e nevojshme ,për ndjekjen dhe trajtimin e rastit. Momentalisht vajza është akomoduar pranë qendrës “Tjetër Vizion”, në Elbasan duke marrë të gjithë shërbimin e nevojshëm.

Nga Drejtoria vendore e Policisë së Shtetit Fier veprat penale në Luftën kundër trafikimit të personave rezultojnë si më poshtë:

13 Raste për veprën penale "Trafikim i personave të rritur" Neni 110/a i Kodit Penal.

7 Raste për veprën penale "Trafikim i personave të mitur" Neni 128/b i Kodit Penal.

8 Raste për veprën penale "Trafikim klandestinësh" Neni 298 i Kodit Penal.

VI. REKOMANDIME

Përmirësimi i mëtejshëm i punës dhe performancës së Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier kërkon përkushtim dhe angazhim gjatë këtij vitit nga administrata e Prefektit . Për realizimin e kësaj performance dua të rendit disa rekomandime, si më poshtë:

Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit të punës me institucionet në nivel vendor, njësitë e vetëqeverisjes vendore, subjektet private, shoqërinë civile si dhe me shoqata mjedisore për krijimin e një mjedisi të pastër brenda territorit të qarkut.

Respektimin e afateve kohore në raportimin periodik mujor të Degëve Territoriale, dhe pasqyrim të arritjeve sipas objektivave të vendosura mujore prej tyre si dhe problematikave

Përgatitja e planeve vjetore në përputhje me ligjin për Çdo Degë Territoriale dhe dërgimi i tyre pranë institucionit të Prefektit brenda muajit shkurt 2023

Përmirësimi i shërbimit ndaj qytetarëve duke shërbyer me profesionalizëm dhe me integritet moral si dhe shqyrtimi i ankesave dhe kërkesave të qytetarëve duke i adresuar drejt zgjidhjes ligjore brenda afateve kohore.

Rritja e performancës së punonjësve të administratës shtetërore brenda çdo institucioni apo degë territoriale.

Rritja e rolit të Prefektit në konsolidimin e imazhit të institucionit nëpërmjet menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Rritja e bashkëpunimit në Institucionin e Prefektit të Qarkut në mbështetje të personelit për përmirësimin e kushteve të punës si në aspektin jetësor ashtu edhe atë funksional sipas sektorëve dhe në tërësi për Institucionin e Prefektit.

Standardizimi i mënyrës së hartimit të urdhrit, shkresës, trajtimit të kërkesave dhe ankesave, dorëzimit të dokumentacionit të prapambetur në AQV, ruajtja e dokumenteve shkresore, monitorimi i ecurisë së sistemit të dokumentacionit arkivor në vite

Rritja e bashkëpunimit midis Njërive të Vetëqeverisjes Vendore, Inspektorateve Shtetërore, Drejtorisë Vendore të Policisë së Qarkut me qëllim parandalimin dhe identifikimin e autorëve në veprat penale si zjarrvënien e qëllimshëm, kultivimi i lëndëve narkotike, prerja e pyjeve, etj.

Hartimi i Planit të Menaxhimit të Emergjencave Civile në shkallë qarku, bazuar në ndryshimet ligjore e udhëzimet e ardhura nga AKMC, duke i kushtuar rëndësi të veçantë analizës së riskut, llogaritjes së forcave dhe mjeteve (të strukturave vendore, strukturave qendrore dhe të të tretëve) dhe skenarëve të ndryshëm sipas probabilitetit të ndodhjes.

VII. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2024

1-Rritja dhe konsolidimi i frymës institucionale gjatë procesit të verifikimit të ligjshmërisë së akteve me karakter normativ me organet e vetëqeverisjes vendore duke synuar përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe përmirësimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë nga Institucioni i Prefektit të Qarkut.

2-Ndjekja e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit me përgjegjshmëri, efikasitet dhe në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

3-Rritja e standardit ligjor të hartimit të shkresave nga administrata si dhe dhënia e asistencës juridike NJVQV-ve për korrigjimin e problematikave të konstatuara gjatë verifikimit të ligjshmërisë së akteve.

4-Perdorimi dhe menaxhimi me ekonomi efektivitet dhe efikasitet të fondeve buxhetore

Realizimi të këtij objekti do t'i shërbejë:

- a) hartimi i një plani të detajuar të burimeve financiare sipas klasifikimit buxhetor, bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",
- b) Studimi I hollësishëm i nevojave dhe kërkesave sipas sektorëve për fonde, për vitin 2023, duke bashkëpunuar me sektorët, në respektimin e parimit të transparencës, ligjshmërisë, shmangien e shpërdorimit të fondeve, keqpërdorimit, dhe vjedhjes së pasurisë së institucionit.
- c) bashkëpunimi me ministrinë e linjës dhe departamentin e Administratës Publike
- d) Mirëmbajtja e aktiveve të Institucionit, rritja e përgjegjësisë menaxheriale të Sektorit të Financës dhe shërbimeve mbështetëse.

5-Permiresim i Kushteve të punës

- e) Përmirësimi i kushteve të punës, në këndvështrimin jetësor dhe atë funksional.
- f) Kompletimi i zyrave me orënditë e nevojshme.
- g) Pajisja me bazë materiale të përditshme.
- h) Standardizimi i sistemimit të dokumentacionit në zyra dhe kujdesit për ambientin e punës.
- i) Zbatimi i kodit të etikës në punë etj,
- j) Mirëmbajtja e aktiveve të Institucionit, rritja e përgjegjësisë menaxheriale të Sektorit të Financës dhe shërbimeve mbështetëse.

6-Arkivimi i dokumenteve

- a) Standardizimi dhe sistemimi i dokumentacionit arkivor të Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier
- b) Standardizimi i mënyrës së hartimit të urdhrit, vendimit, udhëzimit, trajtimit të kërkesave ankesave, kthim përgjigjeve etj.
- c) Zbatimi me rigorozitet i gjuhës shqipe dhe përmirësimin të mënyrës së formulimit të dokumentit.
- d) Përpunimi dhe dorëzimi i dokumentacionit arkivor në vite.

- e) Përmirësimi i kushteve të ambientit të përpunimit të dokumentacionit shkresor ditor të arkivit.

7- Ndjekja dhe zbatimi i procedurave ligjore mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në lidhje me legjislacionin për nëpunësin civil, emërimin, lirimin, rekrutimin, regjistrimin e lëvizjes së punonjësve, menaxhimin e dosjeve të personelit dhe dhënies së informacioneve eprore sipas shkalles së hierarkisë, mbi menaxhimin e burimeve njerëzore. (Raportimi periodik/mujor i informacionit në lidhje me lirimet, emërimet, vlerësimet, masat disiplinore, proceset gjyqësore të nëpunësve civil), duke iu referuar strukturës plan dhe asaj fakt, shpallja e vendeve vakante sipas kriterëve, përshkrimeve dhe arsimit të kërkuar, sipas aftësive profesionale, dhe kriterëve të përcaktuara, në aktet ligjore, nënligjore, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe me Ministrinë e Brendshme.

Administrimi i HRMIS, hedhja e të dhënave dhe shkresave nga dosja personale fizike në sistemin online.

8- Raportimi dhe përditësimi i pronave të paluajtshme sipas listës së inventarit të pronave për Institucionin e Prefektit Qarkut Fier bazuar në VKM nr. 28, datë 27.1.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”, si dhe urdhrin të Ministrit të Brendshëm nr. 44, datë 11.4.2023 për zbatimin e VKM nr. 28, datë 27.1.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”,

do të realizohen nëpërmjet veprimtarive si më poshtë:

- a. Garantimin para miratimit të shkresave/urdhrave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit; përgatitjen e dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi; pranimin ose jo të dokumentacionit, bazuar në kontrollet pas faktit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- b. Mbajtjen dhe zbatimin e sistemit të kontabilitetit, raportimit për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave, kontabilizimin e plotë, të saktë dhe në kohë të të gjitha transaksioneve,
- c. Kontrollin dhe ndjekjen e shpenzimeve dhe të ardhurave të Institucionit, përpilimin e evidencës së shpenzimeve faktike mujore dhe progresive paraqitjen të Titullari i Institucionit dhe dërgimin në Ministrinë e linjës.
- d. Kontrollin mbi ndjekjen dhe pasurimin e dosjes së personelit, duke bërë në të ndryshimet përkatëse në bazë të urdhërave dhe vendimeve për lëvizje, dhënie stimulesh dhe masash disiplinore, mbarim shkolle dhe kurse, duke vendosur në pjesën përkatëse vlerësimet periodike të punës së nëpunësit, Marrjen e masave për njohjen dhe zbatimin me përpikmëri të ligjeve dhe akteve nënligjore të “Nëpunësit të shërbimit civil” dhe punonjësve që rregullohen me kodin e punës

- e. Kontrollin mbi Regjistrimin e korrespondencës zyrtare, shpërndarjen dhe përpunimin e tyre, evidentimin, ruajtjen fizike, përpunimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve në bazë të ligjeve në fuqi.
- f. Kontrollin mbi Protokollimin e vendimeve dhe urdhërave e Prefektit të Qarkut Fier, si dhe praktikën shkresore të Prefektit të Qarkut Fier nënshkruar nga Prefekti i Qarkut Fier apo persona të tjerë të autorizuar me urdhër të veçantë me shkrim prej tij.
- g. Koordinimin, Administrimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të punës, pajisjeve teknike, për krijimin e kushteve sa më të përshtatshme të punës për të gjithë punonjësit.
- h. Organizimin e punës mbi Përgatitjen e kërkesave, që lidhen me bazën e nevojshme materiale për mirëmbajtjen ose riparimin e godinës, të printerave, të fotokopjeve, të fakseve, të automjeteve, të sistemit të ndriçimit dhe të pajisjeve kancelarike.
- i. Përgatitjen e kushteve dhe specifikimet teknike për pranimin dhe lëvrimin e mallrave, magazinimin dhe ruajtjen e tyre;
- j. Ruajtjen, sistemimin dhe administrimin e dosjeve dhe librezave të punës së punonjësve që janë ose merren në punë në Institucionin e Prefektit të Qarkut Fier duke bërë inkuadrimin e tyre sipas sistemit (HRMIS)
- k. Ndjekjen e shërbimit të pastrimit dhe higjienizimit të zyrave, përfshi edhe pajisjet brenda tyre, ambienteve të brendshme e të jashtme të godinës së Institucionit çdo ditë dhe gjatë gjithë orarit zyrtar të punës
- l. Mbajtjen në gatishmëri të vazhdueshme teknike mjetet e transportit, dhe kontrolli i shpenzimeve të karburantit për të kryer shërbimin e transportit të punonjësve të administratës në përbushje të detyrave të tyre funksionale.

9-Hartimi dhe miratimi i planit të Emergjencave Civile, në nivel qarku

Përbushja e detyrime ligjore të parashikuar në ligjin Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” dhe plotësimi me setin e domosdoshëm të dokumentacionit për “Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.

10-Sigurimi i funksionimit të sistemit të paralajmërimit të hershëm, monitorimit dhe njoftimit në nivel qarku. Rritja e bashkëpunimit me strukturat qendrore dhe vendore të mbrojtjes civile për identifikimin, mbledhjen, përpunimin, analizimin dhe komunikimin e të dhënave që kanë të bëjnë më rreziqet e menjëhershme dhe ato të pritshme.

11- Konsolidimi i performancës së strukturave vendore të mbrojtjes civile

Konsolidimi i performancës së Drejtorive/ Sektorëve të Menaxhimit të Emergjencave Civile (MC) në Qark, nëpërmjet një veprimtarie të përbashkët për të ndikuar në mënyrë reciproke në rritjen dhe konsolidimin e performancës në drejtim të parandalimit, planëzimit dhe menaxhimit të situatave emergjente.

VIII. BURIMI I INFORMACIONIT

1. Informacioni i marrë nga dokumentacioni i prodhuar nga sektorët e Institucionit të Prefektit të Qarkut Fier
2. Raportimet nga 6 bashkitë e qarkut Fier.
3. Raportim nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier.
4. Raportimet nga Degët Territoriale që veprojnë në qarkun Fier.